



MARTESA E FËMIJËVE

NJOHURITË, QËNDRIMET
DHE PERCEPTIMET
NDËR KOMUNITETET
E PREKURA
NË SHQIPËRI



Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Ky raport është përgatitur nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori) për UNICEF dhe UNFPA në Shqipëri dhe në mbështetje të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale gjatë periudhës tetor 2017 – qershor 2017. Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim mbështeti financiarisht këtë studim.

Përmbajtja e botimit është përgjegjësi e Observatorit dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e zyrave të UNICEF dhe UNFPA në Shqipëri apo ato të Qeverisë së Suedisë.

Për të shkarkuar raportin e plotë mund të shkoni në: <https://www.unicef.org/albania/>, <https://albania.unfpa.org/>, ose në <http://observator.org.al/>.

Kërkesat për leje për të riprodhuar ose përkthyer këtë raport duhet të adresohen në zyrat e UNICEF dhe UNFPA në Shqipëri në:

UNICEF Shqipëri
Rruga "Skënderbej"
Ndërtesa Volkswagen, kati i 3-të
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 22 73335
E-mail: info@unicef.org
Website: <https://www.unicef.org/albania/>

UNFPA Shqipëri
Rruga "Skënderbej"
Ndërtesa Volkswagen, kati i 2-të
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 4500015/6/7
E-mail: albania.office@unfpa.org
Website: <https://albania.unfpa.org/>

Falenderime

Ky studim u realizua nën drejtimin e Emira Shkurtit dhe Elda Hallkajt (UNICEF Shqipëri) si dhe të Elsona Agollit (UNFPA Shqipëri).

Do të donim të shprehim mirënjohjen tonë për Joanna J. P. Hoare e cila hartoi pyetësorët dhe Guidat e Grupeve të Fokusit, trajnoi skuadrën e terrenit, krijoi databazën dhe librin e kodimit, kreu përpunimin e të dhënave dhe hartoi me sukses këtë raport analitik. Falenderime të veçanta shkojnë për Emira Galanxhin, për kontributin e saj në përcaktimin e qasjes metodologjike dhe përmasës së zgjedhjes. Falenderojmë skuadrën e terrenit të këtij projekti të përbërë nga: Rezana Shehu, Zana Kondi, Mersi Shehu, Dafina Muda, Regana Hysenbelliu, Mariana Jorgji, Rudina Lako, Entela Fejzo, Marjan Ndoci dhe Anxhela Marpalaj, të cilët ishin përgjegjës për organizimin dhe realizimin e Diskutimeve të Grupeve të Fokusit dhe Intervistave. U jemi mirënjohës Elma Tërshanës, Drejtore Ekzekutive e Observatorit, Julia Alushit, Administratore e të Dhënave Kombëtare dhe Eridjona Valles, Drejtuese Programi për udhëheqjen dhe koordinimin e zbatimit të këtij studimi.

Studimi ka përfituar nga kontributi dhe këshillat e vlefshme të një grupi ekspertësh këshillues: Maha Muna, Këshilltare për çështjet gjinore pranë UNICEF ZRELAQ, Sergiu Tomsa, Specialist për Komunikimin për Zhvillim dhe Ndryshime Shoqërore pranë UNICEF ZRELAQ, David Gvineria, Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë UNICEF Shqipëri, Nigina Abaszadeh, Këshilltare për Çështjet Gjinore pranë UNFPA ZRELAQ, Nurgul Kinderbaeva, Specialiste për Çështjet Gjinore pranë UNFPA ZRELAQ, si edhe IOD Park. Kontribute të vlefshme u dhanë gjithashtu nga skuadra e programit të UNICEF në Shqipëri: Jawad Aslam, Alketa Zazo, Anila Miria, Mariana Bukli dhe Mirlinda Bushati.

U jemi gjithashtu jashtëzakonisht mirënjohës të gjithë ofruesve të shërbimeve në Durrës, Korçë, Lezhë dhe Tiranë të cilët morën pjesë në këtë studim nëpërmjet intervistave si dhe lehtësuan punën tonë në identifikimin dhe ftesën e pjesëmarrësve në Diskutimet e Grupeve të Fokusit. Do të donim të shprehim mirënjohjen tonë për të gjithë pjesëmarrësit që kontribuan në këtë studim nëpërmjet Diskutimeve të Grupeve të Fokusit dhe Intervistave.

Raporti u hartua fillimisht në gjuhën angleze dhe u përkthye në shqip nga Jonida Bregu.

Tabela e Përmbajtjes

Falenderimet.....	3
Konceptet kyç.....	5
Shkurtime.....	7
Lista e tabelave.....	8
Lista e kutive.....	8
1. Përmbledhje ekzekutive.....	9
2. Të kuptojmë martesën e fëmijëve.....	13
3. Qëllimi dhe objektivat e studimit.....	17
4. Metodologjia.....	20
Qasja metodologjike.....	20
Zbatimi i studimit.....	22
Analiza e të dhënave.....	23
Kufizimet e studimit.....	23
Vlerësime dhe procedura etike.....	25
5. Njohuritë rreth martesës së fëmijëve.....	27
Njohuritë për moshën ligjore të martesës.....	25
Njohuritë rreth përhapjes së martesës së fëmijëve në komunitetet e të intervistuarve.....	28
Njohuri rreth ndikimit të martesës së fëmijëve.....	30
6. Parapëlqimet pro dhe kundër martesës së fëmijëve.....	36
Parapëlqimet e kushtëzuara pro martesës së fëmijëve.....	37
Parapëlqimet e kushtëzuara kundër martesës së fëmijëve.....	40
Parapëlqime të pakushtëzuara pro martesës së fëmijëve.....	40
Parapëlqimet e pakushtëzuara kundër martesës së fëmijëve.....	45
Martesa e fëmijëve si praktikë sociale në Shqipëri.....	47
7. Perceptimet e mundësive të zgjedhjes që lidhen me martesën e fëmijëve.....	50
Romë që jetojnë në komunitete të veçuara.....	53
Romë që jetojnë në komunitete të integruara.....	55
Jo-romë që jetojnë në komunitete rurale.....	56
Jo-romë që jetojnë në komunitete urbane.....	58
8. Përfundime dhe rekomandime.....	60
Shtojca 1: Standardet ndërkombëtare.....	63
Shtojca 2: Nxitësit dhe ndikimet e martesës së fëmijëve të identifikuar në nivel botëror, rajonal dhe kombëtar.....	65
Shtojca 3: Metodologjia e zgjeruar.....	71
Shtojca 4: Instrumentat e mbledhjes së të dhënave.....	75
Shtojca 5: Shënime.....	81

Konceptet Kyç

Adoleshent

Megjithëse nuk ka një përkufizim ndërkombëtar të adoleshencës, OKB-ja e përkufizon adoleshentin si një person në moshën 10 deri në 19 vjeç. Kompleksiteti i përkufizimit të adoleshencës lidhet me: ritmet e ndryshme me të cilat të rinjtë arrijnë pjekurinë fizike dhe emocionale; ndryshimet e mëdha mes ligjeve të vendeve të ndryshme, që përcaktojnë moshat minimale për aktivitete 'të rriturish', të tilla si votimi, konsumi i alkoolit ose martesa, dhe fakti që shumë adoleshentë janë të angazhuar në aktivitete 'të rriturish', të tilla si puna ose kujdesi për të tjerët, pavarësisht nëse e kanë arritur apo jo pragun ligjor të moshës së pjekurisë.¹

Mosha e pëlqimit

Mosha e pëlqimit është mosha në të cilën një i ri ose e re gjykohet ligjërisht i/e aftë të japë pëlqimin për marrëdhënie seksuale. Kjo bazohet në supozimin se fëmijët kanë nevojë për mbrojtje të veçantë nga abuzimi seksual dhe se ka një moshë të caktuar, nën të cilën, fëmijët nuk janë në gjendje të japin pëlqimin për aktivitet seksual.² Në shumë vende, mosha e pëlqimit dhe mosha minimale për martesë të ligjshme janë të ndryshme.

Qëndrim

UNICEF-i e përdor termin 'qëndrime' për të përfshirë sferën e gjerë të normave shoqërore, të etikës, moralit, vlerave, të drejtave, kulturës, traditës, shpirtërores dhe fesë, si dhe ndjenjave për veten dhe të tjerët.³

Martesa e fëmijëve

Martesa e fëmijëve është çdo martesë zyrtare ose zakonore apo bashkim jo-zyrtar (i regjistruar ose jo), ku një ose të dy bashkëshortët a partnerët janë nën moshën 18 vjeç.⁴

Mbrojtje e fëmijëve

Mbrojtja e fëmijëve i referohet parandalimit dhe reagimit ndaj dhunës, shfrytëzimit dhe abuzimit të fëmijëve, përfshirë mbrojtjen nga praktikat e dëmshme, siç është martesa e fëmijëve.⁵

Dhunë në familje

Dhuna në familje i referohet dhunës nga një bashkëshort ose partner intim dhe nga anëtarë të tjerë të familjes, kudo që ndodh dhe në çfarëdo lloj forme⁶.

Bashkim i hershëm

Bashkimi i hershëm i referohet martesave të paregjistruara, bashkëjetesave dhe bashkimeve 'de fakto', jo zyrtare ose shoqërore, të cilat mund të njihen nga familjet dhe komunitetet, por nuk kanë bazë ligjore, kur një ose të dy partnerët janë nën 18 vjeç.⁴ Bashkimet e hershme përfshihen në përkufizimin e martesës së fëmijëve.⁷

Gjini

Gjinia është një konstrukt shoqëror dhe kulturor, i cili shquan dallimet në atributet e burrave dhe grave, vajzave dhe djemve, dhe, në përputhje me këtë, iu referohet roleve dhe përgjegjësi të burrave dhe grave. Rolet me bazë gjinore dhe atributet e tjera ndryshojnë me kalimin e kohës dhe variojnë sipas konteksteve të ndryshme kulturore. Koncepti i gjinisë përfshin pritshmëritë për karakteristikat, aftësitë dhe sjelljet e mundshme të grave dhe burrave (feminiteti dhe burrëria). Ky koncept është po ashtu i dobishëm në analizimin si praktikat dhe normat e përbashkëta i legjitimojnë mospërputhjet mes seksve.⁸

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Dhunë me bazë gjinore

Dhuna me bazë gjinore i referohet çdo akti dhune ose abuzimi që shënjestron një individ ose një grup për shkak të gjinisë së tyre. Dhuna me bazë gjinore mund të prekë gratë dhe burrat, por më shpesh përdoret për t'iu referuar dhunës që prek gratë dhe vajzat, pasi marrëdhëniet e pabarabarta gjinore dhe statusi më i ulët i grave dhe vajzave në shoqëri i vë ato në rrezik shumë më të madh ndaj dhunës, sesa burrat dhe djemtë. OKB-ja e përkufizon dhunën ndaj grave si 'dhunë me bazë gjinore, që rezulton ose ka gjasa të rezultojë në lëndim apo vuajtje fizike, seksuale ose mendore për gratë, duke përfshirë kërcënimet për vepra të tilla, shtrëngimin ose privimin arbitrar të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike apo private.⁹

Mundësi zgjedhjeje

Mundësia e zgjedhjes është 'moria e kurseve të mundshme të veprimit... nga ku dikush mund të zgjedhë, realisht' në mënyrë që të përmbushë parapëlqimet e veta.¹⁰ Është e rëndësishme që të merren parasysh bindjet e njerëzve për mundësitë që kanë në dispozicion. Në disa raste, bindjet e njerëzve rreth mundësive të caktuara do të jenë aq të forta, saqë, efektivisht, ato e eliminojnë atë kurs të caktuar veprimi si mundësi.

Parapëlqim

Për këtë studim, parapëlqimet e njerëzve (në këtë rast, pro ose kundër martesës së fëmijëve) kategorizohen si 'të kushtëzuara' (dmth., bazuar në pritshmëritë sociale (çfarë besojnë se bëjnë dhe mendojnë njerëzit e tjerë, në vend të asaj se çfarë besojnë vetë) dhe 'të pakushtëzuara'. Parapëlqimet e pakushtëzuara mund të bazohen në atë çfarë mendon dikush se është më e mira për ta ose për fëmijën e tyre, ose mund të bazohen në një 'rregull moral' (dmth, se ky kurs veprimi është gjëja moralisht e drejtë për të bërë).¹¹

Braktisja e shkollës

Braktisja është largimi nga një program arsimor ose trajnimi para përfundimit të tij.¹² Ndërsa arsimit i detyrueshëm në Shqipëri zgjat deri në fund të klasës së 9^{të} (15 vjeç), këtu, 'braktisja e shkollës' nënkupton se një fëmijë/adoleshent largohet nga shkolla para se të mbushë 18 vjeç.

Normë shoqërore

Në këtë raport, një normë shoqërore është 'një praktikë kolektive e mbështetur nga pritshmëritë empirike dhe normative dhe nga parapëlqimet e kushtëzuara mbi të dyja këto pritshmëri'.¹³ Koncepti i 'normës shoqërore' qendërohet në idenë se njohuritë, qëndrimet dhe parapëlqimet e njerëzve ndaj një praktike kolektive (si martesa e fëmijëve) ndikohen fuqimisht nga ajo çfarë po bëjnë njerëzit e tjerë përrreth dhe nga ajo se çfarë besojnë ata se të tjerët mendojnë se duhet bërë.

Dhuna ndaj fëmijëve

Të gjitha format e dhunës fizike ose mendore, lëndimit dhe abuzimit, neglizhencës ose trajtimit neglizhent, keqtrajtimit ose shfrytëzimit, përfshirë abuzimin seksual.¹⁴ Raporti Botëror mbi Dhunën dhe Shëndetin i vitit 2002 e zgjeron më tej përkufizimin e dhunës, duke theksuar se dhuna është përdorimi i qëllimshëm i forcës ose fuqisë fizike, i kërcënuar ose faktik, kundër vetes, një njeriu tjetër ose kundër një grupi ose komuniteti, që rezulton ose ka gjasë të lartë të rezultojë në lëndim, vdekje, dëmtim psikologjik, zhvillim të keq ose privim. Llojet e veçanta të dhunës ndaj fëmijëve përfshijnë neglizhencën, abuzimin dhe disiplinën e ashpër. Neglizhimi është një formë abuzimi ndaj fëmijëve që përfshin vëmendje të mangët ndaj nevojave bazë të fëmijës. Abuzimi shpesh përdoret për t'iu referuar keqtrajtimit fizik dhe/ose seksual të fëmijës. Disiplina e ashpër shpesh iu referohet praktikave të dhunshme ose abuzive të prindërimit të justifikuar si masa ose taktika disiplinore. Ndonjëherë, disiplina e ashpër quhet ndëshkim trupor.¹⁵

Shkurtime

Observatori	Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
ZRELAQ	Zyra Rajonale e Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
QSES	Qendra për Studime Ekonomike dhe Sociale
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
DUDNJ	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
KNDESK	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
KNDKP	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
KEGjFDG	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KNPZh	Konferenca Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin
APKE	Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës
KNPDNJ	Këshilli Ndërkombëtar për Politikën e të Drejtave të Njeriut
PpV Pekin	Platforma për Veprim e Pekinit
ADSh	Anketa Demografike dhe Shëndetësore
AGTSh	Anketat e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë
OZHM	Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
DGF	Diskutime të Grupeve të Fokosit
II	Intervista Individuale
IIK	Intervista me Informatorë Kyç

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Lista e tabelave

Tabela 1: Martesa e fëmijëve si praktikë kolektive.....	19
Tabela 2: Parapëlqimet e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara pro dhe kundër martesës së fëmijëve sipas grupeve të popullsisë.....	37
Tabela 3: Martesa e fëmijëve si praktikë sociale për grupe të ndryshme të popullsisë në Shqipëri.....	49
Tabela 4: Mundësitë që kanë në dispozicion vajzat dhe gratë e reja: arsimi.....	52
Tabela 5: Mundësitë që kanë në dispozicion vajzat dhe gratë e reja: puna.....	52
Tabela 6: Mundësitë që kanë në dispozicion vajzat dhe gratë e reja: lidhjet dashurore..	53
Tabela 7: Shpërndarja e DGF-ve.....	72
Tabela 8: Shpërndarja e II-ve.....	74
Tabela 9: Shpërndarja e IIK-ve.....	74

Lista e kutive

Kutia 1: Martesa e fëmijëve–kush vendos?.....	29
Kutia 2: Ndryshimi i praktikave të martesës.....	30
Kutia 3: Ndikimet gjinore të martesës së fëmijëve.....	32
Kutia 4: Nuk ka shkollë, nuk ka jetë shoqërore.....	35
Kutia 5: Martesa e fëmijëve – cikël i varfërisë.....	35
Kutia 6: Dëshira për t’u martuar si mundësi për një jetë më të mirë.....	43
Kutia 7: Kur gjithçka del mirë.....	44
Kutia 8: Martesa e fëmijëve për të ‘mbrojtur’ vajzën.....	45
Kutia 9: Shkolla është e ardhmja.....	47
Kutia 10: Martesa është e vetmja rrugë për të qenë bashkë.....	57
Kutia 11: Kur martesa është mundësia e vetme.....	59

1. Përmbledhje Ekzekutive

Martesa e fëmijëve - martesa zyrtare ose bashkimi jo-zyrtar i çdo personi nën moshën 18 vjeç - është një shkelje e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijës. Martesa e fëmijëve i vendos bashkëshortët fëmijë dhe në veçanti, vajzat e martuara, në rrezik ndaj dhunës në familje, abuzimit seksual, përdhunimit dhe mohimit të qasjes në arsim. Praktika ka ndikime jetëgjata në shëndetin fizik e mendor si dhe në mirëqenie, të cilat shtrihen deri në moshën madhore, kontribuon në rritjen e shkallës së vdekshmërisë foshnjore dhe amtare dhe shërben për të zgjatur vazhdimësinë e pabarazisë gjinore, varfërisë dhe përjashtimit social. Çdo vit, deri në 12 milionë vajza martohen ose hyjnë në një bashkim para moshës 18 vjeç; shifrat për djemtë janë shumë më të ulëta. Martesa e fëmijëve është një çështje jashtëzakonisht e ndërlikuar, që ndikohet dhe ndikon tek kushtet e caktuara shoqërore, ekonomike dhe kulturore në një vend të caktuar. Thënë kështu, në nivel botëror janë identifikuar një grup nxitësish kyç të martesës së fëmijëve, përfshirë: pabarazinë gjinore dhe normat kufizuese gjinore; varfërinë dhe përjashtimin social; zbatimin e dobët ose të paqëndrueshëm të legjislacionit; konfliktin dhe 'tronditje' të tjera; dhe zgjedhja e vetë adoleshentëve që të martohen. Sa i përket ndikimeve, vijueset janë identifikuar si rezultate të zakonshme të martesës së fëmijëve: braktisja e shkollës; amësi e hershme; prekja nga ndërlikimet e shtatëzanisë dhe lindjes, rreziqe më të larta të shtatëzanive të paparashikuara, ndërprerje të shtatëzanisë në kushte të pasigurta dhe çështje të tjera të lidhura me shëndetin seksual e riprodhues; cënueshmëri më të madhe ndaj dhunës me bazë gjinore se grupe të tjera vajzash dhe grash; theksimi i mëtejshëm i varfërisë dhe pabarazisë gjinore; dhe mirëqenie e ulët emocionale dhe psikologjike.

Martesa e fëmijëve në Shqipëri

Shqipëria ka një kornizë të fortë legjislative për të trajtuar martesën e fëmijëve, megjithatë, hulumtime të kryera më herët nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve kanë gjetur se ligjet nuk zbatohen në mënyrë efektive apo të vazhdueshme. Të dhënat zyrtare të vitit 2017 tregojnë se në 16.9% të martesave atë vit, bashkëshortja ishte nën 19 vjeç dhe në 0.5% të rasteve, bashkëshorti ishte nën 19 vjeç, por kjo nuk përfshin martesat e paregjistruara, ç'ka do të thotë se nuk dihet shkalla e vërtetë e përhapjes. Dihet edhe se normat e martesës së fëmijëve janë shumë më të larta në komunitetet Rome, por nuk ka të dhëna të sakta statistikore.

Hulumtimet cilësore të kryera deri më tani nga Observatori dhe agjenci të tjera kanë gjetur se martesa e fëmijëve në Shqipëri duket të jetë e lidhur me normat gjinore kufizuese dhe varfërinë e përjashtimin social; këto gjetje përsëritin ato në nivel botëror. Sa i përket ndikimeve, hulumtimet cilësore dhe të dhënat nga Anketa më e fundit Demografike dhe Shëndetësore (ADSh) (2008-2009) tregojnë se braktisja e shkollës, amësia e hershme dhe mungesa e autonomisë dhe fuqisë vendimmarrëse në familje janë të gjitha tipare të martesës së fëmijëve në Shqipëri. Megjithatë, kërkimet e deritanishme kanë qenë në shkallë të vogël, të bazuara në studime rasti dhe të kufizuara në një popullsi të caktuar (Romët dhe vendndodhje të caktuara).

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Ky studim cilësor u ndërмор për të mbledhur të dhëna mbi njohuritë, qëndrimet, bindjet dhe perceptimet, pritshmëritë sociale, stimujt, sanksionet dhe normat që lidhen me martesën e fëmijëve në Shqipëri. Mbi të gjitha, studimi mbulon si Romët ashtu edhe jo-Romët nga zona anembanë vendit. Gjetjet cilësore do të plotësojnë të dhënat sasiore mbi martesën e fëmijëve që pritet të dalin nga ADSh-ja e ardhshme (që po kryhet gjatë vitit 2018) dhe do të udhëheqin më mirë përfshirjen e çështjeve të martesës së fëmijëve në strategjitë dhe programet kombëtare të qeverisë dhe aktorëve joqeveritarë, si dhe agjencive të Kombeve të Bashkuara.

Metodologjia

Ky studim përdor një kornizë konceptuale për të kuptuar 'normat shoqërore', ashtu siç janë zhvilluar nga Bicchieri dhe të tjerët, për të studiuar martesën e fëmijëve si praktikë kolektive. Brenda këtij kuadri, Bicchieri dhe të tjerët propozojnë se parapëlqimet e njerëzve pro ose kundër martesës së fëmijëve janë ose të kushtëzuara - bazuar në atë që njerëzit e tjerë mendojnë dhe/ose bëjnë - ose të pakushtëzuara - bazuar në 'realitetet faktike' ose në bindjet morale vetjake.

Studimi përdori metoda cilësore, të përzgjedhura si mënyra më e mirë për të kapur të dhëna mbi njohuritë, qëndrimet, bindjet dhe perceptimet, pritshmëritë sociale, stimujt, sanksionet dhe normat që lidhen me martesën e fëmijëve. Diskutimet në grupet e fokusit u zhvilluan në Durrës, Korçë, Lezhë dhe Tiranë me të rinj (18-24 vjeç) dhe të rritur (25-50 vjeç) nga katër komunitete: romë dhe egjiptianë, që jetojnë faktikisht në komunitete të veçuara; romë dhe egjiptianë që jetojnë në komunitete të integruara; jo-romë që jetojnë në zona rurale; dhe jo-romë që jetojnë në zona urbane.

Hulumtuesit kryen edhe intervista me të rinj, që ishin martuar para moshës 18 vjeç, me të rritur, të cilët i kishin martuar fëmijët e tyre para moshës 18 vjeç dhe me informatorë kyç. Të gjitha komunitetet e përzgjedhura kishin shkallë të lartë varfërie, duke patur parasysh lidhjen midis varfërisë dhe martesës së fëmijëve.

Gjetjet

Gjetjet nuk janë përfaqësuese, por ofrojnë një 'fotografi' të asaj që mendojnë dhe besojnë njerëzit në komunitetet e mbuluara nga studimi rreth asaj çfarë nxit martesën e fëmijëve dhe ndikimet e saj mbi fëmijët.

Njohuritë

Pjesëmarrësit nga të gjitha grupet e popullsisë kishin njohuri për legjisllacionin lidhur me martesën e fëmijëve, përhapjen në komunitetet e tyre dhe ndikimet. Në veçanti, pjesëmarrësit folën gjerësisht për ndikimet negative të martesës së fëmijëve në barazinë gjinore, arsim, shëndetësi dhe mirëqenie, si dhe në varfëri. Duke gjykuar nga përmbajtja e diskutimit, kjo përfshiu komunitetet ku praktikohet martesa e fëmijëve.

Parapëlqimet pro dhe kundër martesës së fëmijëve

Të katër grupet folën për **parapëlqime të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara pro martesës së fëmijëve**, gjithësesi, këto **ishin më të forta tek pjesëmarrësit romë**. Kishte një numër të vogël dallimesh të konsiderueshme gjinore ose dallime midis grupmohave të ndryshme. Pjesëmarrësit folën **për frikën nga sanksionet shoqërore** (p.sh. thashethemet rreth 'nderit' të vajzës) si një faktor i rëndësishëm që i shtyn vajzat drejt martesës së hershme. Ndërsa njerëzit nga të katër grupet e popullsisë e përmendën këtë, kjo frikë nga sanksioni shoqëror ishte më e fortë tek pjesëmarrësit romë. Pjesëmarrësit nga të katër grupet folën gjithashtu për **varfërinë** si një 'realitet faktik', që i shtyn vajzat (dhe djemtë) në martesë, pavarësisht nëse ishin prindërit apo vetë adoleshentët që mernin vendimin për t'u martuar. Pjesëmarrësit romë folën gjerësisht edhe për **bindjet vetjake për rëndësinë e 'nderit'**, si dhe për faktin se martesa e fëmijëve shihet si një **zakon apo traditë e rëndësishme**.

Parapëlqimet kundër martesës së fëmijëve për pjesëmarrësit romë dhe jo-romë ishin të pakushtëzuara, d.m.th., të bazuara në realitetet 'faktike': që adoleshentët nuk ishin gati për martesë dhe/ose martesa e fëmijëve **ndikonte negativisht në arsim dhe punësim**. Gjithashtu, pjesëmarrësit jo-romë shprehën bindjet vetjake për **rëndësinë e 'vetë-realizimit'** dhe se si martesa e fëmijëve ishte pengesë për këtë.

Mundësitë në dispozicion

Pjesëmarrësit në hulumtim diskutuan se çfarë mundësish kishin në dispozicion të rinjtë në lidhje me martesën dhe gjetjet tregojnë se ato janë **tejet të kufizuara**, sidomos për vajzat dhe gratë e reja. Ky është rezultat i **mungesës së alternativave të mundshme ndaj martesës** (p.sh. pak mundësi punësimi), por edhe bindjes mbizotëruese se **martesa është e vetmja mundësi e pranueshme për gratë**, në disa raste duke përjashtuar të gjitha aktivitetet e tjera, përfshirë përfundimin e shkollimit. Kishte dallime në lidhje me pikën kur martesa bëhet mundësia më e mirë ose 'mundësia e vetme' për vajzën ose gruan. Për pjesëmarrësit romë nga komunitetet e veçuara, martesa bëhet mundësia më e mirë ose 'mundësia e vetme' për vajzat nga mesi i adoleshencës. Në dallim, disa pjesëmarrës jo-romë nga komunitetet urbane folën për universitetin dhe karrierën si mundësi të pranueshme për vajzat dhe gratë e reja, para martesës.

Përfundime

Gjetjet e këtij studimi zbulojnë se në Shqipëri, parapëlqimet e njerëzve pro martesës së fëmijëve, sidomos tek romët, janë të ndërlikuara dhe të rrënjosura thellësisht në një ndërthurje pritshmëri shoqërore, bindjesh vetjake të ngulitura thellë dhe realitetesh të jetesës në varfëri. Çdo politikë dhe përgjigje programatike ndaj martesës së fëmijëve duhet të marrë parasysh kompleksitetet e këtij realiteti. Ndërhyrjet që synojnë të nxitin ndryshime në qëndrime dhe sjellje do të kenë ndikim të paktë, nëse nuk adresohen edhe varfëria dhe përjashtimi social dhe nëse nuk krijohen mundësi përtej martesës për vajzat dhe gratë e reja. Këto ndryshime do të duhet të ndodhin në sferën e normave shoqërore të lidhura me gjininë dhe çfarë konsiderohen drejtime të pranueshme të jetës për gratë, si dhe në drejtim të përmirësimit të qasjes në arsimin e nivelit dytësor dhe më tej, si dhe përmirësimin e kushteve ekonomike dhe mundësive të punësimit.

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Rekomandime

Rekomandimi i përgjithshëm që rrjedh nga ky studim është se qeveria duhet të adresojë martesën e fëmijëve nëpërmjet masave politike në nivel qendror dhe lokal, duke përcaktuar ndërhyrjet, buxhetet e lidhura, si dhe rolet dhe përgjegjësitë e entiteteve të ndryshme publike. Këto masa politike duhet t'i qasen çështjes nga këto drejtime:

Sensibilizim dhe edukim

Puna për ndryshimin e qëndrimeve dhe normave rreth martesës së fëmijëve kërkon përpjekje të qëndrueshme dhe të vazhdueshme në nivel komuniteti, duke angazhuar një sërë aktorësh, përfshirë mësuesit, punonjësit e shëndetësisë, punonjësit socialë, krerët e komuniteteve, e të tjerë. Të gjithë duhet të sensibilizohen dhe të trajnohen për rolet dhe përgjegjësitë e tyre. Puna për fuqizimin e vajzave për të kundërshtuar pabarazinë gjinore dhe për të vlerësuar mundësi alternative jete është thelbësore, ashtu siç është puna me djemtë për t'i inkurajuar që të dalin kundër martesës së fëmijëve. Shkollat kanë një rol aktiv në rritjen e ndërgjegjësimit tek prindërit dhe nxënësit rreth martesës së fëmijëve dhe për të ndihmuar në ndryshimin e qëndrimeve.

Krijimi i alternativave për fëmijët, përveç martesës

Që ndryshimi të jetë afatgjatë, nevojitet që prindërit dhe adoleshentët të vlerësojnë alternativa të tjera përveç martesës, veçanërisht për vajzat. Sigurimi i mundësive më të mëdha për arsim përtej nivelit të detyrueshëm dhe për punësim e strehim janë të rëndësishme në këtë drejtim, ashtu si edhe ofrimi i ndihmës praktike për t'u mundësuar vajzave të qëndrojnë në shkollë ose të kenë qasje në arsimin jo-formal. Përmirësimi i qasjes në informacione për planifikimin familjar është po ashtu me rëndësi jetike.

Parandalim dhe mbështetje për fëmijët e prekur nga martesa e fëmijëve

Krijimi i mekanizmave efektive të raportimit dhe trajnimit i ofruesve të shërbimit të linjës së parë, përfshirë policinë, për të njohur shenjat e mundshme paralajmëruese të martesës së detyruar ose martesës së fëmijëve si dhe për të ofruar mbështetje, janë të rëndësishme për të parandaluar martesat e fëmijëve. Për adoleshentët të cilët janë të martuar tashmë, ofrimi i shërbimeve të përshtatshme mund të ndihmojë në zbutjen e disa prej ndikimeve negative të martesës së fëmijëve. Këto përfshijnë: promovimin e shansit të dytë për arsim për adoleshentët e martuar; ndihmë në gjetjen e punës dhe strehimit; mbështetje prindërore për prindërit e rinj; dhe parandalimin e shtatzënisë tek adoleshentët.

2. Të kuptojmë martesën e fëmijëve

UNFPA-ja, UNICEF-i dhe agjenci të tjera të OKB-së e përkufizojnë martesën e fëmijëve si çdo martesë ose bashkim (i regjistruar ose jo) midis dy njerëzve, ku një ose të dy partnerët janë nën moshën 18 vjeç.¹⁶ Kjo përfshin vendet ku moshë ligjore e martesës është vendosur nën 18 vjeç.

Martesat e fëmijëve përbëjnë shkelje të të drejtave të njeriut dhe të të drejtave të fëmijës. Kjo pasi fëmijët - përcaktuar si cilido person nën moshën 18 vjeç sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijës (KDF) - nuk gjykohen aq të pjekur sa të japin pëlqimin e tyre 'të plotë dhe të lirë' për martesë, siç pranohet në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut.^{17,18} Ndërkohë që ka edhe djem që martohen kur janë ende fëmijë, në nivel botëror, martesa e fëmijëve prek kryesisht vajzat, në mënyrë sasiore, por edhe cilësore. Për vajzat, martesa zakonisht shënon fundin e fëmijërisë; rëndom, atyre u ndalohej të vazhdojnë shkollimin, pritjet që të marrin një ngarkesë të plotë pune në familje, shpesh përballesh me presionin për të mbetur shtatzëna sa më shpejt të jetë e mundur, mund të përjetojnë ndërlikime në shtatzëni dhe gjatë lindjes, janë në rrezik të dhunës në familje, abuzimit seksual dhe dhunimit, dhe mund të jenë të izoluar nga miqtë dhe familja e tyre e origjinës. Kjo praktikë ka ndikime jetëgjata në shëndetin fizik e mendor dhe në mirëqenie, të cilat shtrihen deri në moshën madhore, kontribuon në shkallë më të lartë të vdekshmërisë foshnjore dhe amësores dhe kontribon në zgjatjen e vazhdimësisë së pabarazisë gjinore, varfërisë dhe përjashtimit social.¹⁹

Një dukuri botërore dhe rajonale

Martesa e fëmijëve është një dukuri botërore. Shkalla e përhapjes është më e lartë në vendet e Afrikës Sub Sahariane dhe Azisë Jugore, por praktika prek fëmijë në çdo rajon, përfshirë Evropën. Në nivel botëror, UNICEF-i vlerësoi se, që nga viti 2014, një në pesë vajza të moshës 15-19 vjeç ishin faktikisht të martuara ose jetonin bashkë me një partner mashkull.²⁰ Ndërsa ka patur përparime të ndjeshme në uljen e shkallës së përhapjes së martesës së fëmijëve në të gjithë botën, gjatë dhjetë viteve të fundit, UNICEF-i vlerëson se, ende çdo vit, një total prej 12 milion vajzash martohen para moshës 18 vjeç. Nëse ky ritëm vazhdon deri më 2030-tën, më shumë se 150 milion vajza të tjera do të martohen para ditëlindjes së tyre të 18^{të}.²¹

Për rajonin e 'Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore', e cila përfshin Shqipërinë, UNFPA jep një shifër prej 11% të grave të moshës 20-24 vjeç të martuara ose në bashkim para moshës 18 vjeç (2001-2011).²² Hulumtimet e UNFPA-së për 12 vende të Ballkanit, Kaukazit, Azisë Qendrore, si dhe Turqisë²³ e Ukrainës, gjetën ndryshime të rëndësishme në shkallët e përhapjes nëpër rajon: nga 23% në Turqi në 0.9% në Kazakistan.²⁴

Megjithatë, normat e përhapjes nuk përfshijnë tërë pamjen. Shumica e martesave të fëmijëve janë në fakt bashkime të hershme dhe nuk janë të regjistruara zyrtarisht, që do të thotë se shpesh ato nuk shfaqen në statistikat kombëtare zyrtare për martesën.²⁵ Të dhënat e mbledhura në Anketat Demografike dhe Shëndetësore (ADSh)²⁶ dhe Anketat e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë të UNICEF-it (AGTSh) arrijnë të nxjerrin bashkimet e paregjistruara, por, sërish, mund të mos matin shtrirjen e vërtetë të praktikës, pasi mund të ketë mospërputhje, të cilat e vështirësojnë krahasimin e kryqëzuar, përfshirë kuptimet e ndryshme të asaj se çfarë përbën faktikisht martesë dhe/ose bashkim. Clark dhe të tjerët vërejnë se '... nëse një adoleshente e raporton veten të martuar varet nga interpretimi që ai/a jo i bën martesës, e cila në shumë kultura është një rregullim kompleks, ndonjëherë i paqëndrueshëm, i karakterizuar nga dykuptimësia dhe luhajtje të mëdha.'²⁷

Martesa e fëmijëve është një çështje tejet e ndërlikuar. Ajo është një praktikë që nuk është e njëtrajtshme dhe jo vetëm ndikohet nga, por edhe ndikon në kushtet e caktuara sociale, ekonomike dhe kulturore në një vend të caktuar. Gjithashtu, martesa e fëmijëve ndikohet fuqishëm nga qëndrimet kulturore, shoqërore dhe fetare ndaj seksualitetit, ndaj marrëdhënieve prind-fëmijë, ndaj roleve gjinore dhe moshës së përshtatshme për të patur fëmijë. Vendimi për t'u martuar para moshës 18 vjeç, qoftë nëse merret nga prindërit apo nga vetë adoleshenti ose adoleshentja, nuk do të merret thjesht dhe vetëm për një arsye: ai do të merret nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm të ndërthurur, që formësojnë edhe bindjet rreth moshës që vlerësohet e përshtatshme për martesë, edhe realitetet praktike ekonomike dhe shoqërore.²⁸

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Në çdo analizë, mund të jetë gjithashtu e vështirë të ndahen faktorët që nxitin praktikën nga ata që nxiten të vazhdojnë prej saj. Për shembull, në Evropë, varfëria dhe përjashtimi social janë faktorë kyç rreziku për martesën e fëmijëve dhe, në të njëjtën kohë, martesa e fëmijëve shërben për të zgjatur vazhdimësinë e varfërisë dhe përjashtimit social dhe për ta përcjelle atë nga brezi në brez.²⁹

Me këtë në mendje, faktorët kryesorë që nxitin martesën e fëmijëve dhe pasojat e kësaj praktike, siç janë identifikuar në nivel botëror, rajonal dhe kombëtar, janë si në vijim:

- Pabarazia gjinore, përfshirë mungesën e rëndësisë që i kushtohet arsimit të vajzave, dëshira për të kontrolluar seksualitetin e grave dhe vajzave (shpesh për shkak të shqetësimeve rreth 'nderit') dhe martesa që shihet si 'mundësia e vetme' për gratë dhe vajzat;³⁰
- Varfëria dhe përjashtimi social, ku familjet e martojnë vajzën për të lehtësuar tryshninë mbi burimet në familje dhe adoleshentët që pranojnë ose zgjedhin të martohen për t'i shpëtuar varfërisë dhe përjashtimit social;³¹
- Zbatim i dobët ose i paqëndrueshëm i legjislacionit, p.sh. ligje që lejojnë martesën në moshë të re me leje gjyqësore ose prindërore;³²
- Konflikti dhe 'tronditjet' (si fatkeqësitë natyrore), ku prindërit i martojnë vajzat për t'i 'mbrojtur', veçanërisht nga dhuna seksuale;³³ dhe
- Adoleshentët që zgjedhin të martohen.

Martesa në adoleshencë mund të ketë ndikim të thellë negativ në shëndetin, sigurinë dhe perspektivat e ardhshme të një të reje. Këto përfshijnë:

- Mëmësi e hershme, ku adoleshentët e martuara shpesh kanë pak ose aspak kontroll mbi atë nëse duhet të mbeten shtatzënë dhe kur;³⁴
- Ndërlikime të shëndetit të nënës dhe foshnjës, pasi trupi i adoleshentes nuk është fizikisht i pjekur për shtatzëni dhe lindje;³⁵
- Rrënjosje të varfërisë dhe përjashtimit social;³⁶
- Braktisje të shkollës;³⁷
- Zgjatja e vazhdimësisë së pabarazisë gjinore;³⁸
- Dhunë me bazë gjinore, ku vajzat e martuara janë në rrezik shumë më të lartë të dhunës në familje nga bashkëshortët dhe familjet e tyre, se sa vajzat e pamartuara apo gratë e martuara në moshë më të madhe;³⁹ dhe
- Mirëqënie e dobët emocionale dhe psikologjike.^{40,41}

Martesa e fëmijëve në Shqipëri

Martesa e fëmijëve mbetet një dukuri e pa hulumtuar mirë në Shqipëri. Të dhënat statistikore të Institutit të Statistikave (INSTAT) dhe ato më të fundit të ADSH-së (2008-2009), si dhe numri i vogël i studimeve cilësore që janë kryer, përfshirë ato nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, tregojnë se:

- a) martesa e fëmijëve është një çështje e rëndësishme, por e eksploruar pak, që prek kryesisht vajzat nga grupe të ndryshme shoqërore;
- b) nxitet kryesisht nga pabarazia gjinore, si dhe nga varfëria e përjashtimi social; dhe c) ka një sërë efektesh të dëmshme.

Shqipëria ka një kornizë të fortë legjislative për të mbrojtur adoleshentët nga martesat e fëmijëve. Megjithatë, në praktikë, ligjet në fuqi nuk zbatohen në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme.


Sipas Kodit aktual të Familjes (2003), mosha minimale për martesë është 18 vjeç për burrat dhe gratë (neni 7). Kodi i Familjes deklaron se: ‘...martesa lidhet para nëpunësit të gjendjes civile me pëlqimin e lirë të bashkëshortëve të ardhshëm’ (neni 8). Martesa kërkon praninë e të dy bashkëshortëve dhe nuk mund të lidhet nga palë të treta, si p.sh. prindërit e bashkëshortëve të ardhshëm.

Gjykata, në vendin ku do të lidhet martesë, mundet të lejojë martesën para moshës minimale ligjore, për shkakë me rëndësi. Kjo vendoset rast pas rasti. Hulumtimi i ndërmarrë nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve zbuloi se gjykatat lejonin martesën për vajzat para moshës 18 vjeç për arsye të: shtatzënisë, lindjes së fëmijës dhe bashkëjetesës. Gjetjet e hulumtimit të Observatorit tregojnë se shpesh gjykatat nuk i marrin këto vendime në interesin më të mirë të fëmijëve në fjalë ose në bazë të një shqyrtimi të hollësishëm të çështjes.⁴²

Kodi Penal i Shqipërisë përcakton se mosha e pëlqimit për marrëdhënie seksuale është 14 vjeç. Çdo aktivitet seksual me një fëmijë nën 14 vjeç klasifikohet si vepër penale.⁴³ Kodi Penal përmban edhe një dispozitë që dënon shtrëngimin për të lidhur martesë a bashkëjetesë (neni 130). Në Shqipëri, nuk ka patur studime për martesat e detyruara dhe nuk ka patur asnjë përpjekje për të lidhur martesën e fëmijëve me shtrëngimin për martesë apo bashkëjetesë.⁴⁴

Sipas INSTAT, në vitin 2017, 16.9% e martesave të regjistruara përfshinin një bashkëshorte nën 19 vjeç dhe 0.5% përfshinin një bashkëshort nën 19 vjeç. Analiza e të dhënave të INSTAT tregon se ka një prirje të dukshme të rritjes së moshës së martesës në Shqipëri.⁴⁵

MARTESAT E REGJISTRUARA TË VAJZAVE DHE DJEMVE (NË %)



Burimi: Shifrat e INSTAT, Martesat sipas gjinisë dhe grupmoshave, 2007-2017, Llogaritjet e autorit

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Të dhënat dëshmojnë se martesat e regjistruara, që përfshijnë vajzat nën 18 vjeç, janë rritur nga 10 në vitin 2016, në 34 raste në vitin 2017, ndërsa numri i djemve të martuar nën 18 vjeç mbetet 0. Megjithatë, këto të dhëna zyrtare nuk japin një pamje të saktë të përhapjes së martesës së fëmijëve në Shqipëri, pasi ato evidentojnë vetëm martesat e regjistruara në shtet. Ato nuk regjistrojnë çiftet që bashkëjetojnë. Të dhënat e hollësishme më të fundit, që përfshijnë bashkimet e paregjistruara, vijnë nga ADSh, e realizuar në 2008-2009. Ato zbuluan se:

- 9.6% e grave dhe 0.8% e meshkujve të moshës 20-24 vjeç ishin martuar para ditëlindjes së tyre të 18-të;
- 7.4% e vajzave të moshës 15-19 vjeç dhe 1.0% e djemve të moshës 15-19 vjeç ishin, në kohën e anketimit, të martuar ose jetonin në bashkim.⁴⁷

Nga ana tjetër, të dhënat nga ADSh dhe INSTAT nuk përfshijnë informacione mbi përhapjen e martesës së fëmijëve tek minoritetet rome dhe egjiptiane (këtej e tutje referuar bashkarisht si 'romë'), ku besohet se shkallët e përhapjes janë më të larta.

Shifrat zyrtare më të fundit për numrin e romëve në popullsinë shqiptare janë shumë të vjetra, pasi vijnë nga regjistrimi i popullsisë i vitit 2001. Këshilli i Evropës vlerëson se popullsia rome mund të jetë midis 80,000 dhe 150,000 vetë, në një popullsi të përgjithshme prej 3.2 million banorësh.⁴⁸ Egjiptianët janë një grup etnik i veçantë, që deklaroi se janë pasardhës të njerëzve nga Egjipti, që u vendosën në Shqipëri në të kaluarën. Qeveria shqiptare nuk i njeh ata si grup etnik i veçantë, që do të thotë se, ndryshe nga grupet e tjera minoritare, përfshirë romët, ata nuk mbrohen me Kushtetutë nga diskriminimi. Nuk ka vlerësime të besueshme të numrit të egjiptianëve në Shqipëri.⁴⁹ Shkallët e varfërisë dhe të papunësisë janë shumë më të larta tek romët dhe egjiptianët, krahasuar me grupe të tjera në Shqipëri dhe, shpesh, ata kanë kushte shumë të këqija jetese. Gjithashtu, të dy grupet diskriminohen në mënyrë të konsiderueshme nga shoqëria e gjerë.⁵⁰

Një raport hulumtues i Bankës Botërore, i publikuar në vitin 2005, raportonte se në vitin 2002-2003, moshën mesatare të martesës për gratë rome ishte 15.5 vjeç, më e ulët se çdo grup tjetër etnik në Shqipëri; moshën mesatare të martesës së grave në popullatën e përgjithshme ishte 23.3 vjeç.⁵¹ Një anketim i realizuar me romët (madhësia e kampionit: 661), në vitin 2011, zbuloi se 31% e vajzave Rome të moshës 13-17 vjeç ishin të martuara.⁵² Edhe burrat romë duket se martohen të rinj, por në moshë më të madhe se vajzat rome. Studimi i Bankës Botërore, i cituar më lart, tregon se moshën mesatare të martesës për meshkujt romë ishte 18.2 vjeç (në 2002-2003), krahasuar me 28.3 vjeç për meshkujt në popullatën e përgjithshme.⁵³ Megjithatë, këto studime nuk janë statistikiq përfaqësuese dhe të dhënat tashmë janë të vjetëruara. Fondacioni për Shoqërinë e Hapur në Shqipëri zhvilloi një regjistrim të popullsisë dhe banesave rome në vitin 2014, por kjo nuk ofroi të dhëna treguese për martesat e hershme ose ato të fëmijëve.

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve ka nxjerrë tre botime për martesën e fëmijëve, duke filluar me dukurinë në popullsinë rome. Ky studim zbuloi se martesa e fëmijëve ishte e lidhur me mungesën e rëndësisë që i kushtohej arsimit të vajzave dhe rëndësinë që i jepej mbrojtjes së 'nderit' të vajzës, por se varfëria ishte gjithashtu një faktor i rëndësishëm.⁵⁴

Hulumtimet e Observatorit vazhduan me studime rastesh të martesës së fëmijëve në komunitetet jo-rome në Korçë dhe Vlorë. Këto studime vlerësuan statusin e grave, që kanë përjetuar martesë të hershme dhe pasojat e saj në jetën socio-ekonomike, duke identifikuar një lidhje midis mungesës së arsimit dhe martesës së fëmijëve.⁵⁵ Botimi i tretë mori në shqyrtim aspektet ligjore dhe analizoi vendimet e marra nga gjykatat për kërkesat për martesë të fëmijëve në një periudhë pesëvjeçare, së bashku me aspektet sociale të martesës së fëmijëve.⁵⁶

UNFPA ndërmori një projekt hulumtues cilësor në shkallë të vogël për martesën e fëmijëve në Shqipëri, të plotësuar me një shqyrtim dokumentesh dhe prodhoi një dokument me faktet e rëndësishme për vendin' (2012).⁵⁷ Ky hulumtim zbuloi se shkalla e martesës së fëmijëve ishte e lartë në komunitetet e largëta malore, si dhe në minoritetin rom dhe se praktika nxitej nga rolet tradicionale gjinore, varfëria dhe përjashtimi social.

Edhe pse të kufizuara, gjetjet e këtyre studimeve sigurojnë njohuri të vlefshme për dukurinë e martesës së fëmijëve në Shqipëri. Gjetjet e studimit aktual do t'i shtohen këtij grupi në rritje hulumtimesh, duke zgjeruar njohuritë tona për atë çfarë i shtyn prindërit dhe adoleshentët në komunitetet rome dhe komunitete të tjera të prekura nga varfëria, të kërkojnë ose të pranojnë martesën para moshës 18 vjeç.⁵⁸

3. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i këtij studimi cilësor ishte mbledhja e informacionit mbi njohuritë, qëndrimet, bindjet dhe perceptimet dhe shqyrtimi i normave tradicionale dhe sociale në lidhje me martesën e fëmijëve mes romëve dhe jo-romëve në komunitete të ndryshme të Shqipërisë.

Ky studim është një ndërhyrje e nevojshme në kohën e duhur dhe ofron një analizë që shqyrton në thellësi dukurinë e martesës së fëmijëve në Shqipëri. Një Anketim Demografik dhe Shëndetësor (ADSh) po zhvillohet në Shqipëri dhe ky studim cilësor do të mbështesë dhe pasurojë të dhënat sasiore të ADSh-së. Së bashku, të dy studimet do të sigurojnë një bazë të përmirësuar provash mbi dukurinë e martesës së fëmijëve në Shqipëri. Studimi cilësor ofron njohuri të vlefshme për atë që njerëzit mendojnë dhe besojnë në lidhje me martesën e fëmijëve dhe ndikimin e saj tek fëmijët, nëse martesa e fëmijëve në Shqipëri mbështetet nga parapëlqimet e kushtëzuara apo të pakushtëzuara si dhe deri në ç'masë mbështetet nga pritshmëritë shoqërore. Gjetjet dhe rekomandimet e studimit do të orientojnë më mirë përfshirjen e çështjeve të martesës së fëmijëve në strategjitë dhe programet e qeverisë dhe aktorëve joqeveritarë në vend, si dhe në ato të agjencive të OKB-së. Gjetjet do t'i ndihmojnë aktorët të kuptojnë më mirë çështjen e martesës së fëmijëve dhe të ndërtojnë një bazë të përbashkët për të ndërmarrë veprime.

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Ky studim udhëhiqet nga objektivat e mëposhtme:

1. Të shqyrtojë njohuritë, qëndrimet, bindjet, pritshmëritë, bindjet rreth mundësive, perceptimet dhe parapëlqimet rreth martesës së fëmijëve në grupet e studiuara të popullsisë.
2. Të shqyrtojë nëse martesa e fëmijëve nxitet/ përforcohet nga normat shoqërore në grupet e popullsisë në studim, apo nëse bën pjesë në një kategori tjetër të praktikës kolektive (p.sh.: përgjigje logjike, zakon, rregull moral, normë përshkruese).
3. Të shqyrtojë dallimet gjinore brenda secilit grup popullate në studim në lidhje me njohuritë, qëndrimet, bindjet, pritshmëritë, bindjet rreth mundësive, perceptimet dhe parapëlqimet që lidhen me martesën e fëmijëve dhe implikimet gjinore të martesës së fëmijëve (ndikim të caktuar mbi djemtë dhe vajzat).

Me kërkesë të UNICEF-it dhe UNFPA-së, ky studim është konturuar nga korniza konceptuale e 'normave sociale' të Bicchierit dhe të tjerëve dhe si këto përcaktojnë vendimmarrjen në lidhje me praktikën kolektive, siç është martesa e fëmijëve. Kjo kornizë konceptuale ka udhëhequr zhvillimin e pyetjeve hulumtuese, instrumenteve të mbledhjes së të dhënave dhe analizës së të dhënave.

Koncepti i 'normës shoqërore' të Bicchierit dhe të tjerëve qendërzohet në idenë se njohuritë, qëndrimet dhe parapëlqimet e njerëzve ndaj një praktike kolektive ndikohen fuqishëm nga ajo që njerëzit e tjerë rreth tyre bëjnë dhe nga ajo që ata besojnë se të tjerët mendojnë se duhet bërë. Kështu, në lidhje me martesën e fëmijëve, njerëzit në një bashkësi të caktuar mund të thonë se do të parapëlqenin që vajzat e tyre (dhe djemtë) të martohen herët, sepse besojnë se: a) shumica e prindërve të tjerë në atë bashkësi i martojnë fëmijët e tyre sa janë të rinj (pritsmëri empirike); dhe b) se shumica e prindërve të tjerë dhe anëtarë të rëndësishëm të komunitetit besojnë se ata duhet t'i martojnë vajzat e tyre (dhe djemtë) herët (pritsmëri normative). Në këtë mënyrë, parapëlqimet e prindërve për martesën e fëmijëve janë të kushtëzuara nga pritshmëritë sociale, pra çfarë besojnë ata se bëjnë dhe mendojnë njerëzit e tjerë, në vend të asaj se çfarë besojnë ata vetë. Në kontekstet ku martesa e fëmijëve mbështetet nga pritshmëritë sociale në këtë mënyrë, Bicchieri dhe të tjerët e përkufizojnë praktikën si një 'normë shoqërore', pra 'një praktikë kolektive, e mbështetur nga pritshmëritë empirike dhe normative dhe nga parapëlqimet e kushtëzuara nga të dyja këto pritshmëri'. Sanksionet e vërteta ose të përfytyruara (për shembull, përjashtimi nga anëtarët e tjerë të komunitetit) për shkeljen e normave shoqërore mund të veprojnë për t'i përforcuar ato më tej.

Bicchieri dhe të tjerët vërejnë gjithashtu ekzistencën e parapëlqimeve të pakushtëzuara në lidhje me martesën e fëmijëve, të cilat nuk varen nga ajo që njerëzit e tjerë në një bashkësi bëjnë apo mendojnë. Parapëlqimet e pakushtëzuara mund të bazohen në atë që prindërit mendojnë se është më e mira për ata vetë, p.sh. 'një gojë më pak për të ushqyer' në shtëpi, kur e marton fëmijën (një 'parapëlqim me interes vetjak') ose atë që mendojnë se është më e mira për fëmijën e tyre, p.sh. duke e martuar vajzën për të mbrojtur emrin e mirë të saj (një 'parapëlqim në interes të tjetrit'). Parapëlqimet e pakushtëzuara mund të bazohen po ashtu në 'rregulla morale', kur prindërit mbështesin martesën e fëmijëve, sepse mendojnë se është gjëja moralisht e drejtë për të bërë (për shembull, sepse besojnë se vajzat/gratë duhet të jenë të virgjëra kur martohen). Këto parapëlqime të pakushtëzuara mbështeten nga ajo që Bicchieri dhe të tjerët i quajnë 'bindje jo-shoqërore', dmth. që nuk janë të varura nga pritshmëritë sociale (çfarë po bëjnë të gjithë të tjerët dhe/ ose hamendësohet se mendojnë). 'Bindjet jo-shoqërore' mund të jenë normative ('Besoj se vajza ime duhet të martohet e re, sepse kjo është gjëja moralisht e drejtë për të bërë') ose faktike ('Gjendja jonë financiare do të jetë më mire, nëse e martojmë vajzën').

Brenda kornizës së Bicchierit dhe të tjerëve, mundësitë e zgjedhjes përbëhen nga ‘moria e kurseve të mundshme të veprimit ... nga ku dikush mund të zgjedhë realisht’ në mënyrë që të kënaqë parapëlqimet e veta (qofshin ato të kushtëzuara apo të pakushtëzuara); po ashtu, ‘mundësitë e njerëzve janë të kufizuara’. Për shembull, ato mund të jenë të kufizuara nga ‘mundësitë e pakta për të fituar para’, kështu që një nga mundësitë për të përmbushur parapëlqimet e tyre për përmirësimin e mirëqenies financiare të të gjithë familjes, do të ishte të martonin njërin nga fëmijët. Analiza e bindjeve të tyre rreth mundësive të zgjedhjes përfshin idenë se shtyrja e martesës thjesht nuk mund të jetë një mundësi, sepse prindërit besojnë se, nëse vajzat e tyre nuk martohen të reja, ato do të kenë marrëdhënie seksuale, diçka që prindërit e konsiderojnë të papranueshme.

Së fundi, Bicchieri dhe të tjerët deklarojnë se pasi vlerësohet nëse parapëlqimet pro ose kundër martesës së fëmijëve në një grup të caktuar të popullsisë janë të kushtëzuara ose të pakushtëzuara, atëherë është e mundur të përcaktohet nëse martesa e fëmijëve përbën një normë shoqërore në atë grup të popullsisë, apo jo. Për ta përmbledhur, Bicchieri dhe të tjerët e përkufizojnë një normë shoqërore si ‘një praktikë kolektive, të mbështetur nga pritshmëri empirike dhe normative dhe nga parapëlqime të kushtëzuara mbi të dyja këto pritshmëri’. Ose, për ta thënë ndryshe, një normë shoqërore është: ‘Një rregull që njerëzit e ndjekin, sepse besojnë se të tjerët e ndjekin atë (pritsshmëri empirike) dhe që të tjerët mendojnë se duhet ndjekur (pritsshmëri normative)’.⁶²

Nëse një praktikë kolektive, si martesa e fëmijëve, nuk mund të karakterizohet si normë shoqërore, atëherë Bicchieri dhe të tjerët propozojnë kategori alternative të praktikës kolektive, të përmbledhura në tabelën më poshtë.

Tabela 1: Martesa e fëmijëve si praktikë kolektive

	Përkufizim	Shembuj
Përgjigje racionale	Një rregull që njerëzit e ndjekin, sepse arsyetojnë se përmbush maksimalisht parapëlqimet e tyre	‘Do ta martoj vajzën të re, sepse është barrë financiare’
Zakon	Një rregull që njerëzit e ndjekin pak a shumë verbërisht, por që do të braktisej, nëse nuk është më në interesin e tyre	‘Do ta martoj vajzën të re, sepse është tradita jonë’
Rregull moral	Një rregull që njerëzit e ndjekin, sepse besojnë se duhet ndjekur (bindje vetjake normative)	‘Do ta martoj vajzën të re, sepse besoj se vajzat duhet të jenë të pastra dhe të dëlira’
Normë përshkruese	Një rregull që njerëzit e ndjekin, sepse besojnë se të tjerët e ndjekin (pritsshmëri empirike)	‘Do ta martoj vajzën të re, sepse besoj se të gjithë të tjerët i martojnë vajzat e tyre në moshë të re’
Normë shoqërore	Një rregull që njerëzit e ndjekin, sepse besojnë se të tjerët e ndjekin (pritsshmëri empirike) dhe se të tjerët mendojnë se duhet ndjekur (pritsshmëri normative)	‘Do ta martoj vajzën të re, sepse të gjithë mendojnë se vajzat duhet të martohen të reja dhe unë do të dënohem nga opinioni, nëse nuk e bëj’

Burim: Përshtatur nga Bicchieri, Cristina, Ting Jiang, dhe Lindemans, Jan Willem: A Social Norms Perspective on Child Marriage: The General Framework, DRAFT i komisionuar dhe për t’u botuar nga UNICEF, Filadelfia, Laboratori i Etikës së Sjelljes, Universiteti i Pensilvanisë, 2014, tabela 4, fq.14-15.

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

4. Metodologjia

Qasja metodologjike

Qasje cilësore

Gjetjet e këtij studimi bazohen në hulumtime cilësore, specifkisht: diskutime të grupeve të fokusit (DGF), intervista individuale (II) dhe intervista me informatorë kyç (IIK).

Metodat cilësore ishin zgjedhja më logjike për të kapur të dhëna mbi normat shoqërore, njohuritë, qëndrimet dhe perceptimet në lidhje me martesën e fëmijëve. Përveç kësaj, një studim sasior do të kishte përsëritur pa dobi gjetjet nga ADSH e ardhshme. Diskutimet e grupeve të fokusit dhe intervistat iu lejuan pjesëmarrësve në hulumtim të shprehnin veten më lirisht dhe në mënyrë më intuitive se një anketim me pyetje të mbyllura dhe iu mundësuan atyre të shqyrtonin çështjet dhe t'i vlerësonin pikëpamjet e tyre përmes bisedës me të tjerët. Kjo ka siguruar të dhëna të pasura për qëndrimet në nivel komuniteti. Studimet e mëparshme nga UNFPA dhe Observatori janë përqendruar tek njerëzit e prekur drejtpërdrejt nga martesa e fëmijëve ose që punojnë për këtë çështje, duke ofruar njohuri të rëndësishme nga këto këndvështrime mbi nxitësit dhe ndikimet e martesës së fëmijëve në grupe të caktuara (romët⁶³ dhe vajzat që jetojnë në dy qarqe të vendit⁶⁴), si dhe duke theksuar dobësitë e reagimit të sistemit ligjor.⁶⁵ Me studimin e tanishëm, kapja e pikëpamjeve të njerëzve që nuk preken drejtpërdrejt nga martesa e fëmijëve ofron njohuri në atë se cilat aspekte të njohurive, qëndrimeve dhe parapëlqimeve të anëtarëve të komunitetit më të gjerë po ndihmojnë për të mbështetur praktikën (ose anasjelltas, po ndihmojnë në reduktimin e saj). Përveç kësaj, studimi kap pikëpamjet e njerëzve që jetojnë në qarqe të ndryshme të vendit dhe nxjerr në dritë dallime të mëdha në qëndrimet (pro dhe kundër martesës së fëmijëve) midis komuniteteve romë dhe jo-romë. Gjetjet do të jenë të paçmueshme për politikëbërësit dhe punonjësit e programeve që kërkojnë të projektojnë ndërhyrje efektive për të ulur më tej mbështetjen ndaj martesës së fëmijëve në Shqipëri.

Vendet e mbledhjes së të dhënave

Hulumtimet e mëparshme cilësore nga UNFPA dhe Observatori treguan se martesa e fëmijëve në Shqipëri është e lidhur fort me përkatësinë në komunitetin rom, varfërinë dhe jetesën në një komunitet rural ose urban të marginalizuar.⁶⁶ Prandaj, për përzgjedhjen e vendeve për mbledhjen e të dhënave, u konsiderua triangulimi i tre dimensioneve: shkalla e varfërisë⁶⁷ (e lartë), përqendrimi i popullsisë romë⁶⁸ (e lartë) dhe vendndodhja gjeografike (veri/jug/qendrore, zonë kufitare/jo kufitare).

Në secilin prej qarqeve të identifikuar (Durrës, Korçë, Lezhë dhe Tiranë), u përzgjedhën dy ose tre bashki, duke u bazuar në përqendrimin e romëve (të lartë), shkallën e varfërisë (të lartë) dhe nëse bashkia gjendet në një zonë rurale apo në një zonë urbane të populluar nga njerëz të marginalizuar në aspektin social.

Popullatat e synuara

Grupet e fokusit dhe pjesëmarrësit në intervista u përzgjedhën nga grupet e mëposhtme të popullsisë brenda secilës bashki. Hulumtimet e mëparshme kanë treguar se brenda grupeve të mëposhtme praktikohet martesa e fëmijëve.

1. Romë dhe egjiptianë që jetojnë nëkomunitete të veçuara
2. Romë dhe egjiptianë që jetojnë në komunitete të integruara
3. Jo-romë që jetojnë në zona rurale
4. Jo-romë që jetojnë në zona urbane të margjinalizuara

Hulumtimet e gjera në nivel botëror dhe vendor tregojnë se përjashtimi social është një faktor i fortë që nxit martesën e fëmijëve.⁶⁹ Për këtë arsye, kategoria ‘romë’ (e cila përfshin edhe egjiptianët [shih diskutimin në Pjesën 2]) u zbërthye më tej në romë që jetojnë në komunitete të veçuara dhe të integruara, me arsyetimin se ata që jetojnë në komunitete të veçuara ka gjasa të përjetojnë një shkallë më të lartë përjashtimi social, se ata që jetojnë në komunitete të tjera. U parashikua që krahasimi i këtyre dy grupeve do të zbulojë dallime në njohuri, qëndrime, bindje, pritshmëri, besime rreth mundësive, perceptime dhe parapëlqime (së bashku me informacione mbi praktikatat e tyre vetjake dhe komunitare) në lidhje me martesën e fëmijëve.

Metodat e mbledhjes së të dhënave

Diskutimet e grupeve të fokusit

U zhvilluan gjithsej 34 DGF të përbërë nga një minimum prej 5 pjesëmarrësish deri në një maksimum prej 12 pjesëmarrësish. DGF-të u kryen veçmas me pjesëmarrësit romë dhe ata jo-romë në secilin vend të mbledhjes së të dhënave:

- me vajza të reja të moshës 18-24 vjeç;
- me djem të rinj të moshës 18-24 vjeç;
- me nëna/kujdestare të moshës 25-50 vjeç; dhe
- me baballarë / kujdestarë të moshës 25-50 vjeç.

Kjo ndarje midis grupeve të ndryshme, bazuar tek mosha, u bë për të provuar nëse ka dallime në njohuritë, qëndrimet, bindjet, pritshmëritë, bindjet rreth mundësive, perceptimet dhe parapëlqimet midis brezit më të ri dhe atij më të vjetër (të rritur të rinj dhe prindër/ kujdestarë).

Intervistat individuale

U zhvilluan edhe 13 intervista të pastrukturuara me të rritur të rinj, të cilët ishin martuar para moshës 18 vjeç dhe ishin nga vende të ndryshme të mbledhjes së të dhënave. Përveç kësaj, u zhvilluan dy intervista me gra, të cilat i kishin martuar fëmijët e tyre para moshës 18 vjeç dhe me një grua rome të pamartuar, mbi moshën 18 vjeç. Këto intervista ofrojnë ‘histori jete’ të përfshira në këtë raport, si dhe të dhëna të mëtejshme mbi njohuritë, qëndrimet, bindjet, pritshmëritë, bindjet rreth mundësive, perceptimet dhe parapëlqimet. Të dhënat nga këto intervista individuale paraqiten në tekstet në kuti përgjatë gjithë këtij studimi.

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Intervistat me informatorë kyç

Përveç kësaj, u kryen 15 intervista gjysmë të strukturuar me informatorë kyç (IIK), të cilat mundësojnë triangulimin e të dhënave të grumbulluara gjatë diskutimeve të grupeve të fokusit dhe intervistave individuale me të rriturit e rinj të martuar para moshës 18 vjeç dhe përfshijnë diskutime më të thelluara të çështjeve të caktuara. IIK-të u realizuan me të paktën një aktor vendor të rëndësishëm në secilën bashki, të identifikuar me ndihmën e lehtësuesve vendorë.

Udhëzuesit e grupit të fokusit dhe intervistës

U përdor korniza e Bicchierit dhe të tjerëve për të përpiluar pyetje për DGF-të për të nxjerrë informacionet e mëposhtme:

- Njohuritë, qëndrimet, bindjet, pritshmëritë, bindjet rreth mundësive, perceptimet dhe parapëlqimet e pjesëmarrësve në lidhje me martesën e fëmijëve dhe ndikimet e saj.
- Pritshmëritë dhe parapëlqimet e pjesëmarrësve në lidhje me martesën e fëmijëve dhe nëse këto parapëlqime janë të kushtëzuara apo të pakushtëzuara.
- Mundësitë e zgjedhjes që pjesëmarrësit perceptojnë se kanë në dispozicion dhe bindjet e tyre për këto mundësi, përfshirë sanksionet shoqërore dhe/ose përforcimet për ndjekjen ose jo të praktikës.

Protokollet e intervistave për informatorët kyç dhe pyetjet për intervistat me të rriturit e rinj të martuar para moshës 18 vjeç, u informuan gjithashtu nga kjo kornizë, veçanërisht në lidhje me përcaktimin se çfarë pritshmëri sociale janë të përhapura në komunitetet e studiuara dhe mundësitë e zgjedhjes në dispozicion të adoleshentëve në rrezik të martesës së fëmijëve.⁷⁰

Zbatimi i studimit

Një ekip prej tre vetash u angazhua në çdo zonë të projektit për të bashkërenduar dhe kryer punën në terren. Me punëtorët në terren u zhvillua një trajnim fillestar dy-ditor që mbulonte:

- 'Njohjen me njëri-tjetrin'
- Hyrjen në projekt
- Diskutim mbi martesën e fëmijëve: Ç'është ajo? Përse ndodh? Cilat janë ndikimet?
- Vlerësime etike: pëlqimi, fshehtësia/konfidencialiteti, parimi 'mos bëj dëm'
- Trajtimi i çështjeve shqetësuese që dalin në hulumtim
- Hyrje në intervistimin e grupeve të fokusit
- Përsosja e pyetjeve të DGF-ve.

Pas këtij trajnimi, instrumentet e mbledhjes së të dhënave u testuan në terren. Pasi u rishikuan dhe u finalizuan instrumentet e mbledhjes së të dhënave, punëtorët e terrenit morën pjesë në një trajnim të dytë një-ditor, duke i prezantuar ata me versionet përfundimtare të udhëzuesve të DGF-ve dhe pyetësorëve, dhe duke i udhëzuar si të menaxhojnë dinamikat e grupit.

Identifikimi i pjesëmarrësve dhe ftesat për ta për të marrë pjesë në DGF dhe intervista u lehtësuan nga ofruesit e shërbimeve dhe/ose personat me ndikim në secilin komunitet, përfshirë krerë të komuniteteve, punonjës të qendrave shëndetësore, në arsim, në bashki, punonjës socialë, psikologë, etj.⁷¹

Analiza e të dhënave

Korniza e Bicchierit dhe të tjerëve u përdor gjatë fazës së analizës së të dhënave. Kopjet e shkruara të intervistave dhe diskutimeve të grupeve të fokusit u koduan me dorë duke përdorur kodet e nxjerra nga korniza, duke kapur, ndër faktorët e tjerë, ato që lidhen me martesën e fëmijëve:

- Pritshmëritë empirike
- Pritshmëritë normative
- Bindjet faktike jo-shoqërore
- Bindjet normative jo-shoqërore
- Mundësitë e zgjedhjes
- Bindjet rreth mundësive të zgjedhjes
- Parapëlqimet e kushtëzuara
- Parapëlqimet e pakushtëzuara
- Sanksionet

Kodet mbuluan gjithashtu:

- Njohuri mbi përhapjen në komunitetin e të anketuarve
- Njohuri për ndikimet e martesës së fëmijëve
- Njohje të legjisllacionit në lidhje me martesën e fëmijëve

Hulumtuesi zhvilloi një skemë për regjistrimin e të dhënave të koduara që vunë në dukje se si ndërliken këta faktorë (për shembull, nëse një bindje në lidhje me mundësitë në dispozicion bazohet në pritshmëritë normative apo bindjet faktike jo-sociale). Së pari, hulumtuesi përdori stilolapsa me ngjyra të theksuara për të shënuar kopjet fizike të transkripteve, duke nënvizuar fragmentet e rëndësishme dhe duke shënuar se në cilat nga kategoritë e mësipërme bien ato ('pritshmëri empirike', 'bindjet rreth mundësive', 'njohuri mbi ndikimet e martesës së fëmijëve', etj.). Pastaj, fragmentet u kopjuan dhe u ngjiten në një libër pune (workbook) në Excel, e cila kishte një fletë për secilin grup të popullsisë. Pasi u koduan të dhënat dhe u integruan në analizë narrative, hulumtuesi nxori përfundime për të përcaktuar se në cilën kategori të praktikës kolektive (përgjigje racionale, zakon, rregull moral, normë përshkruese, normë shoqërore) futet martesa e fëmijëve për grupet e popullsisë nën studim.

Kufizimet e studimit

Ky studim nuk merret në thellësi me ndikimet e martesës së fëmijëve, edhe pse pjesëmarrësit reflektuan mbi ndikimet e praktikës, kur diskutuan njohuritë e tyre, qëndrimet, bindjet, pritshmëritë, bindjet rreth mundësive, perceptimet dhe parapëlqimet e tyre. Hulumtimi do të shtojë dhe plotësojë të dhënat sasiore të ADSh-së që do të dalin në vitin 2018, por nuk është caktuar në asnjë mënyrë që të jetë përfaqësues. Ai ofron një 'fotografi' të njohurive, qëndrimeve dhe perceptimeve për martesën e fëmijëve në komunitetet e përfshira në hulumtim. Gjetjet mund të jenë të rëndësishme për komunitete të tjera dhe janë një pikënisje për hulumtime dhe hetime të mëtejshme të kësaj teme, por nuk do të ishte aspak e këshillueshme të bëhen përgjithësime nisur nga to.

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Korniza konceptuale e përdorur për këtë studim – korniza e normave shoqërore e Bicchierit dhe të tjerëve - u zhvillua për të analizuar të dhënat sasiore mbi martesën e fëmijëve. Këtu, ajo është përshtatur për t'u përdorur për një studim cilësor dhe të tillë që kërkoi të nxirrte në pah edhe të dhënat mbi normat shoqërore (siç përcaktohen ngushtë nga Bicchieri dhe të tjerët) edhe mbi njohuritë, qëndrimet dhe perceptimet më të gjera për martesën e fëmijëve. Kjo çoi në disa sfida, për shembull në kodimin e të dhënave nga transkriptet e grupeve të fokusit dhe intervistave, duke qënë se pyetjet e bëra ishin të hapura dhe pjesëmarrësit u ftuan të shpreheshin lirisht. Për shembull, një përgjigje ndaj një pyetjeje mbi vendimmarrjen në lidhje me martesën e fëmijëve mund të përfshijë një deklaratë që tregon se edhe bindjet shoqërore jo-faktike (p.sh. nevoja ekonomike) edhe pritshmëritë sociale normative (p.sh. frika se çfarë do të mendojë fisi) kishin luajtur një rol në vendim. Për më tepër, në lidhje me diskutimet rreth 'nderit' dhe emrit të mirë, nganjëherë rezultoi e vështirë të përcaktohej nëse parapëlqimi i një të intervistuarit se vajzat duhet të ruajnë 'nderin' bazohej në bindje vetjake (që, sipas kornizës së Bicchierit dhe të tjerëve, do ta bënte atë një parapëlqim të pakushtëzuar bazuar në një 'bindje jo-shoqërore') apo bazohej në shqetësimin për atë që do të thoshin të tjerët për vajzën, nëse ajo nuk do ta ruante 'nderin' e saj (ç'ka do ta bënte atë një parapëlqim të kushtëzuar, bazuar në pritshmëritë sociale empirike ose normative). Supozimi i natyrshëm në kornizën se, në një komunitet të caktuar, martesa e fëmijëve do të futej më së miri në njërin nga kategoritë e praktikës sociale të identifikuar nga Bicchieri dhe të tjerët ishte gjithashtu problematik: u bë e qartë në fazën e analizës se martesa e fëmijëve për të gjitha grupet e përfshira në studim futej në më shumë se një kategori të praktikës sociale.

Ky studim nuk përfshiu asnjë pjesëmarrës më të ri se 18 vjeç. Përfshirja e fëmijëve në studim do të kishte shtuar pasurinë e të dhënave. Në veçanti, intervistat vetjake me adoleshentë të martuar/ adoleshentë që jetojnë në bashkim do të kishin dhënë një njohuri më të mirë të realiteteve të jetës për adoleshentët e martuar në Shqipëri sot, si dhe informacion 'në kohë reale' rreth arsytimit të tyre për dëshirën për t'u martuar ose për të pranuar një martesë të hershme.

Disa vështirësi u hasën edhe gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave. Duke angazhuar ofrues shërbimesh ose persona të mirënjohur në komunitet si lehtësues, në disa raste, pjesëmarrësit në grupin e fokusit erdhën në takim me pritshmëri të tjera. Një shembull u regjistrua në Bashkinë e Durrësit, ku lehtësuesi i grupit të fokusit ishte punonjës i Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki. Megjithëse pjesëmarrësit ishin informuar për qëllimin e takimit, ata ende prisnin se mund të merrnin ndihmë nga Bashkia. Për ta kapërcyer këtë, lehtësuesi e bëri edhe një herë të qartë qëllimin e takimit, angazhimin e Observatorit dhe angazhimin që pritet nga pjesëmarrësit. Në fund, asnjë nga pjesëmarrësit e grupit të fokusit nuk e tërhoqi pëlqimin për të marrë pjesë.

Në disa grupe, pjesëmarrësit hezituan të shpreheshin në fillim të diskutimit. Kjo u vu re në një grup fokusi me nëna dhe në një grup fokusi me baballarë në zonat rurale. Moderatorin e grupit të fokusit vazhdoi bisedën duke bërë pyetje të përgjithshme rreth stilit të jetesës në zonë dhe duke shkuar hap pas hapi drejt çështjes së martesës së fëmijëve.

Edhe pse pyetjet u përshtatën për t'u kuptuar lehtësisht, në disa raste, pjesëmarrësit nga komunitetet rome dukej se nuk kuptonin pyetje të caktuara. Në këto raste, moderatorin u përpoq ta përsëriste pyetjen duke e formuluar ndryshe deri sa pjesëmarrësit ishin në gjendje ta kuptonin atë.

Intervistuesit, në disa raste, vunë re gjithashtu një prirje të vajzave të reja të martuara para moshës 18 vjeç, veçanërisht në rastet e vajzave jo-rome që jetonin në zonat rurale, për të nxjerrë në pah aspektet pozitive të jetës së tyre martesore. Në këto raste, intervistuesit iu desh të përpiqej më shumë për të fituar besimin e tyre dhe për t'i bindur ato se informacioni është vetëm për qëllimin e studimit dhe se identiteti i të anketuarave nuk do të lidhej me asnjë nga informacionet e përfshira në raportin e studimit.

Vlerësime dhe procedura etike

Gjatë gjithë hulumtimit, Observatori ka respektuar procedurat e UNICEF-it për standardet etike në hulumtim, vlerësim, grumbullim dhe analizimin e të dhënave (2015). Çështjet etike janë diskutuar gjerësisht që nga fillimi i studimit, duke marrë parasysh që një studim mbi martesën e fëmijëve mund të nënkuptojë ndjeshmëri për pjesëmarrësit dhe hulumtuesit. Kjo pjesë jep në hollësi masat dhe veprimet e ndërmarra për të zbutur/ trajtuar çështjet thelbësore etike dhe për të siguruar standardet më të larta etike.

Dëme dhe përfitime

Shtirirja dhe metodologjia e studimit u ndërtuan mbi një shqyrtim analitik të të dhënave dytësore, gjë që zbuloi se mbledhja e të dhënave parësore mbetet thelbësore për t'u mbështetur në burimet e kufizuara të njohurive rreth kësaj teme. Vendimi për kriteret e përfshirjes dhe përjashtimit të pjesëmarrësve/ të intervistuarve të studimit u mbështetën në: a) të drejtën e grupeve të cënueshme për të marrë pjesë dhe për t'u përfaqësuar (p.sh. komunitetet rome dhe rurale); b) vlerësimin e çdo dëmtimi të mundshëm për pjesëmarrësit.

Për të minimizuar efektet negative ndaj pjesëmarrësve, udhëzuesit e DGF-ve u strukturuan për të nxjerrë diskutime të përgjithshme rreth lëndës dhe nuk inkurajuan ndarjen e informacioneve ose përvojave personale. Ndërkaq, intervistat individuale ndoqën modelin e 'narrativës së jetës', duke synuar të nxisnin një rrëfim historik e jo një hetim të thellë mbi temën. Të dy udhëzuesit, për DGF-të dhe intervistat, përmbanin pyetje të qarta, të përshtatura me karakteristikat e pjesëmarrësve.

Siç u detajua më lart, në fillim të këtij studimi, të gjithë anëtarët e ekipit hulumtues u trajnuan për standardet e hulumtimit etik, duke mbuluar pëlqimin e informuar, parimin 'mos bëj dëm' dhe konfidencialitetin/fshehtësinë. Lehtësuesit e DGF-ve dhe intervistuesit morën dy cikle trajnimesh. I pari mbuloi një hyrje në projekt dhe në çështjen e martesës së fëmijëve, si dhe hulumtimin etik. I dyti mbuloi punën me instrumentet e mbledhjes së të dhënave (pas testimit), përforcimin e parimeve të hulumtimit etik dhe praktikat më të mira për regjistrimin e të dhënave të DGF-ve dhe intervistave.

Të gjithë të intervistuarit u informuan plotësisht për rreziqet dhe përfitimet, para se të jepin pëlqimin e tyre për të marrë pjesë në studim. Si pjesë e manualit të punës në terren, lehtësuesit e DGF-ve dhe intervistuesit kishin të dhënat e kontaktit të një psikologu vendas për t'ia dhënë ndonjë pjesëmarrësi, në rast se ishte e nevojshme. Kjo nuk ndodhi në asnjë kohë gjatë punës në terren.

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Pëlqimi i informuar

Para hulumtimit në terren, Observatori zhvilloi procedura për marrjen e pëlqimit të informuar nga të gjithë pjesëmarrësit.⁷²

Pjesëmarrësve iu kërkua të jepnin gojarisht pëlqimin e tyre për të marrë pjesë dhe kjo u regjistrua nga lehtësuesit e DGF-ve/ intervistuesit. Procesi i pëlqimit të informuar përfshiu dhënien shkurtimisht të arsyeve të studimit, çështjet dhe pyetjet që do mbuloreshin gjatë DGF-së ose intervistës, kohëzgjatjen, pjesëmarrjen vullnetare dhe ruajtjen e fshehtësisë së informacionit. Formulari i pëlqimit u përpilua duke përdorur gjuhë të thjeshtë. Pyetësi përfshinte një hapësirë që duhej plotësuar me shënimin nëse ishte marrë apo jo pëlqimi i informuar.

Asnjë nga pjesëmarrësit nuk e mohoi pëlqimin e vet. Në pak raste, pjesëmarrësit e grupeve të fokusit u larguan nga seancat më herët, për shkak të punëve të tjera.

Privatësia dhe konfidencialiteti

Observatori ka punuar për të siguruar privatësinë dhe konfidencialitetin e të intervistuarve. Privatësia është veçanërisht e rëndësishme në lidhje me të dhënat e mbledhura gjatë intervistave me të rriturit e rinj të martuar dhe intervistat me informatorë kyç. Observatori u siguroi që përgjigjet të mbledheshin në një vend privat dhe në një hapësirë të sigurt, ku të intervistuarit nuk mund të dëgjoheshin apo të shiheshin nga anëtarë të tjerë të komuniteteve të tyre, si dhe në një kohë të përshtatshme, për të minimizuar shqetësimin ndaj jetës së tyre. Pjesëmarrësit në grupet e fokusit u nxitën që të respektonin fshehtësinë e të tjerëve, që morën pjesë në diskutim, dhe të mos zbulonin asgjë rreth diskutimit.

Nuk u regjistrua asnjë informacion që mund të mundësonte identifikimin e të intervistuarve. Të dhënat në terren janë regjistruar, ruajtur, analizuar dhe shkruar në bazë të karakteristikave të përgjithshme, pa asnjë mundësi që këto të mund të çojnë në identifikimin e ndonjërit prej të intervistuarve individualë. Të gjitha të dhënat dhe shënimet në terren, përfshirë regjistrimet, ruhen në mënyrë të sigurt nga Observatori.

Pagesa dhe kompensime

Të intervistuarve nuk iu premtua apo dha asnjë pagesë në këmbim të kohës dhe informacionit të tyre. Pije freskuese u ofruan gjatë DGF-ve dhe intervistave si shenjë mirënjohjeje për kohën e dedikuar për pjesëmarrjen në studim.

Konflikti i interesit

Observatori konfirmon se nuk është në dijeni të ndonjë konflikti interesi për këtë punë. Lehtësuesit dhe intervistat nuk zbuluan asnjë konflikt interesi faktik dhe të mundshëm në ndërmarrjen e studimit.

Në seksionet vijuese të këtij raporti, analiza e këtyre gjetjeve është e strukturuar në tre seksione, duke shqyrtuar 'Njohuritë mbi martesën e fëmijëve', 'Qëndrimet ndaj martesës së fëmijëve' (kryesisht, parapëlqimet dhe nëse ato janë të kushtëzuara apo të pakushtëzuara), dhe 'Perceptimet' (mundësitë e zgjedhjes dhe bindjet rreth këtyre mundësive).

5. Njohuritë rreth martesës së fëmijëve

Pjesëmarrësit në grupet e fokusit nga katër grupet e popullsisë - romë që jetojnë në komunitete të veçuara, romë që jetojnë në komunitete të integruara, jo-romë që jetojnë në zona rurale, jo-romë që jetojnë në zona urbane - u pyetën për të zbuluar sa dinin për tre aspekte të martesës së fëmijëve:

- Moshën ligjore të martesës
- Përhapjen e martesës së fëmijëve në komunitetet e tyre
- Ndikimet

Nëpër të katër grupet e popullsisë, pjesëmarrësit në grupet e fokusit shfaqën njohuri të gjera në të tria fushat, me pak ndryshime të dukshme mes grupeve të ndryshme. Ky ishte rasti për grupmoshat më të reja (18-24 vjeç) dhe më të vjetra (25-50 vjeç), si dhe për grupet e grave dhe burrave (pa ndonjë dallim të dukshëm gjinor midis nivelit të njohurive të femrave dhe meshkujve). Në veçanti, grupet e fokusit diskutuan gjerësisht për ndikimet negative të martesës së fëmijëve në pabarazinë gjinore, arsim, shëndet dhe mirëqenie, jetën shoqërore dhe kushtet socio-ekonomike.

Njohuritë për moshën ligjore të martesës

Në përgjithësi, pjesëmarrësit në grupet e fokusit e dinin se mosha minimale ligjore për martesë në Shqipëri është 18 vjeç; në secilin grup, kishte të paktën një pjesëmarrës, i cili deklaroi me saktësi se mosha minimale ishte 18 vjeç. Kështu ndodhi, pavarësisht nëse pjesëmarrësit ishin nga komunitetet rome apo nga popullata më e gjerë, dhe pavarësisht nëse i përkisnin grupmoshave më të reja (18-24 vjeç) apo më të vjetra (25-50 vjeç). Përrjashtim përbënin disa gra të reja jo-rome (18-24 vjeç), që jetojnë në zonat rurale dhe urbane. Në një DGF të vajzave të reja nga zona urbane, asnjëra nga pjesëmarrëset nuk e dinte moshën minimale ligjore për martesë.

Disa pjesëmarrës e dinin gjithashtu se, në rrethana të caktuara, lejohet martesa para moshës 18 vjeç.

“Moshë ligjore për martesë është 18 vjeç, por ka raste kur vajza mbetet shtatzënë, kështu që martesa mund të ndodhë më herët përmes Gjykatës.”

[DGF– baballarë / kujdestarë jo-romë që jetojnë në zona rurale]

Tek pjesëmarrësit romë, njohuria për moshën minimale ligjore për martesë, shpesh, ishte e lidhur me përvojat e tyre të përpjekjes për të regjistruar martesën në moshë të hershme (dhe që iu është miratuar ose jo nga institucionet). Pjesëmarrësit në të gjithë grupet e popullsisë gjithashtu përmendën se fëmijët e lindur nga nënat e mitura nuk mund të regjistrohen në gjendjen civile. Një punonjës social i intervistuar sqaroi se, në fakt, kjo lidhet me regjistrimin e emrit të kujdestarit të fëmijës dhe nuk është një ndalim i përgjithshëm për regjistrimin e foshnjave të lindura nga nënat e mitura.

“Problemi i vetëm është nëse ato kanë fëmijë, sepse nuk mund t’i regjistrojnë fëmijët nën kujdestarinë e tyre dhe, në vend të emrit të vet, përdorin emrin e njërit prej prindërve të tyre.”

[IIK– Punonjës social në komunitetin romë]

Sikurse tregon pjesa më sipër, për të anashkaluar këtë, gjyshërit e regjistrojnë të porsalindurin në emër të tyre; shembuj u regjistruan gjatë DGF-ve me pjesëmarrës romë nga komunitete të veçuara dhe të integruara dhe me pjesëmarrës jo-romë nga zona urbane, çka tregon se kjo është një praktikë e përhapur dhe jo e kufizuar tek komunitetet rome.

Nëpër të gjitha grupet e popullsisë, pjesëmarrësit reflektuan se, ndërsa shumica e njerëzve e dinin se mosha minimale e martesës ligjore ishte 18 vjeç, shpesh, kjo nuk merrej në konsideratë dhe dasmat, që përfshin persona nën 18 vjeç, vazhdonin ende.

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Qëndrimet 'tradicionale' u vlerësuan nga disa pjesëmarrës me ndikim më të madh se ligji.

"Mendoj se të gjithë e dinë se moshë ligjore për martesë është 18 vjeç. Megjithatë, kam dëgjuar edhe thënie si: 'Nëse vajzës i prekin këmbët dyshemenë kur ulet në karrige, atëherë ajo është gati të martohet.'"

[DGF–vajza të reja jo-rome që jetojnë në zona urbane]

Ky ishte rasti për romë që jetojnë në komunitete të veçuara dhe jo të veçuara, dhe për jo-romë që jetojnë në zona rurale dhe urbane. Më pas, martesë do të regjistrohej kur bashkëshorti/bashkëshortja të mbushte 18 vjeç.

"U martova sapo mbarova shkollën (pasi mbarova klasën e 9^{të}). Celebrimin në gjendjen civile e bëmë pasi mbusha 18 vjeç."

[DGF - nëna / kujdestare jo-rome që jetojnë në zona rurale]

Një prirje tjetër e vërejtur tek pjesëmarrësit jo-romë ishte që një i ri/ e re (zakonisht një vajzë) të fejohej para se të mbushte 18 vjeç, por të mos martohej derisa të mbushte 18 vjeç. Kjo duket të jetë sidomos e zakonshme në zonat rurale.

Njohuritë rreth përhapjes së martesës së fëmijëve në komunitetet e të intervistuarve

Në secilin prej grupeve të fokusit, nëpër të gjitha grupet e popullsisë, pjesëmarrësit iu referuan të paktën një rasti të martesës së fëmijëve, për të cilën kishin dijeni. Për pjesën më të madhe, këto raste përfshinin vetëm vajzat nën moshë, që zakonisht martoheshin me burra disa vjet më të mëdhenj se ato. Megjithatë, pjesëmarrësit raportuan disa raste të martesës së fëmijëve që përfshinin djem. Diskutimi midis pjesëmarrësve romë që jetojnë në komunitete të veçuara tregon se djemtë në komunitetet e tyre, zakonisht, *martohen shumë të rinj*.

"Vajzat martohen që 12-13 vjeç, ndonjëherë 14, por rrallë më vonë. Djemtë po ashtu martohen herët, 14-16 vjeç deri në 19."

[DGF – vajza të reja rome që jetojnë në komunitete të veçuara]

Të dhënat nga grupet e fokusit tregojnë se, ajo që pjesëmarrësit e shihnin si moshë 'të zakonshme' për martesë, ndryshonte në mënyrë të konsiderueshme si brenda për brenda, ashtu edhe midis komuniteteve të ndryshme. Kjo sugjeron që edhe praktikatat e martesës janë shumë të ndryshme, ku, për shembull, disa familje rome e refuzojnë praktikën e martesës së fëmijëve, ndërsa disa familje jo-rome e ruajnë atë.

Një pjesëmarrës rom shprehu idenë e rëndësishme se brenda një komuniteti të caktuar rom, faktorë të tjerë, si gjendja socio-ekonomike dhe qëndrimet ndaj arsimit, mund të ndikojnë në moshën 'e zakonshme' për martesë.

Njerëzit nga klasa e ulët ... priren t'i martojnë fëmijët sa më shpejt të jetë e mundur. Klasa e mesme priret t'i martojë fëmijët pak më të mëdhenj dhe klasa e lartë priret të ndjekë arsimin.

[DGF– baballarë / kujdestarë romë që jetojnë në komunitete të veçuara]

Pjesëmarrësit romë që jetonin në komunitete të veçuara raportuan më së shpeshti një moshë 'të zakonshme' martesë për vajzat midis 14 dhe 16 vjeç dhe për djemtë, midis 17 dhe 20. Megjithatë, disa pjesëmarrës përmendën moshë më të mëdha të 'zakonshme' martesë.

Pjesëmarrësit romë nga komunitetet e integruara raportuan një moshë pak më të madhe 'të zakonshme' të martesës për vajzat, midis 15 dhe 17 vjeç, ndërsa djemtë prireshin të martoheshin midis 18 dhe 23 vjeç. Megjithatë, përsëri, kjo nuk ishte e përgjithshme.

**“Në komunitetin tonë kemi raste kur vajza në klasë të pestë martohen, sepse familja e burrit është e pasur.”
[DGF– nëna / kujdestare rome që jetojnë në komunitete të integruara]**

Pjesëmarrësit e këtyre grupeve të fokusit treguan se në të dyja komunitetet, të veçuara dhe jo-të veçuara, këto gama moshe përfaqësonin atë që ishte praktikë e zakonshme në komunitetet e tyre. Në të kundërt, gjatë diskutimeve të grupeve të fokusit me pjesëmarrësit e komuniteteve jo-rome, moshë ‘e zakonshme’ për martesë u dha mbi 18 vjeç, ndërsa rastet e martesës në moshë më të re u paraqitën si të jashtëzakonshme.

**“Në shumicën e rasteve, ato fejohej shumë herët, por presin derisa të mbushin 18 vjeç për t’u martuar, për vajzat. Ndërsa djemtë, ata nuk martohen deri në 23 vjeç.” [...]
[DGF – vajza të reja jo-rome që jetojnë në zonat rurale]**

Përjashtim përbënin disa komunitete rurale në Fan, ku vajzat zakonisht martoheshin që nga moshë 15 vjeç.

**“Këtu, vajzat prirën të martohen shumë herët, disa prej tyre qysh 15 vjeç ose sapo mbarojnë shkollën 9-vjeçare. Djemtë prirën të martohen më vonë, 23-25 vjeç ose më vonë nëse kanë emigruar diku.”
[DGF – baballarë / kujdestarë jo-romë që jetojnë në zona rurale]**

Ky pjesëmarrës në DGF nuk ishte i vetmi që sugjeroi një lidhje midis vajzave që martoheshin dhe burrave që emigronin.

**“Ka edhe raste kur prindërit i fejojnë vajzat me djem emigrantë dhe ajo jeton me prindërit e bashkëshortit, ndërsa burri punon jashtë.”
[DGF – vajza të reja jo-rome që jetojnë në zona urbane]**

Në përgjithësi, pjesëmarrësit në grupet e fokusit vunë re se martesat e fëmijëve ishin më të zakonshme në zonat rurale, se në ato urbane.

**“Varet nga familja, si për shembull, njerëzit nga qyteti nuk i martojnë vajzat të reja, ndërsa njerëzit nga fshatrat dhe zonat rurale i martojnë. Madje nuk i lejojnë të shkojnë në shkollë dhe sapo marrin një propozim për vajzat e tyre, i martojnë ato.”
[DGF– djem të rinj jo-romë që jetojnë në zona urbane]**

Kutia 1: Martesa e fëmijëve–kush vendos?

‘...ky ishte urdhri që m’u dha dhe e ndoqa.’

... [Isha 15 vjeç] si ta dija çfarë ishte bashkëshorti? Ne nuk ishim si fëmijët në ditët e sotme që edhe në kopsht dinë të të përgjigjen si të rritur kur i pyet se çfarë është burri. [...]

Gruaja e xhaxhait tim kishte (në rrethin e saj familjar) një djalë të mirë, burrin tim ... ai dhe familja e tij janë të mirë dhe ai është punëtor. Si mund të mbaj mend gjithçka ... familja më pyeti se çfarë do vendosja ... Nuk mund të flisja fare. E humba fare ... ishte vërtet e sikletshme ... pasditen tjetër më thanë se fejesa do të bëhet pas 2 ditësh. Nesër do të dalim të blejmë një dhuratë për burrin tënd dhe do të bëhemi gati.

Ndërsa më parë, madje më thanë se burri im kishte ardhur disa herë në dyqan për të parë si isha dhe, për të qenë e sigurtë, më la një përshtypje të mirë, si i panjohur që ishte.

Ç’të them? Nuk kisha arsye [të martohesha]. Ai ishte urdhri që m’u dha dhe e ndoqa.

[II - Vajzë e re jo-rome e martuar para moshës 18 vjeç]

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Në pjesën më të madhe, pjesëmarrësit nga grupet e ndryshme të popullsisë mendonin se martesa e fëmijëve po bëhej gjithnjë e më pak e zakonshme, përfshirë në komunitetet romë. Për shembull, pjesëmarrësit më të rinj (18-24 vjeç) thanë se martesat e fëmijëve ndodhnin më rrallë tani se në kohën e prindërve dhe gjyshërve të tyre. Pjesëmarrësit shpesh i lidhën këto ndryshime me mënyra të reja të të menduarit për dashurinë, martesën dhe marrëdhëniet, si dhe ndryshimin e prioritetëve, sikurse vuri në dukje një nga informatorët kyç të intervistuar për këtë studim.

“Pesë - gjashtë vite më parë duhej ta martoje vajzën për shkak të mentalitetit ose se fqinji kishte vepruar kështu, e ke parasysh, se të tjerët kishin vepruar kështu. Ndërsa sot, kjo ka ndryshuar. Njerëzit janë bërë të vetëdijshëm se vajzat e tyre nuk janë pronë dhe nuk mund të bëjnë ç’të duan me to.”
[IJK – punonjës në një OJQ që ofron shërbime komunitare]

Megjithatë, këto pikëpamje nuk ishin të përgjithshme dhe disa pjesëmarrës romë vunë re se numri i martesave të fëmijëve duket të jetë në rritje.

“Martesat e hershme janë bërë më të zakonshme. Nuk e di, vajzat mezi presin të kenë burrë.”
[DGF – djem të rinj romë që jetojnë në komunitete të integruara]

Kutia 2: Ndryshimi i praktikave të martesës

“Ditët e sotme, njerëzit nuk kërkojnë më lejen e prindërve ...”

Ditët e sotme, njerëzit nuk kërkojnë më lejen e prindërve: vendosin vetë kur duan të martohen. Dhe kjo më ka ndodhur edhe mua. I kërkova bashkëshortes të jetonte me mua, ajo pranoi dhe këtë bëmë. U fejuam kur unë isha 18 vjeç dhe ajo 15, ende nuk jemi martuar ligjërisht. Vendosëm që të dy të jetonim bashkë; nuk është se i pyetëm prindërit. [...]

Fillimisht, u diskutua moshja jonë shumë e re dhe se nuk ishim të zotë për veten, por prindërit tanë donin që ne të ishim të lumtur, kështu që na mbështetën. Na mbështetën që të qëndronim më gjatë kështu, por erdhi fëmija dhe marrëdhënia jonë u bë më e fortë.

Jam babai i një djali shumë të bukur dhe tani jam 23 vjeç... Jam i lumtur dhe gjithçka më duket e mundur. Unë do të punoj shumë që ai dhe gruaja ime të kenë gjithçka që duan.

Nuk e di, nëse djali apo vajza ime dëshiron të ketë një marrëdhënie, moshja nuk është problem. Kjo është ajo që bënë paraardhësit tanë dhe ata kishin një jetë të mirë. Më e mira do të ishte që të mbaronin shkollën, të kishin një punë të qëndrueshme dhe të ardhura, që të mund të kenë një jetë të mirë.

[II – Djalë i ri jo-rom i martuar para moshës 18 vjeç].

Njohuri rreth ndikimit të martesës së fëmijëve

Pjesëmarrësit në grupet e fokusit nga të gjitha grupet e ndryshme të popullsisë diskutuan gjerësisht ndikimet e martesës së fëmijëve në pabarazinë gjinore, arsimim, shëndetin fizik dhe mendor, mirëqenien, jetën shoqërore dhe kushtet socio-ekonomike. Shumë pjesëmarrës përmendën gjithashtu një lidhje midis martesës së fëmijëve dhe shkallëve më të larta të zgjidhjes së martesës.

“Edhe në rastet kur të rinjtë martohen në moshë të hershme me miratimin e familjes, divorci ndodh, ka probleme sociale për familjen e ndarë.”

[IIK – administrator social]

Pjesëmarrësit mendonin fuqimisht se ndikimet e praktikës ishin më të mëdha për vajzat e martuara sesa për djemtë e martuar, jetët e të cilëve kishin më pak gjasa të ndryshonin në mënyrë dramatike pas martesës. Ata gjithashtu folën pothuajse ekskluzivisht për ndikimet negative, duke thënë se martesa e fëmijëve ishte një praktikë që kishte sjellë vetëm probleme dhe vështirësi për të prekurit.

Kjo përfshinte pjesëmarrës nga komunitetet rome ku, duke gjykuar nga diskutimi, martesa e fëmijëve konsiderohej një praktikë e zakonshme.

“Kjo është çfarë na shkatërron jetën, sepse i martojmë vajzat herët për t’i larguar nga shtëpia. Unë u martova 14 vjeç.”

[DGF– nëna/ kujdestare rome që jetojnë në komunitete të integruara]

Pjesëmarrësit përmendën disa përfitime nga martesa e fëmijëve. Praktika siguronte që ‘nderi’ i vajzës të ishte i mbrojtur, e lejonte çiftin që dashurohej të ishte bashkë, çonte në një përgjegjësi më të madhe dhe do të thoshte se do të lindnin fëmijë.

“Kur martohesh e re, e mira është se i bën fëmijët shpejt dhe pastaj ata të bëhen krah pune.”

[DGF – nëna/ kujdestare jo-rome që jetojnë në zona urbane]

Megjithatë, në përgjithësi, pjesëmarrësit në grupet e fokusit mendonin se ndikimet negative të martesës së fëmijëve i tejkalonin këto përfitime.

Pabarazia gjinore

Pjesëmarrësit në të gjitha grupet e fokusit folën për ndryshimet e rëndësishme që vajzat adoleshente përjetojnë duke u martuar. Pritet menjëherë që vajzat e martuara të marrin përsipër një barrë të rëndë të punës në familje, përfshirë punët e shtëpisë, ‘shërbimin’ ndaj burrit dhe familjarëve të tij dhe kujdesin për anëtarët e tjerë të familjes. Vërtet, disa pjesëmarrës flisnin për familje dhe burra që zgjidhnin një vajzë të re për martesë, që të mund ‘ta stërvitnin’ si t’u pëlqente, sepse ishte shumë e re.

“Kur vajzat martohen në moshë shumë të re, ato duhet të kujdesen që të përmbushin të gjitha kërkesat e vjehrrës dhe antarëve të tjerë të familjes, duhet të rrinë në shtëpi dhe të bëjnë punët e shtëpisë, të gatujnë, pastrojnë dhe të përmbushin të gjitha kërkesat e burrit.”

[DGF– vajza të reja rome që jetojnë në komunitete të veçuara]

Pas martesës, pjesëmarrësit mendonin se zakonisht, jeta e vajzave kufizohej në punët e shtëpisë dhe rritjen e fëmijëve dhe nuk u lejohej të vazhdonin studimet ose të punonin. Shumë pjesëmarrës në DGF mendonin se vajzat ishin tepër të reja për të marrë përsipër këto përgjegjësi dhe ishin të papërgatitura për to. Një pjesëmarrës mendonte se disa familje i shfrytëzojnë nuset e tyre adoleshente.

“Por ndodh, ata përfitojnë nga vajza dhe e detyrojnë të bëjë punë, por kjo varet nga familja.”

[DGF– baballarë / kujdestarë romë që jetojnë në komunitete të integruara]

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Pjesëmarrësit reflektuan se në dallim, djemtë e martuar në moshë të re nuk përjetonin një ndryshim kaq të rëndësishëm në jetë. Ndryshimet që ata përjetonin lidheshin me faktin se bëheshin më të pjekur, më të përgjegjshëm dhe kështu u panë nga disa si pozitive.

“Djemtë bëhen më të pjekur dhe vajzat mësojnë zakonet e prindërve të burrit, mësojnë të gatujnë, të kujdesen për shtëpinë, fëmijët, e kështu me radhë”

[DGF– Djem të rinj romë që jetojnë në komunitete të veçuara]

Kështu pra, pjesëmarrësve iu dukej se martesa e fëmijëve i shtynte adoleshentët në role gjinore shumë ‘tradicionale’, që i kufizonin mundësitë e vajzave për studime të mëtejshme, karrierë dhe forma të tjera të vetë-realizimit. Kjo shërben për të vazhduar pabarazinë gjinore brenda dhe jashtë familjes. Një pjesëmarrës e bëri të qartë lidhjen mes martesës së fëmijëve dhe pabarazisë gjinore.

“Para së gjithash, as nuk bëhet fjalë të ndjekësh universitetin: po flas për vajzën. Gjinnazi mund të lejohet. Ajo nuk ka jetë shoqërore. Ndërsa për djemtë është ndryshe. Ata vazhdojnë jetën si më parë, dhe ndoshta mund të mendojnë se kanë më shumë autoritet. [...] Pabarazia gjinore zgjerohet edhe më shumë.”

[DGF – vajza të reja jo-rome që jetojnë në zona urbane]

Kutia 3: Ndikimet gjinore të martesës së fëmijëve

‘E vazhdova shkollën, por me shumë përpjekje dhe sakrificë.’

U martuam kur isha 17 vjeç dhe burri im 22. Kjo nuk është një moshë shumë e zakonshme për t’u martuar, por ka disa raste. Në zonën tonë, martesat e hershme nuk janë shumë të zakonshme. Tani që ka kaluar pak kohë, mendoj se nuk duhet të isha martuar kaq e re, sepse u kufizova nga shumë gjëra. [...] Ishte e vështirë për mua që të merrja përgjegjësi në familje, të gatujaja, të lindja dhe të rritja fëmijët. [...]

Jeta jote ndryshon shumë. Në fillim, të pëlqen gjithçka, sepse ke gjithçka ke dashur dhe jeton me atë që do, çdo gjë duket e bukur dhe pa asnjë problem, dhe pastaj fillon përgjegjësia dhe kufizimet. Ndryshimi më i madh është kur bën fëmijë, sepse atëherë ke më shumë shpenzime. E vazhdova shkollën, por me shumë përpjekje dhe sakrificë.

[II - Vajzë e re jo-rome, e martuar para moshës 18 vjeç].

Arsimimi

Pjesëmarrësit nga të gjitha grupet e popullsisë të përfshira në studim u pajtuan me mendimin se martesa e fëmijëve ka një ndikim shumë negativ në arsimin e vajzave.

Në tregimin e rasteve të martesës së fëmijëve, qofshin këto ‘të jashtëzakonshme’ ose të zakonshme, pjesëmarrësit në DGF nga të gjitha grupet e popullsisë theksuan dy pika në jetën e një adoleshenteje kur kjo ka më shumë gjasa të ndodhë: në fund të shkollës 9-vjeçare (14- 15 vjeç) dhe në fund të shkollës së mesme (17-18 vjeç). Në të dyja rastet, zakonisht, kjo shënonte fundin e arsimimit të vajzës: kur martohej, ajo nuk do të vazhdonte shkollën e mesme apo universitetin apo ndonjë formë tjetër të arsimit të mëtejshëm.

Thënë kjo, ndryshimi i kushteve ekonomike mund të çojë në ndryshime në qëndrime, nëse një vajzë ose një grua duhet të vazhdojë arsimin pas martesës, siç vuri në dukje ky i intervistuar.

“Ky koncept ka ndryshuar paksa, sepse edhe kur këto vajza martohen në moshë më të re, është e nevojshme që të investohet në to. Burrat dëshirojnë që gratë e tyre të shkojnë në shkollë dhe të punojnë, sepse sot familjet kanë më shumë shpenzime.”

[DGF – nëna/ kujdestare jo-rome që jetojnë në zonat rurale]

Pengesat për qasjen në arsim ishin gjithashtu një faktor, siç theksoi ky informator kyç.

“Kam patur një rast ... [një vajzë që braktisi shkollën] me rezultate shumë të mira akademike. Zona nuk ka transport publik dhe kjo ishte arsyeja që ajo nuk u kthye në shkollë.”

[IIK – punonjës i njësisë së mbrojtjes së fëmijëve]

Është e rëndësishme të theksohet se në disa komunitete rome nuk është çështja se vajzat (ose djemtë) lënë arsimin për t'u martuar, por që, në radhë të parë, ato nuk e kanë ndjekur asnjëherë shkollën.

“Martesa nuk ndikon në arsim, sepse ne nuk shkojmë fare në shkollë.”

[DGF – baballarë / kujdestarë romë që jetojnë në komunitete të veçura]

Në të njëjtën kohë, ka familje rome që janë të gatshme të mbështesin arsimimin e vajzave të tyre deri në nivelin universitar.

“Në ditët e sotme, familja e lejon vajzën të ndjekë universitetin, nëse ajo e dëshiron këtë dhe nëse familja mund ta përballojë; kush nuk mund ta përballojë shkollimin zgjedh martesën.”

[DGF – vajza të reja rome që jetojnë në komunitete të integruara]

Kontrasti midis këtyre dy realiteteve thekson përsëri ndryshimin e madh në praktikat e martesës - dhe në qëndrimet ndaj arsimimit të vajzave - brenda komuniteteve të ndryshme rome. Ai gjithashtu tregon për ndikimin e kushteve socio-ekonomike në përcaktimin nëse një vajzë do të jetë në gjendje të përfundojë arsimin.

Shëndeti dhe mirëqenia

Pjesëmarrësit në grupet e fokusit nga të gjitha grupet e ndryshme të popullsisë folën për ndikimet negative të martesës së fëmijëve në shëndetin fizik dhe mendor dhe në mirëqenie.

Gratë rome (nga grupmoshat më të reja dhe më të vjetra) sollën vëmendjen te fakti se, pasi martohen, vajzat janë në presion që të mbeten shtatzënë sa më shpejt të jetë e mundur. Pjesëmarrësit në diskutimet e grupeve të ndryshme të fokusit reflektuan mbi ndikimet negative që lindja në moshë të hershme ka mbi shëndetin fizik të vajzave të martuara, sepse trupat e tyre nuk janë të pjekur fizikisht mjaftueshëm për shtatzëni dhe lindjen e fëmijës.

“Nuk janë fizikisht të gatshme të bëhen nëna, sepse trupi i vajzës vazhdon të rritet deri në moshën 20 vjeçare.”

[DGF – vajza të reja jo-rome që jetojnë në zona rurale]

Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit folën gjithashtu për ndikimet e martesës së fëmijëve në shëndetin mendor dhe në mirëqenie. Një pjesëmarrës rom në DGF tha se adoleshentet e martuara *‘kanë probleme psikologjike’*. Një pjesëmarrëse jo-rome foli për mënyrën se ndihej sikur vajzat që fejojeshin ose martoheshin të reja *‘e humbin veten’* dhe identitetin e tyre.

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Ato përdorin 'ne' në çdo bisedë, duke nënkuptuar të fejuarin dhe veten dhe nuk përdorin kurrë 'unë' ... Vajzat e shohin veten në funksion të marrëdhënies, ndërsa djemtë e shohin veten në funksion të vetvetes.

[DGF – vajza të reja jo-rome që jetojnë në zonat urbane]

Ndërsa nuk flitet drejtpërdrejt, disa pjesëmarrës hodhën fjalën nga larg për traumën seksuale të përjetuar nga adoleshentet pas martesës, të cilat ishin fizikisht, emocionalisht dhe mendërisht të papërgatitura për marrëdhënie seksuale. Në një grup fokusi me vajza të reja rome, dy nga pjesëmarrëset deklaruan se nuk dinin asgjë për seksin dhe marrëdhëniet seksuale, para se të martoheshin dhe se e kishin zbuluar vetëm natën e dasmës.

Së fundi, dy pjesëmarrës përmendën se vajzat e martuara ishin në rrezik të dhunës në familje [baballarë / kujdestarë jo-romë që jetojnë në zona urbane; vajza të reja jo-rome që jetojnë në zona urbane], por kjo nuk u diskutua më tej në këto apo në ndonjë DGF tjetër.

Cënueshmëria ndaj dhunës në familje u përmend në këtë intervistë me një informator kyç.

Normalisht, ka patur raste dhune, debate të vazhdueshme dhe kjo përhapet në të gjithë lagjen. A janë më të ekspozuara ndaj dhunës në familje?

Po, po.

[IIK – përfaqësues i një OJQ-je që ofron shërbime komunitare]

Jeta shoqërore

Shumë pjesëmarrës tërhoqën vëmendjen tek fakti se kur martohen, vajzat dhe djemtë adoleshentë nuk janë më në gjendje të shoqërohen me miqtë dhe të afërmit e tyre në të njëjtën masë. Megjithatë, pjesëmarrësit nëpër të gjitha grupet e popullsisë ranë dakord se kufizimet në lëvizjen e vajzave të martuara jashtë shtëpisë dhe kontaktet me bashkëmoshatarët janë më të rrepta. Një pjesëmarrës bëri lidhjen midis kufizimit në lëvizjen e vajzave të martuara dhe kontaktin e tyre me bashkëmoshatarët, nga njëra anë dhe normave shoqërore gjinore, nga ana tjetër.

“Nuk kam parë një vajzë që të ketë jetë shoqërore. Kjo lidhet me normat/rregullat e pashkrara.”

[DGF – nëna/ kujdestare jo-rome që jetojnë në zona rurale]

Një informator kyç vuri në dukje se ky kontroll shtrihej në median sociale, me implikime për një vajzë të fejuar ose të martuar për t’ju qasur rrjeteve të miqësisë dhe atyre mbështetëse.

“Kur fejohen, i mbyllin faqet në Facebook, i fshijnë miqtë e tyre nga Facebook ... [i fejuari thotë] ‘pse komentuan ata... ti nuk duhet t’i flasësh atij, se një herë më ke thënë se ai të ngacmonte ... pra, kështu gjërash.”

[IIK – punonjës i njësisë për mbrojtjen e fëmijëve]

Një tjetër informator kyç foli për adoleshente të martuara që bëhen ‘pronë’ e familjes së burrit dhe se ‘nuk janë më vetja’ [IIK- punonjës në një OJQ që ofron shërbime komunitare].

Kutia 4: Nuk ka shkollë, nuk ka jetë shoqërore***‘Çfarë shkollë, s’bëhet fjalë...’***

U martova në moshën 17 vjeçare. [...]

Prisja të ishte më e mrekullueshme. Ishte e vështirë, por u mësua me njëri-tjetrin dhe si t’i kalonim kohët e vështira. Edhe ne nuk e kuptuam si na ndryshoi jeta pas martesës.

Çfarë shkollë, s’bëhet fjalë! Punonim te dyqani i rrobave. Jetë sociale? Jo! Nuk dilnim. Kryetari i familjes ishte përgjegjës. Unë isha burri. Jetoja me prindërit e mi në të njëjtën shtëpi, por urdhëronte babai im. Gjithkush ka përgjegjësitë e veta, por babai im kishte më shumë. [...]

19 vjeç u bëra prind. Ishte përvojë e bukur dhe e njëjta gjë ishte për gruan time. Kam tre fëmijë. Kam dy vajza binjake 10 vjeç dhe një djalë 3 vjeç.

Nuk kam mbaruar shkollën.... Nuk dua që fëmijët e mi të martohen në të njëjtën moshë si unë. Dua që të përfundojnë shkollën. Mendoj se kjo është për më mirë.

[II – Djalë i ri rom i martuar para moshës 18 vjeç]

Kushtet socio-ekonomike

Disa pjesëmarrës romë bënë lidhjen midis martesës së fëmijëve, braktisjes së shkollës dhe vazhdimet të varfërisë në komunitetet e tyre.

Efektet negative janë se nuk e përfundojnë shkollën për shkak të martesave të hershme, mezi gjejnë punë dhe kanë probleme ekonomike.

[DGF – djem të rinj romë që jetojnë në komunitete të veçuara]

Disa pjesëmarrëse rome vunë në dukje se varfëria, gjithashtu, ishte e lidhur me faktin se shumë martesat e fëmijëve dështonin, që do të thotë se gratë e reja përfundonin prindër të vetëm, duke luftuar për të mbështetur veten dhe fëmijët e tyre.

“Të rejat martohen, por ... pastaj e kuptojnë se jeta nuk është e lehtë dhe ndahen. Pastaj e provojnë përsëri (me një burrë tjetër). Ato bëhen edhe më të varfra, duke pasur fëmijë nga të dyja martesat. Edhe për djemtë është e njëjta gjë.”

[DGF – nëna/ kujdestare rome që jetojnë në komunitete të integruara]

Kutia 5: Martesa e fëmijëve – cikël i varfërisë***‘Vajzat e mia patën fat më të keq se unë...’***

Kur isha 14 vjeç, babai më gjeti burrë dhe vendosi të më martonte. Edhe nëna ime e miratoi këtë, ndërsa mendimi im nuk kishte rëndësi, sepse ata kishin vendosur tashmë.

Në fillim nuk mund të dilja kundër vendimit të prindërve dhe, gjithashtu, askush nuk më pyeti nëse doja të martohesha apo jo, pavarësisht nëse kjo ishte e mirë për mua apo jo, por kur u ndava nga burri i parë dhe vendosa të martohesha me burrin e dytë, gjithçka erdhi si rezultat i kushteve ekonomike në të cilat isha dhe nuk kisha zgjedhje. [...]

Vajzat e mia patën fat më të keq se unë, sepse, praktikisht, u rrëmbyen kur ishin 13-14 vjeç, u takuan me burrat e tyre dhe donin të martoheshin pa miratimin tim. Vajza e parë është ndarë dy herë dhe tani është në një marrëdhënie të re me dy fëmijë dhe nuk ka mjaftueshëm për të ngrënë. Ajo ka ndjekur vetëm filloren dhe nuk punon. Vajza e dytë u martua dhe shkoi në Greqi, kur ishte 13 vjeç. Thotë se është mirë, por nuk e di, sepse nuk më viziton shumë shpesh. Vajza e tretë u takua me një fqinj aty afër dhe kjo shkaktoi shumë probleme, sepse nuk e miratoja. Ai është shumë xheloz, nuk lejon që ajo të bëjë asgjë [vetëm]. Ai është edhe shumë përtac dhe ata mezi e shtyjnë deri në fund të muajit. Kur bëjnë sherr ai i thotë: ‘Shko te jot ëmël!’ dhe ajo vjen tek unë duke qarë.

Të gjitha kanë fëmijë dhe, në një farë mënyre, unë i mbaj të gjitha problemet e tyre dhe, si nënë, nuk mund të rri pa i ndihmuar, sepse nuk kanë asnjë tjetër, përveç meje.

[II - Nënë rome e cila ka martuar fëmijët para moshës 18 vjeç]

6. Parapëlqimet pro dhe kundër martesës së fëmijëve

Ky seksion përdor konceptin e parapëlqimeve ‘të kushtëzuara’ dhe ‘të pakushtëzuara’ të Bicchierit dhe të tjerëve për të zbuluar qëndrimet ndaj martesës së fëmijëve në katër grupet e popullsisë: romë që jetojnë në komunitete të veçuara, romë që jetojnë në komunitete të integruara, jo-romë që jetojnë në komunitete rurale dhe jo-romë që jetojnë në zona urbane. Në fund të seksionit, këto gjetje janë shqyrtuar për të vlerësuar se në cilën kategori të praktikës sociale futet martesa e fëmijëve, përsëri sipas kornizës së Bicchierit dhe të tjerëve.

Brenda kornizës së Bicchierit dhe të tjerëve, *parapëlqimet e kushtëzuara* janë ato që bazohen në pritshmëri sociale, pra çfarë mendojnë njerëzit e tjerë në një grup ose komunitet të caktuar se duhet bërë (pritshmëritë sociale normative), apo çfarë bëjnë ata në të vërtetë (pritshmëritë empirike). Nëse një njeri shpreh një parapëlqim të kushtëzuar (p.sh., për martesën e fëmijëve ose për një praktikë tjetër), ky parapëlqim nuk bazohet në pikëpamjen vetjake të personit, por në atë që njerëzit rreth tij mendojnë dhe bëjnë dhe si ai beson se do të gjykohet ose dënohet nga këta njerëz (nga opinion).

Në të kundërt, *parapëlqimet e pakushtëzuara* bazohen në atë që Bicchieri dhe të tjerët i quajnë ‘bindje jo-sociale’, d.m.th. bindje të bazuara në bindjet morale, vetjake (bindje jo-sociale normative) të dikujt për atë çfarë duhet apo nuk duhet bërë, ose bindje të bazuara në realitete faktike (bindje jo-sociale faktike). Këto nuk ndikohen nga ajo që mendojnë ose bëjnë njerëzit në grupin ose komunitetin e atij personi.

Gjatë diskutimeve të grupeve të fokusit dhe intervistave me informatorë kyç, pjesëmarrësit diskutuan parapëlqimet e tyre, por edhe ato që besonin se ishin parapëlqimet e njerëzve të tjerë në komunitetet e tyre. Gjetjet kryesore nga këto diskutime janë përmbledhur në Tabelën 2 dhe analizohen më hollësisht më poshtë. Ajo që del qartë është se parapëlqimet e pjesëmarrësve pro dhe kundër martesës së fëmijëve përcaktoheshin nga një gamë e gjerë faktorësh, që formësoheshin nga pritshmëritë sociale, ashtu si dhe nga bindjet morale personale e nga realitetet faktike. Në shumë raste, pjesëmarrësit folën se parapëlqimet pro ose kundër martesës së fëmijëve ndikohen nga një mori pritshmëri sociale (për shembull, frika nga thashethemet dhe dënimi nga opinion) dhe bindjet jo-sociale faktike (për shembull, ‘realiteti faktik’ i varfërisë). Kjo ilustron në ekstraktin më poshtë.

“Në rastin e vajzës, familja vendos për martesën për shkak të problemeve ekonomike, ‘një gojë më pak për të ushqyer’ ose sepse, nëse ajo i kalon 15-16 vjeç, do të konsiderohet ‘lëneshë’: Ky është zakoni. Ndërkohë, për djalin, familja mendon se ka gjetur një grua të mirë dhe të ndershme. [...] Burimi i trysnisë është tradita dhe kushtet.”

[DGF – vajza të reja rome që jetojnë në komunitete të veçuara]

Shembuj si ky u dhanë gjatë grupeve të fokusit me gra dhe burra nëpër të gjithë grupet e ndryshme të popullsisë të përfshira në këtë studim. Si rrjedhim, në analizë, shpesh ishte e vështirë të identifikohesh mirë nëse parapëlqimi mbizotëruar pro ose kundër martesës së fëmijëve në një grup të caktuar bazohej në pritshmëri sociale apo në kushte ekonomike apo kushte të tjera sociale (dhe kështu, në cilën kategori të ‘praktikës sociale’ bie martesa e fëmijëve për këtë komunitet). Kjo ilustron përsëri se sa e ndërlikuar është çështja e martesave të fëmijëve, pavarësisht nëse praktikohet në komunitetet rome (ose pakica të tjera) apo në komunitete shumice.

Përveç kësaj, në analizë, ndonjëherë ishte e vështirë të veçonim bindjen vetjake morale të një personi nga ndikimi i pritshmërive sociale normative. Kjo është veçanërisht e vështirë në lidhje me rëndësinë që i vendoset ‘nderit’. Shumë pjesëmarrës besonin fuqimisht se vajza duhet të jetë e virgjër kur martohet, për të mbrojtur ‘nderin’ e saj dhe të familjes. Në të njëjtën kohë, ata ndikoheshin fuqimisht nga ajo që njerëzit e tjerë rreth tyre mendonin për ‘nderin’ dhe në veçanti, nga frika e zërave dhe thashethemeve rreth ‘nderit’ të vajzës.

I martojnë sa janë janë ende të reja, që të mos turpërojnë prindërit e tyre. Duan që ato të jenë të virgjëra.
[DGF – nëna/ kujdestare rome që jetojnë në komunitete të veçuara]

Tabela 2: Parapëlqimet e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara pro dhe kundër martesës së fëmijëve sipas grupeve të popullsisë

	Faktorët kryesorë që formësojnë parapëlqimet e kushtëzuara pro martesës së fëmijëve	Faktorët kryesorë që formësojnë parapëlqimet e kushtëzuara kundër martesës së fëmijëve	Faktorët kryesorë që formësojnë parapëlqimet e pakushtëzuara pro martesës së fëmijëve	Faktorët kryesorë që formësojnë parapëlqimet e pakushtëzuara kundër martesës së fëmijëve
Romë që jetojnë në komunitete të veçuara	<ul style="list-style-type: none"> Frikë nga sanksioni social Trysni nga komuniteti/fisi Frika se mos 'mbeten pas' Lëvdatë se martuan një vajzë të re 		<ul style="list-style-type: none"> Martesa e fëmijëve shihet si zakon/ traditë Bindje vetjake në rëndësinë e 'nderit' Varfëria Dëshira për t'i dhënë fëmijës një jetë më të mirë 	<ul style="list-style-type: none"> Adoleshentët nuk janë gati Martesa e fëmijëve/e hershme është pengesë për arsimin dhe punësimin
Romë që jetojnë në komunitete të integruara	<ul style="list-style-type: none"> Frikë nga sanksioni social Trysni nga komuniteti/fisi Frika se mos 'mbeten pas' Lëvdatë se martuan një vajzë të re 		<ul style="list-style-type: none"> Martesa e fëmijëve shihet si zakon/ traditë Bindje vetjake në rëndësi të e 'nderit' Varfëria Dëshira për t'i dhënë fëmijës një jetë më të mirë 	<ul style="list-style-type: none"> Adoleshentët nuk janë gati Martesa e fëmijëve/e hershme është pengesë për arsimin dhe punësimin
Jo romë që jetojnë në zona rurale	<ul style="list-style-type: none"> Frikë nga sanksioni social Frika se mos 'mbeten pas' Lëvdatë se martuan një vajzë të re 		<ul style="list-style-type: none"> Varfëria Dëshira për t'i dhënë fëmijës një jetë më të mirë 	<ul style="list-style-type: none"> Martesa e fëmijëve/ e hershme është pengesë për 'vetë-realizimin' Adoleshentët nuk janë gati Martesa e fëmijëve/e hershme është pengesë për arsimin dhe punësimin
Jo romë që jetojnë në zona urbane	<ul style="list-style-type: none"> Frikë nga sanksioni social Trysni nga komuniteti Frika se mos 'mbeten pas' 		<ul style="list-style-type: none"> Varfëria Dëshira për t'i dhënë fëmijës një jetë më të mirë 	<ul style="list-style-type: none"> Martesa e fëmijëve/ e hershme është pengesë për 'vetë-realizimin' Adoleshentët nuk janë gati Martesa e fëmijëve/e hershme

**d.m.th. konsiderohet shumë e madhe për t'u martuar*

Parapëlqimet e kushtëzuara pro martesës së fëmijëve

Pjesëmarrësit në grupet e fokusit nga të katër grupet e popullsisë ose shprehën parapëlqime të kushtëzuara për martesën e fëmijëve vetë ose folën se si parapëlqimet për martesën e fëmijëve mes njerëzve të tjerë në komunitetin e tyre ishin të kushtëzuara nga pritshmëritë sociale. Këto pritshmëri sociale lidhen me:

- Frikën nga thashethemet dhe zërat (për shembull, që një vajzë është e lidhur me një djalë ose nuk është më e virgjër) dhe forma të tjera të sanksioneve sociale;
- Presionin nga fisi dhe komuniteti më i gjerë;
- Frikën se mos vajzat 'mbeten pas', nëse nuk martohen herët;
- Lavdërim nga fisi dhe komuniteti më i gjerë nëse e martojnë vajzën'

Në përgjithësi, të dhënat nga diskutimet e grupeve të fokusit tregojnë se për romët që jetojnë në komunitete të veçuara dhe të integruara, pritshmëritë sociale luajnë një rol shumë të fortë në formësimin e parapëlqimeve për martesën e fëmijëve.

Nga të gjitha grupet pjesëmarrëse, romët e rinj që jetojnë në komunitete të veçuara kishin më shumë gjasa të shprehin një parapëlqim të fortë të kushtëzuar pro martesës së fëmijëve (të vajzave).

"Për vajzat është mirë të martohen në moshë të re, sepse ruajnë namin, nderin dhe krijojnë një familje të mirë dhe të fortë. Sa më shpejt, aq më mirë se, siç themi ne, 'vajzat kanë flokë të gjatë, por mendje të shkurtër!'"

[DGF – djem të rinj romë që jetojnë në komunitete të veçuara]

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Ata folën gjerësisht se si pritshmëritë sociale i shtyjnë vajzat drejt martesës së hershme. Kjo përfshinte frikën e turp-it që rezultoi nga thashethemet dhe ndikimi i asaj që bënin të tjerët në komunitet.

Të dhënat nga grupet e fokusit me jo-romë që jetojnë në komunitetet rurale dhe urbane tregojnë se edhe parapëlqimet në këto bashkësi për martesën e fëmijëve ndikohen gjithashtu shumë nga pritshmëritë sociale. Për të anketuarit jo-romë nga zonat urbane, dënimi shoqëror i marrëdhënieve të adoleshentëve u shfaq si pritshmëria më e rëndësishme shoqërore, që i shtyn adoleshentët drejt martesës. Në të kundërt, për pjesëmarrësit jo-romë nga zonat rurale, frika nga thashethemet, zërat ose forma të tjera sanksionesh sociale, dhe frika se mos 'mbeten pas' ishin më domethënëse.

Frika nga sanksionet sociale

Nga grupet e fokusit me pjesëmarrës romë, është e qartë se frika nga thashethemet, zërat dhe forma të tjera sanksionesh sociale formësojnë parapëlqimin e njerëzve për t'i martuar vajzat sa janë ende fëmijë dhe se kjo është e lidhur ngushtë me rëndësinë e 'nderit'.

Disa të anketuar romë folën se si një vajzë (dhe familja e saj) mund të përballen me sanksione të rëndësishme sociale, nëse zbulohet se ajo nuk ishte e virgjër natën e martesës, siç është 'kthimi mbrapsht' në shtëpinë e prindërve të saj.

"Nëse ajo martohet dhe burri zbulon se ajo nuk është e virgjër, jo vetëm që e kthejnë mbrapsht në familjen e saj, por edhe e detyrojnë familjen t'u japë para për të gjitha shpenzimet e dasmës."

[IIK – punonjës social në komunitetin romë]

Të martoje vajzën në moshë të vogël shihej si një mënyrë për të shmangur zërat për namën e saj dhe kjo ishte një konsideratë shumë e rëndësishme për familjet dhe një faktor i rëndësishëm që i shtynte adoleshentët drejt martesës.

"Ka raste kur ajo punon ose ndjek universitetin, por gjithmonë do të ketë thashetheme për të, kështu që është më mirë që ajo të martohet që prindërit e saj të mos turpërohen."

[DGF – vajza të reja romë që jetojnë në komunitete të integruara]

Pjesëmarrësit e komuniteteve jo-rome rurale dhe urbane folën gjithashtu për rolin e zërave dhe thashethemeve në shtyrjen e vajzave drejt martesës së hershme (d.m.th. para moshës 20 vjeç), në mos drejt martesës në moshë të vogël, dhe thashethemet dhe 'skandali' që do plasnin në qoftë se merrej vesh se një çift i ri ishte lidhur apo edhe nëse djemtë dhe vajzat thjesht shoqërohen me njëri-tjetrin. Në këto raste, prindërit do t'iu bënin presion fëmijëve që të martoheshin sa më shpejt të jetë e mundur, me qëllim që t'iu pritej rruga thashethemeve. Ishte edhe më keq, nëse zbulohej se vajza ishte shtatzënë.

"Nëse prindërit të zbulojnë, nuk ke më çfarë bën."

[DGF – djem të rinj jo-romë që jetojnë në komunitete rurale]

Trysnia e komunitetit

Analiza e të dhënave nga DGF-të me të dyja popullatat romë zbulon se prindërit përballen me trysni të konsiderueshme nga fisi dhe komuniteti më i gjerë për t'i martuar vajzat si dhe të pranojnë kërkesën e një të riu për t'u martuar me vajzën.

"Po, ka shumë presion. Nëse shoku im e marton vajzën, atëherë unë duhet të bëj të njëjtën gjë, përndryshe ajo do të mbetet në shtëpi dhe nuk do të gjejë burrë."

[DGF – djem të rinj romë që jetojnë në komunitete të veçuara]

Burimet e trysnisë përfshinin të afërm më të moshuar -me ç'rast ishte shumë e vështirë të kundërshtojë pikëpamjet e tyre - dhe fqinjët.

"Kur në këto familje ka njerëz të moshuar, ata vendosin kur është koha e duhur për martesë dhe është e vështirë t'iu kundërvihesh."

[DGF – djem të rinj romë që jetojnë në komunitete të veçuara]

“Nëse vajza e fqinjit të tyre u martua, edhe ata duhet të gjejnë një burrë për vajzën e tyre.”
[IIK – punonjës i njësisë së mbrojtjes së fëmijëve]

Edhe gratë dhe burrat më të rinj nga komunitetet jo-rome në zonat urbane përmendën se si presioni nga familja dhe komunitetet e tyre do të thotë se sapo një marrëdhënie adoleshente zbulohet, çifti do të duhet të fejohej ose të martohet.

“Ndoshta presioni nga njerëzit e të tjerë i bën të fejohen më shpejt, sepse nuk mund të dalin në publik lirisht.”

[DGF – vajza të reja jo-rome që jetojnë në zona urbane]

Frika se mos ‘mbeten pas’

Në të dhënat nga DGF-të me të katër grupet e popullsisë është e qartë se ka një bindje të fortë se është e vështirë - ose e pamundur - që një grua të martohet mbi një moshë të caktuar. Mosha kufi dukej se ishte midis 18 dhe 20 vjeç. Kjo e rrit presionin mbi vajzat që të martohen shumë të reja në mënyrë që të mos ‘mbeten pas’.

“Djemtë kërkojnë vajzë në moshë të re, kështu që ne duam ta kryejmë martesën sa më shpejt që mundemi, sepse, nëse ato bëhen më të mëdha, askush nuk i do.”

[DGF – baballarë/kujdestarë romë që jetojnë në komunitete të integruara]

Një i anketuar në grupin me baballarë nga një bashkësi rurale jo-rome përmendi se kjo ishte veçanërisht problem për vajzat dhe familjet që jetojnë në zona të largëta.

“... kur kalojnë një moshë të caktuar, askush nuk do t’i dojë më dhe, ngaqë është një zonë e izoluar dhe mundësitë për të takuar njerëz janë aq të pakta, ata i martojnë vajzat me rastin e parë që ju jepet.”

[DGF – baballarë/kujdestarë jo-romë që jetojnë në komunitete rurale]

Të anketuarit nga zonat rurale folën për presionin e komunitetit që vajzat të martohen, sapo mbarojnë shkollën e mesme, pasi, përndryshe do të ishte shumë vonë dhe ato do të ‘mbeteshin prapa’. Megjithatë, frika se mos vajzat ‘mbeten pas’, nëse nuk martohen në moshë të re u diskutua po ashtu nga të anketuarit në zona urbane. Informatorët kyç folën edhe për frikën e ‘të mbeturit pas’ që ndikon në vendimin për t’u martuar në moshë të re, dhe si kjo lidhet me shqetësimet rreth ‘nderit’.

“Nëse vajza kalon moshën 18 vjeç, ajo nuk konsiderohet më me nder dhe nuk ka më kërkesa për ta martuar, kështu që ajo konsiderohet e mbetur.”

[IIK – punonjës i gjendjes civile]

Lavdërim se martoi vajzën

Përveç sanksioneve, është po ashtu e rëndësishme të vlerësohet roli i fiseve dhe komuniteteve që miratojnë martesat e fëmijëve (ose martesat e hershme) përmes lavdërimit. Ishte e qartë se për pjesëmarrësit romë (nga komunitetet e veçuara dhe të integruara), ky ishte një faktor i rëndësishëm në formësimin e parapëlqimeve të njerëzve për martesat e fëmijëve.

“Për familjet është gjë e mirë ta martojnë vajzën e tyre herët; kjo lavdërohet në komunitet dhe njerëzit e marrin shembull.”

[DGF – djem të rinj romë që jetojnë në komunitete të veçuara]

Vërtet, gra më të mëdha përmendën se, nëse një familje e marton vajzën ose djalin sa është shumë e re ose i ri, nuk ka rrezik që familja të përballet me dënimin ose ndonjë sanksion negativ.

“Askush në komunitet nuk gjykon kur të rinjtë martohen, sepse tradita ka ndikim të madh.”

[DGF – nëna/kujdestare rome që jetojnë në komunitete të integruara]

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Lavdërimi për martesën e vajzës sa është e vogël, nuk ishte vetëm një faktor që mbështeste parapëlqimet për martesën e hershme dhe të fëmijëve në komunitetet rome, siç tregon ky ekstrakt nga një grua e re jo-rome që jeton në një komunitet rural.

“Kur prindërit vendosin dhe ia arrijnë ta martojnë vajzën rreth moshës 18-20 vjeç, njerëzit në fshat i përgëzojnë: ‘E arrite këtë ditë’ dhe po ‘i rregulloni’ fëmijët tuaj me nder!”

[DGF – vajza të reja jo-rome që jetojnë në komunitete rurale]

Parapëlqimet e kushtëzuara kundër martesës së fëmijëve

Në përgjithësi, analiza e të dhënave nga të gjitha grupet e fokusit tregon se pritshmëritë sociale luajnë rol të vogël në formësimin e parapëlqimeve kundër martesës së fëmijëve, për cilindo prej këtyre grupeve të popullsisë.

Gjatë një DGF-je me gra më të mëdha rome që jetojnë në komunitete të integruara u përmend roli i arsimit në ndikimin e qëndrimeve të adoleshentëve ndaj martesës së fëmijëve.

“Arsimi ndikon, nëse shkojnë në shkollë, do ta kuptojnë se martesa e fëmijëve nuk është gjë e mirë.”

[DGF – nëna/kujdestare rome që jetojnë në komunitete të integruara]

Gjatë një grupi fokusi me gra më të mëdha jo-rome nga komunitete urbane, pjesëmarrëset përmendën se si moshë kur u martuan ato, do të ndikonte kur do të martohen fëmijët e tyre.

“Moshë e përshtatshme për t’u martuar në komunitetin tonë është 22-23 vjeç për vajzat dhe 25-28 vjeç për djemtë. Kjo është një moshë e përshtatshme, sepse edhe ne u martuam në këtë moshë dhe do t’ua kalojmë traditën fëmijëve tanë.”

[DGF – nëna/kujdestare jo-rome që jetojnë në zona urbane]

Një faktor tjetër që ndikon në parapëlqimet e të rinjve romë kundër martesës së fëmijëve është socializimi me njerëz nga komunitetet jo-rome.

“Fëmijët dhe të rinjtë bëhen më të vetëdijshëm në shkollë. Madje edhe opinioni publik i ndikon ata, sepse duke u shoqëruar me bashkëmoshatarët e tjerë (jo-romë), të rinjtë tanë nuk duan të martohen në moshë të re.”

[DGF – nëna/kujdestare rome që jetojnë në komunitete të integruara]

Parapëlqime të pakushtëzuara pro martesës së fëmijëve

Pjesëmarrësit në të gjitha grupet e fokusit diskutuan ndikimin e bindjeve vetjake në lidhje me atë që është moralisht e drejtë apo e gabuar (bindjet jo-sociale normative) dhe bindjet rreth realiteteve faktike (bindje jo-sociale faktike) mbi parapëlqimet e tyre për martesën e fëmijëve ose parapëlqimet e njerëzve të tjerë në komunitetet e tyre.

Gjerësisht, bindjet morale individuale (dmth, bindjet jo-sociale normative) që i japin formë parapëlqimeve të pakushtëzuara për martesën e fëmijëve lidheshin me:

- Zakonin dhe traditën
- ‘Nderin’ dhe rëndësinë që vajzat dhe gratë të mbeteshin të virgjëra deri në martesë

Realitetet faktike (d.m.th., bindjet jo-sociale faktike) që i japin formë parapëlqimeve të pakushtëzuara për martesën e fëmijëve lidheshin me:

- Varfërinë ose faktorë të tjerë ekonomikë, siç është migrimi
- Dëshirën për një jetë më të mirë për fëmijën
- Adoleshenca si koha e duhur për t’u martuar
- Arratisjen nga jeta e dhunshme dhe abuzive në shtëpi

Dukshëm, këto bindje kishin një ndikim të fortë në komunitetet nëpër të katër grupet e popullsisë, megjithëse kishte disa dallime. Për romët - me pak dallim midis pjesëmarrësve nga komunitetet e veçuara dhe jo të veçuara - bindjet morale vetjake në lidhje me 'nderin' dhe rëndësinë e martesës së fëmijëve si traditë ishin jashtëzakonisht të rëndësishme në formësimin e parapëlqimeve të pakushtëzuara për martesën e fëmijëve, veçanërisht mes grave. Kjo ishte shumë më pak e theksuar për të anketuarit, të cilët nuk ishin romë. Megjithatë, për të anketuarit nga të katër grupet e popullsisë, varfëria dhe dëshira për t'u përpjekur për t'i dhënë fëmijës një jetë më të mirë ishin faktorë të rëndësishëm që formësonin mbështetjen për martesën e hershme (para moshës 20 vjeç) dhe të fëmijëve (para moshës 18 vjeç).

Pjesëmarrësit në të gjitha grupet e fokusit përmendën se rënia në dashuri e të rinjve formësonte parapëlqimin për martesën e fëmijëve, edhe pse në rastin e një pjesëmarrësi më të madh në moshë, kjo ishte në kuadrin e 'kufizimit të dëmit'.

“Ata [prindërit] nuk mund të bëjnë asgjë; duhet t'i martojnë ato [vajzat], sepse përndryshe ato do të bëjnë një skandal, do të bëjnë vetëvrasje ose do të largohen nga shtëpia.”

[DGF – baballarë/kujdestarë romë që jetojnë në komunitete të integruara]

Sigurisht që është e rëndësishme të njohësh dhe të pranosh fuqinë e të rinjve në zgjedhjen për t'u martuar, por është e nevojshme të mbahet parasysh kuadrin moral dhe shoqëror brenda të cilit merren vendime të tilla. Siç është diskutuar në seksionin e mësipërm dhe përsëri në seksionin mbi 'Mundësitë e zgjedhjes', adoleshentët dhe të rinjtë zgjedhin të martohen në një kontekst ku nuk gjykohet e pranueshme nga shoqëria që ata të lidhen dhe/ose të kenë marrëdhënie seksuale jashtë martesës. Për adoleshentët dhe të rinjtë që duan të jenë së bashku, zgjedhja që bëjnë duke u martuar, shpesh është e vetmja rrugë.

Zakonet dhe traditat

Pjesëmarrësit në grupet e fokusit të zgjedhur nga komunitetet rome (të veçuara dhe të integruara) theksuan se martesa e fëmijëve vlerësohet të jetë një traditë ose zakon i fortë në komunitetet e tyre dhe ky është një faktor shumë i rëndësishëm në formësimin e parapëlqimeve të pakushtëzuara për këtë praktikë.⁷³

Në një grup fokusi me gra të reja, një pjesëmarrëse u përgjigj thjesht:

Epo, e kemi traditë të martohemi herët.

[DGF – vajza të reja rome që jetojnë në komunitete të veçuara]

Kjo deklaratë tërheq vëmendjen për sfidat në drejtim të nxitjes së njerëzve që të mendojnë ndryshe rreth një praktike që e shohin si traditë dhe, për pasojë, si diçka të pandryshueshme dhe të ngulitur. Thënë kjo, pjesëmarrësit në një grup fokusi me burra më të rinj folën tërthorazi për disa konflikte mes të moshuarve dhe të rinjve në lidhje me respektimin e traditave, ndoshta duke treguar se qëndrimet po fillojnë të ndryshojnë.

“Kur ke të moshuar në shtëpi, je i detyruar të ndjekësh traditat e komunitetit, sepse ato janë shumë të rëndësishme për të moshuarit.”

[DGF – djem të rinj romë që jetojnë në komunitete të veçuara]

Në të kundërt, me përjashtim të pjesëmarrësve në një DGF me baballarë/ kujdestarë jo-romë që jetojnë në komunitete rurale, asnjë nga pjesëmarrësit jo-romë nuk foli për martesën e fëmijëve në termat e zakonit ose traditës. Në fakt, një pjesëmarrëse u përpoq shumë të theksonte se për sa i përket asaj, nuk ishte një zakon, por diçka që kishte dalë këto kohë e fundit.

“Nuk ka qenë zakon të martohesh herët. Nuk ka qenë kurrë. Por, po ndodh kohët e fundit, sepse të rinjtë bien në dashuri në një moshë të re.”

[DGF – nëna/kujdestare jo-rome që jetojnë në komunitete rurale]

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Bindja në rëndësinë e ‘nderit’

Analiza e të dhënave nga grupet e fokusit me romët tregon se bindja që martesa e fëmijëve është një traditë e rëndësishme është e lidhur ngushtë me bindjen se vajza duhet të jetë e virgjër kur martohet, për të mbrojtur ‘nderin’ e saj (dhe të familjes).

“Tradita për të mbrojtur nderin e vajzës ekziston ende dhe kjo është një arsye shumë e fortë pse ka akoma martesa të hershme.”

[DGF – djem të rinj romë që jetojnë në komunitete të integruara]

Megjithatë, u shfaqën disa dallime të rëndësishme. Në DGF-të me romë që jetojnë në komunitete të veçuara, pjesëmarrësit në secilin grup fokusi përmendën rëndësinë e mbrojtjes së ‘nderit’ dhe pse kjo kërkonte që vajzat të martoheshin në një moshë shumë të re, edhe nëse martesa në këtë moshë kaq të re ishte e dëmshme për vajzën.

“Ato nuk janë gati [për martesë], por për ne është më e rëndësishme të ruhet nderi i tyre.”

[DGF – nëna/kujdestare rome që jetojnë në komunitete të veçuara]

Në të kundërt, mes romëve nga komunitetet e integruara, vetëm gratë folën për rëndësinë e ‘nderit’ dhe virgjërisë dhe lidhjeve të tyre me martesën e fëmijëve. Disa kishin pikëpamje shumë të ngulitura për këtë çështje.

Do ta vrisja vajzën me duart e mia, para se ta lejoja [të merrte rrugë të keqe].

[DGF – nëna/kujdestare rome që jetojnë në komunitete të integruara]

Në DGF-të me jo-romë që jetojnë në komunitete rurale dhe urbane, rëndësia e ‘nderit’ u përmend pak, edhe pse qartazi mbetet ende një çështje. Megjithatë, me deklaratat e bëra nga këto grupe të popullsisë, ishte shumë më e vështirë të kuptoje nëse pikëpamjet për rëndësinë e nderit formësoheshin nga bindjet personale, morale apo nga pritshmëritë sociale.

Kanë frikë për nderin e tyre, kështu që sapo marrin një propozim për vajzën, e martojnë menjëherë.

[DGF – djem të rinj jo-romë që jetojnë në komunitete urbane]

Në fakt, një nga pjesëmarrëset më të reja besonte se ‘nderi’ është bërë shumë më pak i rëndësishëm.

Nderi ka kaluar në plan të dytë, nuk është më problem, sepse mund të gjesh një zgjidhje.

[DGF – vajza të reja jo-rome që jetojnë në komunitete rurale]

Varfëria

Pjesëmarrësit nga të gjitha grupmoshat dhe grupet e popullsisë e cilësuan varfërinë si një ‘realitet faktik’ të rëndësishëm që mbështet preferencën për martesën e fëmijëve, ku prindërit vendosin t’i martojnë vajzat - ose ta pranojnë martesën - si një mënyrë për të lehtësuar tryshninë financiare në shtëpi.

“Në familjet me shumë fëmijë, kur vajzat rriten dhe vajza e dytë është aq e rritur sa të kujdeset për më të vegjlit, nëna e marton të parën për të ulur shpenzimet.”

[DGF – djem të rinj romë që jetojnë në komunitete të veçuara]

Ata vunë në dukje se familjet në gjendje më të mirë ekonomike prireshin t’i martonin vajzat më vonë dhe se mbipopullimi në shtëpi u identifikua si një faktor tjetër që i shtyn vajzat në martesë.

Shumë pjesëmarrës bënë gjithashtu lidhjen midis familjes që nuk mund ta përballojë të dërgojë vajzën në shkollë dhe vendimit për ta martuar atë.

“... [prindërit] nuk kanë mundësi t’i dërgojnë [vajzat] në shkollë, nuk kanë kushte të mira jetese për shkak të ekonomisë, prandaj i martojnë.”

[DGF – vajza të reja jo-rome që jetojnë në komunitete rurale]

Varfëria u përmend gjerësisht si nxitës i martesës së fëmijëve edhe në intervistat me informatorë kyç.

“Mendojnë se duke e martuar vajzën me një burrë të pasur do t’i ndihmojë t’i shpëtojnë varfërisë ku gjenden.”

[IIK –punonjës social]

Mundësia e një jete më të mirë

Përsëri, nëpër të katër grupet e popullsisë, pjesëmarrësit pranuan se, përveçse duan të lehtësojnë vështirësitë dhe mungesat që kanë në shtëpi, shumë prindër duan të përpiqen dhe të bëjnë më të mirën për vajzat e tyre dhe t'u japin atyre një jetë më të mirë. Për shumë prindër, martesa me një burrë në një situatë të qëndrueshme financiare dukej se ishte mënyra më e mirë për ta bërë këtë.

“Nëse gjejnë një burrë të mirë me një gjendje të mirë ekonomike, do të rregullojnë të ardhmen e vajzës së tyre.”

[DGF – nëna/kujdestare jo-rome që jetojnë në komunitete rurale]

Në një grup fokusi me djem më të rinj, pjesëmarrësit folën gjithashtu për atë se si martesa mund t'i ofrojë një vajze një 'jetë më të mirë' në mënyra të tjera, jo-materiale.

“... edhe për vajzat është më mirë të martohen, nëse nuk do të shkojnë në shkollë apo të punojnë, kështu mund të kenë jetën e tyre.”

[DGF – djem të rinj jo-romë që jetojnë në zona urbane]

Në disa DGF me jo-romë (nga komunitete rurale dhe urbane), të martosh vajzën me një burrë që kishte emigruar shihej përsëri si një mënyrë për t'i dhënë vajzës një mundësi për një 'jetë më të mirë'. Kjo u përmend edhe nga një informator kyç, edhe pse ky nuk mendonte se raste të tilla ishin shumë të zakonshme.

“Zakonisht, duan që vajza e tyre të jetojë rehat, sidomos me emigrantët në Angli dhe Itali. Nuk është se mendojnë shumë për atë se çfarë personi është ai; thjesht mendojnë se ai duhet të jetojë mirë, meqë është emigrant.”

[IIK – punonjës i njësishë së mbrojtjes së fëmijëve]

Emigracioni nuk u përmend në asnjë prej DGF-ve me romët.

Një informator kyç foli gjithashtu për përgjegjësinë që ndajnë prindërit ndaj fëmijëve të tyre për t'u siguruar që fëmijët të martohen dhe rehatohen.

“Prindërit ndajnë se detyrimi ndaj fëmijëve përmbushet, kur ata martohen dhe kanë familjet e tyre.

[IIK – punonjës social]

Kutia 6: Dëshira për t'u martuar si mundësi për një jetë më të mirë***‘Doja të largohesha, sepse ishim keq ekonomikisht.’***

Vajzat nga zona jonë martohen në moshën 14-15 vjeç, sepse kjo është tradita. Djemtë martohen 18-19 vjeç...

Rashë në dashuri me burrin tim të parë dhe nuk i kërkova miratim nënës. Ai më gënjeu dhe unë isha e re. Më pas grindeshim dhe unë doja të largohesha, sepse ekonomikisht ishim keq gjithashtu [në shtëpi].

Burri më mori kur isha 15 vjeç, pa pyetur askënd.

Ishte vendimi im dhe i burrit tim, sepse, siç thashë, ai më gënjeu, tha se do të ishim të lumtur në Greqi dhe do të punonim edhe atje. Mami im nuk donte që të martohesha dhe bëri sherr me familjen e burrit, por unë nuk ia vura veshin asaj.

Isha e re, e papjekur dhe kishim një situatë vërtet të keqe [ekonomike] në shtëpinë e mamit. Ai më gënjente gjithë kohën ... dhe sapo nisëm lidhjen, më mori në shtëpinë e tij.

[II - Vajzë e re rome e martuar para moshës 18 vjeç]

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Adoleshenca është moshë e duhur për martesë

Ndërkohë që nuk u shpreh gjerësisht, disa pjesëmarrës nga DGF-të me gra rome folën për besimin se vajzat adoleshente ishin fizikisht të gatshme për martesë dhe amësi.

“Po, janë gati [për martesë], meqënëse vajzat janë të zhvilluara, ‘biologjikisht/fizikisht’ flas.”
[DGF – vajza të reja rome që jetojnë në komunitete të veçuara]

Një pjesëmarrëse më e vjetër foli për adoleshencën si faza e duhur për vajzat dhe djemtë që të ecnin përpara dhe të krijojnë familjen e tyre, në mënyrë që prindërit të mos i kishin më përgjegjësi.

“Do të bënin mirë të kishin fëmijët e tyre. Nuk do të kujdesemi për ta gjithë jetën.”
[DGF – nëna/kujdestare rome që jetojnë në komunitete të integruara]

Kjo ide - që prindërit donin që fëmijët e tyre të ecnin përpara, në mënyrë që të mos kishin më përgjegjësi për ta - u shpreh edhe në një grup fokusi me gra jo-rome që jetojnë në komunitetet rurale.

Kutia 7: Kur gjithçka del mirë

‘Do të doja që vajza ime të martohej 16 ose 17 vjeç, ashtu siç bëra unë.’

Unë u martova kur isha 16 vjeç. Një herë, erdhi halla e nënës sime dhe foli me nënën se sa shumë isha rritur dhe se ishte koha të martoheja. Sapo kisha përfunduar klasën e 9-të dhe ajo kishte gjetur një djalë të mirë për mua dhe më pyetën për këtë. Më pëlqeu dhe kur babai më pyeti, i thashë të njëjtën gjë, kështu që u fejuam. Atij i pëlqeva, mua më pëlqeu, gjendja e tij ekonomike ishte e mirë dhe kishte një shtëpi të bukur. Prindërit e mi folën me prindërit e tij dhe ranë dakord.

Ndenjëm të fejuar për rreth një vit dhe pastaj u martuam. Patëm një dasmë të madhe, sepse isha e bukur, prandaj i pëlqejta familjes së burrit. Isha 16 vjeç dhe burri ishte 20 vjeç. Pas një viti së bashku, patëm fëmijën tonë të parë, kur isha 17 vjeç. Kemi 4 vite që jemi martuar kemi 2 fëmijë. Është më mirë nëse vajzat martohej herët, sepse nëse vijnë vërdallë askush nuk do t’i dojë më. Kur vajza ime të rritet, do të doja që ajo të martohej sapo të ishte gati, ashtu si bëra unë dhe doli shumë mirë. Do të doja që vajza ime të martohej 16 ose 17 vjeç, ashtu siç bëra unë. Dhe dua që edhe ajo të martohet me një burrë të mirë.

[II - Vajzë e re rome e martuar para moshës 18 vjeç]

Arratisje nga jeta e trishtueshme në shtëpi

Ndërsa nuk u diskutua gjerësisht, vajzat më të reja që jetojnë në komunitete të veçuara përmendën gjithashtu se një vajzë mund të zgjedhë të martohet ose të pranojë martesën, si një rrugë për t’u larguar nga një gjendje abuzive në shtëpi.

“Ndonjëherë, ndodh që vajzat duan të martohej, sepse duan të largohen nga shtëpia, pasi përjetojnë dhunë atje, si dhe pamundësinë për të përmbushur ëndrrat e tyre.”
[DGF – vajza të reja rome që jetojnë në komunitete të veçuara]

Kjo u përmend edhe në një nga intervistat me informatorë kyç.

“... ka raste të dhunës në familje, gjë që i bën vajzat ta shohin martesën si një rrugëdalje...”
[IIK – punonjës social]

Kutia 8: Martesa e fëmijëve për të ‘mbrojtur’ vajzën

‘Mendova se do të ishte më mirë ta martoja vajzën dhe, së paku, të shpëtoja atë.’

Unë vetë u martova 13 vjeç dhe e di që nuk është e lehtë të kujdesesh për familjen në atë moshë, sepse je vetë fëmijë. Por burri im pinte shumë, përdorte drogë dhe sillej keq në shtëpi. Kur vajza ime mbushi 13 vjeç, ma ‘kërkoj’ një familje e mirë. Pasi pyeta vërdallë për krushqit dhe më thanë se ishin njerëz të mirë, e martova vajzën. Nuk mund ta mbaja në shtëpi me burrin që kisha.

Ç’mund të bëja tjetër?! Nuk mund ta lija burrin, sepse kisha frikë. Mendova se do të ishte më mirë të martoja vajzën dhe, së paku, të shpëtoja atë.

I thashë vajzës se e kishin kërkuar për martesë dhe se ata janë njerëz shumë të mirë. Ajo e takoi edhe djalin dhe ra dakord.

E dimë që fëmijët nuk duhet të martohen kaq të rinj. Ata duhet të jenë të paktën 27-28 vjeç. Por kështu ishte shkruar fati.

Vajza ime është në rregull aty ku është e martuar. Familja e burrit e trajton mirë. Ne jetojmë afër, kështu që e takoj çdo ditë. Ne nuk shkojmë në shkollë dhe gratë nuk punojnë. Ajo qëndron në shtëpi dhe kujdeset për familjen.

[II - Nënë rome e cila ka martuar fëmijët para moshës 18 vjeç]

Parapëlqimet e pakushtëzuara kundër martesës së fëmijëve

Bindjet morale vetjake (bindjet jo-sociale normative) dhe pikëpamjet mbi realitetet faktike (bindjet jo-sociale faktike) kishin po ashtu një ndikim të fortë në formësimin e preferencave të pakushtëzuara kundër martesës së fëmijëve.

Bindjet morale vetjake (dmth, bindjet jo-sociale normative) që formësojnë parapëlqimet e pakushtëzuara kundër martesës së fëmijëve lidheshin me:

- Të drejtën për të vendosur lirisht vetë kur dhe me kë duhet të martohesh;
- Rëndësinë e përvojës së jetës dhe ‘vetërealizimit’.

Realitetet faktike (dmth, bindjet jo-sociale faktike) që formësojnë parapëlqimet e pakushtëzuara kundër martesës së fëmijëve lidheshin me:

- Mungesën e pjekurisë së adoleshentëve dhe mungesën e gatishmërisë për martesë;
- Ndikimin negativ të martesës së fëmijëve në arsim dhe punësim.

Pjesëmarrësit në të katër grupet e popullsisë dhe në të gjitha grupmoshat shprehën parapëlqime të pakushtëzuara të forta kundër martesës së fëmijëve, përfshirë komunitetet ku martesa e fëmijëve ishte praktikë e zakonshme (duke gjykuar nga diskutimi gjatë grupeve të fokusit). Dy përjashtimet nga kjo, ishin gratë më të mëdha rome që jetonin në komunitete të veçuara dhe burrat më të mëdhenj romë që jetonin në komunitete të integruara; asnjëri nga këto dy grupe nuk shprehu ndonjë preferencë të pakushtëzuar kundër martesës së fëmijëve.

Vajzat më të reja nga komunitetet rurale shprehën parapëlqimet e pakushtëzuara më të forta kundër martesës së fëmijëve. Analiza e diskutimit të tyre tregon se një gamë e gjerë e bindjeve të ndryshme jo-sociale, normative dhe faktike, përcaktojnë këto parapëlqime.

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Liria për të vendosur

Disa pjesëmarrës që morën pjesë në grupet e fokusit të burrave më të mëdhenj dhe më të rinj nga komunitetet rome të veçuara shprehën qartë besimin se një çift i ri duhet të ketë mundësinë ta njohë mirë njëri-tjetrin dhe të vendosin vetë nëse do të martohen, në vend që t'i shtyjnë në martesë.

“Mendoj se fëmijët duhet të kenë lirinë e tyre, brenda kufijve, sigurisht.”
[DGF – baballarë/kujdestarë romë që jetojnë në komunitete të veçuara]

Në mënyrë interesante, kjo ide nuk u diskutua gjerësisht nga ndonjë grup tjetër popullsie në asnjë DGF.

‘Vetë-realizimi’

Në disa prej DGF-ve me pjesëmarrës, të cilët nuk ishin nga komunitetet rome, gratë në veçanti, folën për mënyrën se si martesë herët ishte pengesë për ‘vetë-realizimin’. Parapëlqimet e tyre kundër martesës së hershme (para moshës 20 vjeç) ose të fëmijëve (para moshës 18 vjeç) formësoheshin nga ideja se të rinjtë nuk duhet të martohen, derisa të kenë patur mundësinë të përmbushin veten, ‘të bëjnë pak jetë’ dhe të njohin bashkëshortin/en e tyre të ardhshëm.

“.. do të ishte më mirë pas moshës 24 vjeç. Ke mbaruar studimet, ke një punë, ke patur edhe kohën për të udhëtuar dhe për të shijuar lirinë tënde dhe je gati të marrësh përsipër përgjegjësi.”
[DGF – vajza të reja jo-rome që jetojnë në zona urbane]

Është e mundur të spekulohet se fakti që asnjë nga pjesëmarrësit romë nuk foli në terma të ‘vetë-realizimit’ mund të pasqyrojë marginalizimin dhe përjashtimin social me të cilin përballen romët në Shqipëri, që do të thotë se mundësitë për ‘vetë realizim’ (p.sh. përmes arsimit të lartë ose udhëtimit) janë jashtëzakonisht të kufizuara. Megjithatë, kjo do të kërkonte hetime të mëtejshme.

Adoleshentët nuk janë gati

Pjesëmarrës nga shumë DGF nga të katër grupet e popullsisë shprehën një preferencë kundër martesës së fëmijëve që bazohet në besimin e tyre se adoleshentët nuk kishin pjekurinë e duhur për martesë. Në pjesën më të madhe, kjo u shpreh në aspektin se adoleshentët nuk janë gati të marrin përsipër përgjegjësitë e martesës. Sidomos për vajzat e martuara, kjo do të çonte në dështimin e tyre për të përmbushur rolin e gruas dhe nënës në mënyrë të përshtatshme, si dhe në konflikte të mundshme me burrin dhe familjen e tij.

“Nuk do ta martoj vajzën, nëse nuk është 20 vjeç, sepse ajo nuk është mjaft e pjekur dhe ajo nuk di të bëjë asgjë, gjë që do t’i krijonte shumë probleme.”
[DGF – nëna/kujdestare jo-rome që jetojnë në zona urbane]

Megjithatë, një pjesëmarrës më i ri iu referua edhe aspektit emocional të martesës dhe se martesë ishte ‘shumë më e vështirë’ se një marrëdhënie. Sipas mendimit të tij, adoleshentët që martoheshin nuk e kishin idenë se ku po futeshin.

“Sipas mendimit tim, vajzat nuk duhet të martohen para se të jenë 20 vjeçe, sepse martesë nuk është e njëjta gjë sikur të jesh në një marrëdhënie; ajo është shumë më e vështirë....”
[DGF – djem të rinj jo-romë që jetojnë në zona urbane]

Ndikimet negative në arsim dhe punësim

Nëpër të katër grupet e popullsisë, pjesëmarrësit shprehën qartë pikëpamjen se e shihnin martesën e fëmijëve si pengesë për arsimin dhe punësimin dhe se kjo formëonte parapëlqimet kundër kësaj praktike. Shumë shprehën mendimin se si vajzat, ashtu edhe djemtë duhet të përfundojnë arsimin dhe të arrijnë një farë qëndrueshmërie financiare, para se të mendojnë për martesën. Kjo përfshinte pjesëmarrës nga komunitetet rome dhe nga komunitetet rurale jo-rome, ku ishte e qartë nga diskutimi se në fakt kishte shumë pak mundësi punësimi në dispozicion.

“Martesa në moshë të re nuk është e mirë as për vajzat, as për djemtë. Nëse do të kisha një të afërm/ në këtë situatë, do ta këshilloja të presë derisa të përfundojë shkollën, të gjejë një punë dhe pasi të ketë krijuar një [farë] qëndrueshmërie ekonomike, atëherë ai/ajo duhet të krijojë familje.”

[DGF – djem të rinj romë që jetojnë në komunitete të veçuara]

Kutia 9: Shkolla është e ardhmja

‘... këshilla ime për vajzat e tjera është: mos bëni gabimet e mia, mos bëni atë që bëra unë.’

Në atë moshë dukej si gjëja më e mirë në botë, mendova se do të kisha një jetë më të mirë dhe se do të isha e lumtur ose se do të ishte diçka e veçantë për mua, se do të kisha një shtëpi, një familje, fëmijë dhe gjëra më të mira, në përgjithësi. Unë u rrita si jetime dhe e kisha zakon të shihja të tjerët të martoheshin dhe të ishin të lumtur, im atë na la kur isha 6 vjeç, kështu që nënës iu desh të bëhej edhe baba, mendova se do të ishte gjë e mirë, por ndodhi e kundërta.... [...]

Nuk shkova fare në shkollë. Babai na la kur isha 6 vjeç, nëna ishte 32 vjeç në atë kohë dhe nuk kishte mundësi, motra ime më e madhe bëri disa vite shkollë. [...]

... Uroj të mos e kisha bërë këtë ... këshilla ime për vajzat e tjera është të mos bëjnë gabimet e mia, të mos bëjnë atë që bëra unë. [...]

Do të përpiqem, i lutem Zotit [fëmijët e mi] të mos ndajnë fatin tim, Zoti është pasqyra jonë, shpresa jonë, unë nuk dua që ata të vuajnë, sepse unë kam vuajtur boll, nuk e prisja që jeta ime të ishte kështu, pa njerëz, pa të ardhme, pa shtëpi. [...]

Iu uroj atyre të qëndrojnë në shkollë për aq kohë sa shkolla të ofrojë mundësi që ato të ecin përpara, jo si unë, ato duhet të martohen në një moshë të përshtatshme, kështu që, kur gjërat e mira dhe të këqija të ndodhin, ato të dinë si t’i përballojnë, në atë moshë mua më ndodhi fatkeqësia më e madhe dhe nuk dija çfarë të bëja.

[II - Vajzë e re rome e martuar para moshës 18 vjeç]

Martesa e fëmijëve si praktikë sociale në Shqipëri

Siç u diskutua më lart, në Seksionin 3 për ‘Shtrirjen dhe objektivat e studimit’, Bicchieri dhe të tjerët sugjerojnë një varg kategorish të praktikës sociale në të cilën mund të bëjnë pjesë arsyet e grupit të popullsisë për mbështetjen e martesës së fëmijëve. Këto janë përmbledhur në Tabelën 1 në faqen 19, ‘Martesa e fëmijëve si praktikë kolektive’.

Për të vlerësuar se në cilën kategori të praktikës sociale bën pjesë martesa e fëmijëve në Shqipëri, le të shqyrtojmë se si pjesëmarrësit në hulumtim shprehën parapëlqimet e tyre në favor të martesës së fëmijëve. Kategorizimi i martesës së fëmijëve për grupet e ndryshme të popullsisë është përmbledhur më pas në Tabelën 3, në fund të këtij seksioni.

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Parapëlqimet e kushtëzuara pro martesës së fëmijëve

Në lidhje me qëndrimet ose parapëlqimet që kanë të bëjnë me martesën e fëmijëve, pjesëmarrësit nëpër të katër grupet e popullsisë diskutuan një sërë pritshmëri sociale normative dhe empirike që formësojnë parapëlqimet e kushtëzuara pro martesës së fëmijëve.

Kishte mbivendosje të konsiderueshme, nëpër të katër grupet e popullsisë dhe midis grave dhe burrave nga të gjitha grupmoshat, në lidhje me rolin e rëndësishëm që thashethemet, frika nga thashethemet dhe frika nga sanksionet sociale luajnë në formësimin e preferencave pro martesës së fëmijëve. Pati gjithashtu një diskutim të konsiderueshëm të dënimit nga opinioni të marrëdhënies të adoleshentëve. Për ta thënë thjesht, sipas pjesëmarrësve në këtë studim, martesat e fëmijëve në komunitetet e tyre ndodhin për të siguruar që thashethemet të mos përhapen për një vajzë që është në një marrëdhënie jashtë martese, gjë që do të dëmtonte 'nderin' e saj.

Përsa iu përket dallimeve, pjesëtarët romë nga komunitetet e veçuara dhe jo të veçuara folën për prindërit që përjetojnë presion nga fqinjët dhe të afërmit për t'i martuar vajzat e reja dhe lavdërimi që marrin kur veprojnë kështu. Pjesëmarrësit jo-romë nuk folën se ndiheshin kaq nën presion social.

Nga kjo është e mundur të konkludojmë se pritshmëritë sociale normative (bindjet në lidhje me atë që mendonin të tjerët se duhet bërë) formësonin parapëlqimet e kushtëzuara pro martesës së fëmijëve për të gjitha grupet pjesëmarrëse. Kjo do të thotë se **martesa e fëmijëve mund të kategorizohet si një normë shoqërore**, sipas kornizës së Bicchierit dhe të tjerëve, **për të katër grupet e popullsisë**. Pjesëmarrësit romë (qoftë nëse jetojnë në komunitete të veçuara ose jo të veçuara) identifikuan parapëlqime të kushtëzuara më të forta pro martesës së fëmijëve brenda komuniteteve të tyre, për shkak të shkallës më të madhe të presionit shoqëror që përjetonin. Pjesëmarrësit romë iu referuan gjithashtu pritshmërive sociale empirike, d.m.th. që 'të gjithë të tjerët i martojnë vajzat (ose i lejojnë vajzat të martohen) para se të mbushin 18 vjeç, prandaj kështu pritet që të bëj edhe unë'. Kjo do të thotë se **për romët, martesa e fëmijëve mund të përshkruhet si një normë përshkruese**, sipas kornizës së Bicchierit dhe të tjerëve.

Parapëlqimet e pakushtëzuara pro martesës së fëmijëve

Analiza e të dhënave të grupit të fokusit tregon disa dallime në lidhje me parapëlqimet e pakushtëzuara pro martesës së fëmijëve nëpër të gjitha grupet e ndryshme të popullsisë, por edhe një mbivendosje të rëndësishme, përkatësisht me rolin e varfërisë në formësimin e parapëlqimeve të pakushtëzuara pro martesës së fëmijëve.

Sa iu përket bindjeve morale vetjake, (dmth, bindjeve jo-sociale normative), bashkë me bindjen se martesa e fëmijëve ishte 'traditë' ose 'zakon' ishte shumë e fortë midis pjesëmarrësve romë, pavarësisht nëse ishin nga komunitetet e veçuara apo të integruara. Po ashtu, pjesëmarrësit romë edhe nga komunitetet e veçuara, edhe të integruara shprehën besimin se vajzat duhet të ruajnë 'nderin' e tyre, d.m.th. virgjërinë e tyre, para martesës dhe se kjo ishte pothuajse më e rëndësishme se çdo gjë tjetër. Ndërsa 'nderi' u përmend në diskutimet në grupet e fokusit me pjesëmarrës jo-romë, kjo kishte të bënte më pak me atë çka pjesëmarrësit besonin vetë dhe më shumë me frikën nga thashethemet dhe sanksionet sociale.

Nga kjo mund të konkludohet se pjesëmarrësit romë nga komunitetet e veçuara dhe të integruara identifikuan parapëlqime të pakushtëzuara pro martesës së fëmijëve brenda komuniteteve të tyre bazuar në bindjet për atë që është moralisht e drejtë, pra, bindje jo-sociale normative. Si i tillë, **për pjesëmarrësit romë në këtë studim, martesa e fëmijëve mund të kategorizohet si një rregull moral**, sipas kornizës së Bicchierit dhe të tjerëve, dhe **mund të kategorizohet gjithashtu si zakon**.

Sa iu përket bindjeve të bazuara në 'realitete faktike' (bindje jo-sociale faktike), kishte mbivendosje shumë më të madhe nëpër të katër grupet e popullsisë. Varfëria u identifikua në secilin grup të fokusit si një 'realitet faktik' që formësonte parapëlqimet e pakushtëzuara pro martesës së fëmijëve. Pjesëmarrësit folën për familje që nuk ishin në gjendje të përballonin shkollimin e vajzave ose që donin 'një gojë më pak për të ushqyer' në shtëpi. Ata folën gjithashtu për mungesën e mundësive të punësimit që i leadoleshentët - dhe prindërit e tyre - me pak ose pa mundësi të tjera zgjedhjeje, përveç martesës, por folën edhe për dëshirën e prindërve - dhe të vetë adoleshentëve - për të siguruar një të ardhme më të mirë për vajzat e tyre. Lidhur me varfërinë dhe mungesën e mundësive për punësim, pjesëmarrësit jo-romë nga zonat rurale dhe urbane gjithashtu folën për emigrimin si një faktor që formëson preferencën pro martesës së fëmijëve.

Nga kjo mund të konkludohet se pjesëmarrësit nga të katër grupet e popullsisë identifikuan parapëlqime të pa kushtëzuara të forta pro martesës së fëmijëve brenda komuniteteve të tyre, bazuar në bindjet jo sociale faktike, përkatësisht 'realitetit faktik' të varfërisë. Brenda kuadrit të Bicchierit dhe të tjerëve, kjo do të thotë që ne **mund ta kategorizojmë martesën e fëmijëve si një përgjigje racionale, për të katër grupet e popullsisë.**

Në cilën kategori të praktikës sociale futet martesa e fëmijëve?

Siç tregoi analiza më sipër, arsyet pas preferencave pro (dhe kundër) martesës së fëmijëve të artikuluar nga pjesëmarrësit në këtë studim nga të katër popullatat ishin komplekse dhe ndryshonin nga njëra-tjetra. Kjo e bën të vështirë të përcaktosh se cila kategori shoqërore zbatohet për martesën e fëmijëve për secilin grup të popullsisë, aq më tepër për shoqërinë në tërësi në Shqipëri. Në vend të kësaj, tabela më poshtë përpiqet të tregojë se cilat kategori sociale mund të jenë domethënëse në lidhje me martesën e fëmijëve midis katër grupeve të popullsisë të përfshira në këtë studim.

Tabela 3: Martesa e fëmijëve si praktikë sociale për grupe të ndryshme të popullsisë në Shqipëri

	Romë që jetojnë në komunitete të veçuara	Romë që jetojnë në komunitete të integruara	Jo-romë që jetojnë në zona rurale	Jo-romë që jetojnë në zona urbane
Përgjigje racionale	✓	✓	✓	✓
Zakon	✓	✓		
Rregull moral	✓	✓		
Normë përshkruese	✓	✓		
Normë sociale	✓	✓	✓	✓

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Ajo që del nga kjo analizë është se, ndërsa në të gjitha grupet e popullsisë, martesa e fëmijëve mund të kategorizohet si normë shoqërore (d.m.th. një përgjigje ndaj pritshmërive empirike dhe normative sociale) dhe si përgjigje racionale (ndaj varfërisë), për Romët që jetojnë në të dyja komunitetet, të veçuara dhe të integruara, kjo është një praktikë që është shumë më komplekse dhe që nuk mund të kategorizohet në mënyrë efikase brenda kësaj skeme. Çdo politikë dhe përgjigje programatike ndaj martesës së fëmijëve duhet të marrë në konsideratë kompleksitetin e këtij realiteti. Ndërhyrjet që kanë për qëllim nxitjen e ndryshimeve në qëndrimet dhe sjelljet lidhur me martesën e fëmijëve ka të ngjarë të kenë pak efekt, nëse nuk adresohet edhe varfëria e përjetuar në komunitetet ku praktikohet martesa e fëmijëve. Ndërhyrjet gjithashtu duhet të marrin parasysh dhe të jenë të ndjeshme për faktin se parapëlqimet pro martesës së fëmijëve në komunitetet rome formësohen gjithashtu nga bindjet e rrënjësura personale që lidhen me rëndësinë e 'nderit' dhe të zakonit e traditës. Ndërhyrjet që nuk e marrin parasysh këtë, ka gjasa të kenë ndikim të pakët.

7. Perceptimet e mundësive të zgjedhjes që lidhen me martesën e fëmijëve

Ky seksion analizon pikëpamjet e pjesëmarrësve për mundësitë 'reale të jetës' në dispozicion për adoleshentët dhe të rinjtë në lidhje me kohën e martesës, por gjithashtu edhe bindjet që ata shprehin se sa të pranueshme janë këto mundësi zgjedhjeje. Analiza zbulon se mundësitë e zgjedhjes në dispozicion të të rinjve në raport me martesën, veçanërisht mundësitë e vajzave dhe grave të reja, janë tejet të kufizuara. Këto kufizime janë rezultat i mungesës së alternativave të përshtatshme përkundër martesës (p.sh. pak mundësi punësimi), por edhe rezultat i besimit mbizotërues se martesa është e vetmja mundësi e pranueshme për gratë, në disa raste duke përfshirë të gjitha aktivitetet e tjera, përfshirë përfundimin e shkollimit. Përveç kësaj, dënimi shoqëror i marrëdhënieve në forma të tjera, përveç martesës (heteroseksuale), si për shembull, lidhja apo bashkëjetesa me një të dashur femër ose mashkull, do të thotë se martesa bëhet e vetmja mënyrë e pranueshme që dy njerëz të jenë së bashku.

Thënë kjo, për pjesëmarrësit e këtij studimi, kishte ndryshime të rëndësishme midis grupeve të ndryshme të popullsisë në lidhje me atë se në ç'pikë martesa bëhet 'e vetmja mundësi' për një vajzë apo një grua. Për pjesëmarrësit romë, veçanërisht ata që jetojnë në komunitete të veçuara, varfëria, mungesa e mundësive për arsim dhe punësim të ndërthurura me pritshmëri sociale normative dhe bindje jo-sociale shumë të forta rreth 'nderit' dhe virgjërisë, do të thoshte se martesa bëhet mundësia më e mirë ose 'mundësia e vetme' për vajzat nga mesi i adoleshencës. Në të kundërt, disa pjesëmarrës jo-romë nga komunitetet urbane folën për universitetin dhe karrierën si mundësi të pranueshme për vajzat dhe gratë e reja, por ende me pritshmërinë se pas tyre do vinte martesa. Pjesëmarrësit jo-romë nga komunitetet urbane dhe rurale ishin gjithashtu të kufizuar nga të njëjtat pritshmëri sociale normative rreth lidhjes dashurore dhe bashkëjetesës dhe gjithashtu reflektuan se për vajzat e reja që nuk shkonin në universitet (veçanërisht, nëse kjo ndodhte, pasi familjet e tyre nuk mund ta përballonin atë) martesa pak pas përfundimit të shkollës së mesme mbetej mundësia më e mirë ose 'mundësia e vetme'.

Mundësitë e zgjedhjes në raport me martesën janë më pak të kufizuara për djemtë dhe burrat nga katër grupet e popullsisë. Megjithatë, ata ende përballen me presionin për t'u martuar dhe martesa (heteroseksuale) edhe për ta bëhet 'mundësia e vetme' në një moment, (zakonisht) pasi arrijnë moshën e pjekurisë, siç tregon kjo pjesë nga një prej grupeve të fokusit.

“Presioni nga të afërmit është shumë i madh, për shembull: vëllai im i vogël ishte i pamartuar në moshën 22 vjeçare, gjë që është rast i rrallë në komunitetin rom dhe të afërmit tanë po thoshin pse nuk është martuar ai. Kështu që, një ditë të bukur, pa pëlqimin e tij, nëna jonë i gjeti atij një vajzë dhe e martoi, edhe pse ai mund të kishte qenë në një marrëdhënie me dikë tjetër.”

[DGF – nëna/kujdestare rome që jetojnë në komunitete të integruara]

Djemtë dhe burrat përballen me të njëjtat kufizime rreth lidhjeve dashurore dhe bashkëjetesës (por jo me të njëjtin presion social në lidhje me 'nderin' dhe virgjërinë). Nga ana tjetër, kanë një gamë shumë më të gjerë mundësish për sa i përket aktiviteteve të pranueshme që mund të zgjedhin, përveç martesës. Këto përfshijnë përfundimin e shkollës së mesme, universitetit, punën dhe emigrimin. Megjithatë, për djemtë dhe burrat romë, këto mundësi mund të jenë prapëseprapë shumë të kufizuara, për shkak të varfërisë dhe/ose mungesës së mundësive për arsimim dhe punësim.

Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se në të gjitha grupet e fokusit, pjesëmarrësit reflektuan se besonin se mundësitë e e zgjedhjeve për të rinjtë në raport me martesën po ndryshonin. Për shembull, nëpër të gjitha grupet e popullsisë, pjesëmarrësit folën se si në të kaluarën, prindërit i rregullonin vetë martesat për fëmijët e tyre dhe e zgjidhnin partnerin e fëmijëve të tyre pa u këshilluar me ta, ndërsa tani, kjo ishte shumë e pazakontë. Nëse një martesë rregullohej nga familjet, prindërit tani këshilloheshin me vajzën ose djalin e tyre. Megjithatë, gjithnjë e më shumë, të rinjtë po e zgjedhin vetë partnerin/en ose bashkëshortin/en e tyre.

“Zakoni është që vendimi për t'u martuar të merret nga prindërit, por kohët kanë ndryshuar dhe tani, gjithnjë e më shpesh, janë të rinjtë që marrin vendimin se kur dhe me kë të martohen.”

[DGF – nëna/kujdestare jo-rome që jetojnë në komunitete urbane]

Përveç kësaj, nga disa prej komenteve u bë e qartë se mundësia e shtyrjes së martesës në favor të arsimit dhe/ose punës po bëhej tanimë më e pranueshme dhe më realiste, përfshirë edhe mes disa komuniteteve rome.

“Koncepti i martesës ka ndryshuar gjatë viteve, ku martesat me mblesëri pothuajse nuk po praktikohen më dhe po shkohet drejt martesës me dashuri. Njerëzit prirën të përqendrohen në arsimim, karrierë dhe pastaj të mendojnë për martesën. Kjo ka bërë që moshë e martesës të rritet.”

[DGF – nëna/kujdestare rome që jetojnë në komunitete të integruara]

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se, pavarësisht nga bindjet që njerëzit mund të kenë në lidhje me mundësitë e përshtatshme për vajzat dhe djemtë e rinj, praktikisht, të rinjtë shpesh përballen me mundësi shumë të kufizuara, siç vërejt kjo informatore kyç.

“Arsimi mund të jetë një mundësi e mirë për të rritur të ardhurat në familje, por kjo nuk rezulton gjithnjë efektive. Edhe punësimi është një mundësi e mirë, por në praktikë nuk po funksionon siç duhet, sepse shumë të rinj janë të papunë.”

[IIK – infermiere]

Gjetjet mbi mundësitë e zgjedhjes - dhe bindjet rreth këtyre mundësive –që përballin adoleshentët dhe gratë e reja (dhe prindërit të tyre) në katër grupet e popullsisë të përfshira në këtë studim janë përmbledhur në tabelat 4, 5 dhe 6 më poshtë. Pjesa tjetër e këtij seksioni analizon më me hollësi gjetjet për secilin grup të popullsisë.

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Tabela 4: Mundësitë që kanë në dispozicion vajzat dhe gratë e reja: arsimi

	Cfarë mundësisë arsimimi kanë vajzat dhe gratë e reja në dispozicion?	Konsiderohet shkolla/universiteti një mundësi e pranueshme për adoleshentet dhe gratë e reja?	Cilat janë mundësitë që ka në dispozicion një vajzë që nuk është në shkollë/universitet?
Romë që jetojnë në komunitete të veçuara	Shkolla – nëse familja mund ta përballojë <i>Arsimi do të ishte gjë e mirë për të rinjtë, por situata aktuale nuk ofron mundësi të mira.</i> [DGF– djem të rinj romë që jetojnë në komunitete të veçuara]	Po – me disa përjashtime	Martesa <i>Kur nuk e përballon ta dërgosh vajzën në shkollë, e marton me dikë që mos ta mbash në shtëpi, pasi kjo turpëron familjen.</i> [DGF– nëna/kujdestare rome që jetojnë në komunitete të veçuara]
Romë që jetojnë në komunitete të integruara	Shkolla; universiteti – nëse familja mund ta përballojë	Po – me disa përjashtime <i>Përsa iu përket djemve, zakonisht, i dërgojnë në shkollë, madje edhe në universitet. Kurse vajzat jo, se mendojnë se do marrë rrugë të gabuar.</i> [DGF– djem të rinj romë që jetojnë në komunitete të integruara]	Martesa <i>Familjet që i martojnë vajzat në moshë të re për arsye ekonomike, nuk kanë qenë në gjendje t'i arsimonin ato dhe mundësia më e mirë mbetet martesa.</i> [DGF – nëna/kujdestare rome që jetojnë në komunitete të integruara]
Jo romë që jetojnë në komunitete rurale	Shkolla; universiteti – nëse familja mund ta përballojë <i>Arsyet ekonomike janë po ashtu një faktor, nuk e përballojnë t'i dërgojnë fëmijët në universitet, prandaj i martojnë sapo mbarojnë shkollën e mesme.</i> [DGF – baballarë/kujdestarë jo-romë që jetojnë në komunitete rurale]	Po	Martesa <i>Kur vajzat nuk vazhdojnë arsimin, zgjidhja më e mirë për to është martesa, sepse nuk kanë [askund] ku të punojnë. Kur vazhdojnë arsimin, bëjnë zgjedhjen e tyre.</i> [DGF– baballarë/kujdestarë jo-romë që jetojnë në komunitete rurale]
Jo romë që jetojnë në komunitete urbane	Shkolla; universiteti – nëse familja mund ta përballojë	Po <i>Kjo ndodh sepse, kur mbarojnë shkollën e mesme, vajzat zakonisht nuk duan të shkojnë në universitet dhe nuk kanë çfarë të bëjnë tjetër, veç të ulen e të rrinë në shtëpi, prandaj vendimi më i mirë për to është që të martohen</i> [DGF – djem të rinj jo-Romë që jetojnë në zona urbane]	Martesa ose puna

Tabela 5: Mundësitë që kanë në dispozicion vajzat dhe gratë e reja: puna

	A ka mundësi punësimi për vajzat dhe gratë e reja?	A konsiderohet puna një mundësi e pranueshme për vajzat dhe gratë e reja?	Cilat janë mundësitë në dispozicion për një vajzë që nuk punon?
Romë që jetojnë në komunitete të veçuara	Jo - mundësi shumë të kufizuara punësimi për këdo	Jo <i>Është më mirë që ajo të martohet se sa të shkojë në punë dhe të turpërojë familjen.</i> [DGF – nëna/kujdestare rome që jetojnë në komunitete të veçuara]	Martesa
Romë që jetojnë në komunitete të integruara	Jo - mundësi shumë të kufizuara punësimi për këdo <i>Është e pamundur për njerëzit që të gjejnë punë, kështu që çfarë të them për të rinjtë? Çfarë do të bëjnë? Të mbledhin kanaçe, shesin diçka? Nuk ka punë. Kështu që i martojnë.</i> [DGF– baballarë/kujdestarë romë që jetojnë në komunitete të integruara]	Jo <i>Ndonjëherë [prindërit] duan t'i dërgojnë ato për të punuar, por kanë frikë se mund të bëjnë gabime, kështu që, në vend të kësaj, i martojnë.</i> [DGF – vajza të reja rome që jetojnë në komunitete të integruara]	Martesa ose shkolla (nëse familja mund ta përballojë këtë)
Jo Romë që jetojnë në komunitete rurale	Jo - mundësi shumë të kufizuara punësimi për këdo <i>Jeta këtu në fshat nuk ofron ndonjë mundësi tjetër. Nuk ka punë, kështu që martesa është zgjidhja e vetme.</i> [DGF – baballarë/kujdestarë jo-romë që jetojnë në komunitete rurale]	Po	Martesa ose shkolla (nëse familja mund ta përballojë këtë) <i>Kushtet këtu nuk ofrojnë [shumë] mundësi dhe dihet që një vajzë, pas shkollës së mesme, duhet ose të fejohej ose të shkojë në universitet, sepse këtu nuk ka mundësi të tjera, nuk ka punë.</i> [DGF– vajza të reja jo-rome që jetojnë në zona rurale]
Jo Romë që jetojnë në komunitete urbane	Po, por të kufizuara <i>Kohët e fundit gjërat kanë ndryshuar pak, sepse janë hapur rrobaqepësi dhe gratë kanë filluar të punojnë atje.</i> [DGF – vajza të reja jo-rome që jetojnë në zona urbane]	Varet nga familja <i>Ka familje që mendojnë se është tabu që vajzat të punojnë.</i> [DGF – vajza të reja jo-rome që jetojnë në zona urbane]	Martesa, shkolla ose universiteti (nëse familja mund ta përballojë këtë)

Tabela 6: Mundësitë që kanë në dispozicion vajzat dhe gratë e reja: lidhjet dashurore

	A është e pranueshme që të rinjtë të kenë lidhje/marrëdhënie dashurore?	A është bashkëjetesa një mundësi për një çift të ri?	Cila është mundësia më e mirë për një çift të ri që duan të jenë bashkë?
Romët që jetojnë në komunitete të veçuara	Jo <i>... kur të rinjtë nuk martohen në moshë të re, ndodh që vajzat dhe djemtë të krijojnë marrëdhënie që janë të padëshiruara dhe fjalët fillojnë të përhapen dhe gjithçka merr fund.</i> [DGF– djem të rinj romë që jetojnë në komunitete të veçuara]	Jo <i>Nëse e marr vesh që po jeton me dikë, ta fus plumbin ballit, sepse nuk ke nder...</i> [DGF – baballarë/kujdestarë romë që jetojnë në komunitete të veçuara]	Martesa
Romët që jetojnë në komunitete të integruara	Jo	Jo	Martesa <i>... nëse një vajzë bie në dashuri me një djalë, prindërit e saj i martojnë menjëherë, sepse duan të sigurohen që ajo të mbetet e pastër kur të martohet.</i> [DGF – gra të reja rome që jetojnë në komunitete të integruara]
Jo romë që jetojnë në komunitete rurale	Jo <i>Nuk është e pranueshme që ta vazhdojnë marrëdhënien, sidomos këtu në fshat.</i> [DGF – nëna/kujdestare jo rome që jetojnë në zona rurale]	Jo <i>Të jetuarit së bashku nuk ndodh në komunitetin tonë dhe konsiderohet e pamoralshme dhe shumë e keqe, kështu që ose martohem ose hiç</i> [DGF– gra të reja jo-rome që jetojnë në zona rurale]	Martesa
Jo Romë që jetojnë në komunitete urbane	Në disa rrethana <i>Ata flasin, dalin, lidhen... Këto gjëra nuk ndodhnin përpara</i> [DGF – djem të rinj jo-romë që jetojnë në komunitete urbane]	Në disa rrethana <i>Ka shumë raste kur të rinjtë fillojnë të bashkëjetojnë, pasi mbarojnë shkollën e mesme, pra rreth 18 vjeç. Ata që kanë qenë të lidhur gjatë shkollës së mesme, jetojnë së bashku kur fillojnë universitetin në Tiranë.</i> [DGF– vajza të reja jo-rome që jetojnë në komunitete urbane]	Martesa

Romët që jetojnë në komunitete të veçuara

Analiza e të dhënave nga diskutimet e grupeve të fokusit me romët që jetojnë në komunitete të veçuara tregon se, për këta pjesëmarrës, mundësitë që kanë adoleshentët në dispozicion –sidomos vajzat - janë shumë të kufizuara. Martesa shfaqet si mundësi e pranueshme, si e vetmja ose si më e mira për vajzat adoleshente. Për shembull, pjesëmarrëset më të reja në DGF reflektuan se martesa ishte e vetmja mënyrë që një vajzë adoleshente të arratisej nga një mjedis abuziv në shtëpi ose që nëna e saj ta vendoste në (atë që ajo e shihte si) siguri relative.

E martova vajzën në moshën 12 vjeç. Burri [im] ishte i droguar; nuk kisha ku ta mbaja vajzën.
[DGF – nëna/kujdestare rome që jetojnë në komunitete të veçuara]

Nënkuptimi pas këtij ekstrakti - që një prind mendon se e bija 12-vjeçare do të ishte më e sigurt në martesë se të jetonte në shtëpinë prindërore –nënvizon edhe mundësitë e kufizuara që gratë si kjo ndiejnë se kanë për të kërkuar ndihmë ose për t’u larguar nga marrëdhënia (me ç’duket e dhunshme) në të cilën jetojnë për vete, prandaj dhe lidhen pas mendimit se martesa është mundësia më e mirë për sigurimin e të ardhmes së një vajze

Arsimi

Pjesëmarrësit nga komunitetet rome të veçuara folën për mundësitë arsimore për të rinjtë si shumë të kufizuara, ku burrat më të mëdhenj në moshë përmendën se shkolla nuk ekzistonte aspak si mundësi për fëmijët dhe adoleshentët romë, për shkak të mungesës së burimeve financiare. Djemtë e rinj reflektuan mbi mungesën e mundësive për arsim:

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

“Arsimi do të ishte një gjë e mirë për të rinjtë, por situata aktuale nuk ofron mundësi të mira.”
[DGF – djem të rinj romë që jetojnë në komunitete të veçuara]

Gratë më të mëdha në moshë dhe djemtë më të rinj u shprehën se nëse një familje nuk mund ta përballojë që ta dërgojë një vajzë në shkollë, e vetmja mundësi ose ajo më e mira, është ta martojë atë. Arsyeja për martesën si zgjidhja më e mirë, për të dy grupet e pjesëmarrësve, ishte se një vajzë as në shkollë, as e martuar do të ishte një burim turpi për prindërit e saj, pasi ‘nderi’ i saj do të kompromentohej.

Është e rëndësishme të theksohet se për të paktën një pjesëmarrës, martesa nuk e eliminon plotësisht mundësinë e vazhdimet të shkollës.

“Ka disa raste që, pasi martohesh, familja e burrit mund të lejojë të vazhdosh shkollën, sikurse ka ndodhur me time bijë.”
[DGF – nëna/kujdestare romë që jetojnë në komunitete të veçuara]

Puna

Asnjë nga pjesëmarrësit në grupet e fokusit nga ky grup i popullsisë nuk i diskutoi fare mundësitë e punësimit, ndoshta duke nënkuptuar se nuk ka asnjë, ose asnjë që ia vlen të diskutohet.

Pavarësisht kësaj, për temën e punës si një mundësi për vajzat adoleshente, gratë më të mëdha në moshë shprehën fuqishëm pikëpamjen se puna nuk ishte një aktivitet i pranueshëm për vajzat.

“Është më mirë për të që të martohet se të shkojë në punë dhe të turpërojë familjen.”
[DGF – nëna/kujdestare romë që jetojnë në komunitete të veçuara]

Përsëri, kjo ishte e lidhur me besimet e thella për rëndësinë e ‘nderit’ dhe frikën e turpit që do të rezultonte nëse ‘nderi’ i vajzës vihej në pikëpyetje.

Në të kundërt, pjesëmarrësit kishin pritshmërinë se djemtë duhet të punojnë.

“... djemtë e martuar duhet të punojnë për të sjellë para në shtëpi, por shpesh ata janë të papunë dhe i kalojnë ditët duke pirë nëpër lokale.”
[DGF – vajza të reja romë që jetojnë në komunitete të veçuara]

Marrëdhëniet

Takimet dashurore apo madje edhe shoqërimi me anëtarë të seksit të kundërt nuk konsideroheshin të pranueshme për adoleshentët nga pjesëmarrësit e këtij grupi të popullsisë.

“... kur të rinjtë nuk martohen në moshë të re, ndodh që vajzat dhe djemtë krijojnë marrëdhënie, që janë të padëshiruara dhe fjalët fillojnë të përhapen dhe gjithçka merr fund.”
[DGF – djem të rinj romë që jetojnë në komunitete të veçuara]

Disa pjesëmarrës gjithashtu kishin pikëpamje shumë të forta mbi bashkëjetesën.

“Nëse e marr vesh që po jeton me dikë, të fus plumbin ballit, sepse nuk ke nder ... merre çupën në shtëpi dhe martohuni siç duhet, jo këtë gjënë e të jetuarit së bashku.”
[DGF – baballarë/kujdestarë romë që jetojnë në komunitete të veçuara]

Si rezultat, nëse një adoleshent është tashmë në një marrëdhënie, e vetmja mundësi është martesa. Gratë dhe burrat më të mëdhenj në moshë folën gjithashtu mbi mënyrën si e shihnin martesën si mundësia e vetme për të ruajtur ‘nderin’ e vajzës.

“Nuk ka asnjë mënyrë tjetër për të ruajtur virgjërinë e saj, përveç se ta martosh”
[DGF – nëna/kujdestare romë që jetojnë në komunitete të veçuara]

E rëndësishme është po ashtu kjo deklaratë e bërë nga një burrë më i madh në moshë.

“Nëse vajza arrin 20 vjeç, ajo nuk martohet më.”

[DGF – baballarë/kujdestarë romë që jetojnë në komunitete të veçuara]

Kjo nënkupton që, anasjelltas, pas moshës 20-vjeçare, martesë pushon së qeni një mundësi.

Romët që jetojnë në komunitete të integruara

Grupet e fokusit me romë që jetojnë në komunitete të integruara tregojnë se adoleshentët nga ky komunitet kanë më shumë mundësi në lidhje me arsimin, por, përsa i përket punës dhe marrëdhënieve, përballen me të njëjtat mundësi të kufizuara si vajzat rome që jetojnë në komunitete të veçuara.

Arsimi

Pjesëmarrëset më të reja në grupet e fokusit mendonin se tani, disa vajza kanë një sërë mundësish më të mëdha në lidhje me arsimin, përfshirë mundësinë për të shkuar në universitet, nëse prindërit e tyre mund t'i përballojnë shpenzimet. Megjithatë, diskutimet me këtë grup dhe me djem më të rinj treguan se shumë vajza ende nuk e kanë këtë mundësi.

Diskutimet e grupeve të fokusit me të katër grupmoshat tregojnë se, pasi mbarojnë arsimin (qoftë nëse braktis ose përfundon shkollën e mesme a universitetin), mundësia e vetme ose më e mirë është që vajza të martohet.

“Ato mbarojnë shkollën dhe s’mund të bësh gjë tjetër veç t’i martosh, sepse kur një vajzë rritet, ajo duhet të martohet, nuk do ta mbajmë në shtëpi kot, ajo duhet të shkojë tek burri.”

[DGF – baballarë/kujdestarë romë që jetojnë në komunitete të integruara]

Kjo do të thotë se, ashtu si për vajzat rome që jetojnë në komunitete të veçuara, pjesëmarrësit në këtë studim mendonin se martesë shihet si mundësia e vetme ose më e mirë për një vajzë që nuk ndjek arsimin. Gratë më të mëdha në moshë, nga ana e tyre, mendonin se arsimi nuk ishte më një mundësi pas martesës.

Kur vajzat martohen në moshën 16 vjeçe, e vazhdojnë shkollën? Në përgjithësi, çfarë ndodh?

Jo, jo, jo në shumë pak raste. Nuk funksionon kështu në komunitetin tonë.

[DGF – nëna/kujdestare rome që jetojnë në komunitete të veçuara]

Puna

Gratë dhe burrat më të mëdhenj në moshë që morën pjesë në grupet e fokusit reflektuan për mungesën e mundësive të punësimit për të rinjtë.

“Punësimi është i mirë për të rinjtë, por situata aktuale nuk ofron shembuj të tillë.”

[DGF – nëna/kujdestare rome që jetojnë në komunitete të integruara]

Për një pjesëmarrës, mungesa e mundësive të punësimit do të thoshte se martesë bëhej e vetmja mundësi për të gjithë të rinjtë, meshkuj dhe femra.

“Për këdo, është e pamundur të gjesh një punë, kështu që çfarë të themi për të rinjtë, çfarë do të bëjnë? Të mbledhin kanaçe, të shesin diçka, nuk ka punë. Kështu që, i martojnë.”

[DGF – baballarë/kujdestarë romë që jetojnë në komunitete të integruara]

Megjithatë, ashtu si me romët që jetojnë në komunitete të veçuara, shumë prindër nuk e shohin punën si një mundësi të pranueshme për vajzat që kanë braktisur ose përfunduar shkollën, sepse do t'i vinte në kontakt me meshkuj.

“Ndonjëherë [prindërit] duan t'i dërgojnë ato për të punuar, por kanë frikë se mund të bëjnë ... gabime, kështu që i martojnë.”

[DGF – vajza të reja rome që jetojnë në komunitete të integruara]

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Marrëdhëniet

Pjesëmarrësit në grupet e fokusit treguan se nuk do të ishte një mundësi e pranueshme që të rinjtë të kishin takime dashurore ose një lidhje jashtë kuadrit të martesës. Si me romët që jetojnë në komunitete të veçuara, nëse prindërit zbulojnë se një çift i ri është i lidhur, ose nëse një vajzë e re është 'rrëmbyer' dhe është larguar nga shtëpia për të qenë me të dashurin e saj, e vetmja mundësi do të ishte që prindërit t'i martonin ata.

"... nëse një vajzë bie në dashuri me një djalë, prindërit e saj i martojnë menjëherë, sepse duan të sigurohen që ajo të jetë ende e pastër kur të martohet."

[DGF – vajza të reja rome që jetojnë në komunitete të integruara]

Jo-romë që jetojnë në komunitete rurale

Gjetjet nga grupet e fokusit me këtë grup popullsie tregojnë se, ndërsa adoleshentet që jetojnë në zonat rurale duket se kanë më shumë mundësi se vajzat rome në lidhje me arsimin, përfshirë mundësinë për të shkuar në universitet, ato përballen me mundësi shumë të kufizuara punësimit dhe me të njëjtat kufizime për takimet dashurore dhe lidhjet sikurse adoleshentet që jetojnë në komunitetet rome. Përveç kësaj, ashtu si me vajzat dhe gratë e reja rome, kur mbarojnë arsimin, martesa për to bëhet mundësia më e mirë e pranueshme ose e vetmja.

Arsimi

Diskutimet e grupeve të fokusit me të katër grupmoshat tregojnë se, për këta pjesëmarrës, konsiderohet 'normale' që vajzat të kenë mundësinë e përfundimit të shkollës së mesme. Në të vërtetë, pritej që vajzat të mbaronin shkollën e mesme. Megjithatë, pjesëmarrësit ishin qartazi në dijeni të familjeve të caktuara, të cilat nuk mund ta përballonin dot që të vazhdonin t'i dërgonin vajzat e tyre në shkollë pas një niveli të caktuar; në raste të tilla, martesa përsëri shihej si mundësia e vetme ose më e mirë.

"Kur familja nuk mund ta përballojë të dërgojë vajzën në shkollë, ajo nuk ka ndonjë mundësi tjetër, përveçse t'i gjejë një burrë dhe ta martojë."

[DGF – vajza të reja jo-rome që jetojnë në zonat rurale]

Universiteti u konsiderua si një mundësi për gratë e reja, ashtu si edhe për burrat e rinj, por vetëm nëse prindërit e tyre mund ta përballonin atë. Nëse jo, sërish, martesa shihej si mundësia e vetme ose më e mirë për një vajzë, pasi të ketë përfunduar shkollën e mesme.

"Kur vajzat nuk vazhdojnë arsimin, zgjidhja më e mirë për to është martesa, sepse nuk kanë [askund] ku të punojnë. Kur vazhdojnë shkollimin, ato bëjnë zgjedhjen e tyre vetë."

[DGF – baballarë/kujdestarë jo-romë që jetojnë në komunitete rurale]

Në mënyrë domethënëse, disa pjesëmarrës nuk e shihnin martesën si diçka që e mbyllte plotësisht mundësinë e shkollimit të mëtejshëm dhe/ ose të arsimit të lartë.

"... Ka gra këtu që janë të fejuara ose të martuara dhe kanë fëmijë e shkojnë në universitet."

[DGF – nëna/kujdestare jo-rome që jetojnë në komunitete rurale]

Puna

Burrat më të mëdhenj në moshë dhe vajzat më të reja nga ky grup i popullsisë folën për mundësitë e kufizuara të punësimit në dispozicion. Nëse një vajzë ose një grua e re e kishte lënë arsimin dhe nuk punonte, atëherë mundësia e vetme ose më e mirë ishte martesa.

“Nuk ka punë [në fshat], kështu që martesa është e vetmja zgjidhje.”
[DGF – baballarë/kujdestarë jo-romë që jetojnë në komunitete rurale]

Marrëdhëniet

Ashtu si me adoleshentët romë, pjesëmarrësit në grupet e fokusit me këtë grup popullsie ishin të qartë se takimet dashurore apo lidhja me një të dashur, vajzë ose djalë nuk shihej si një mundësi e pranueshme zgjedhjeje. Kjo do të thotë që nëse një çift i ri dëshiron të jetë bashkë, e vetmja mundësi do të ishte martesa.

“Të jetuarit së bashku nuk ndodh në komunitetin tonë dhe konsiderohet e pamoralshme dhe shumë e keqe, kështu që ne ose martohemi ose hiç.”

[DGF – vajza të reja jo-rome që jetojnë në zonat rurale]

Pjesëmarrësit gjithashtu vunë në dukje se për të rinjtë që jetojnë në zonat rurale, mundësitë për të takuar njerëz janë shumë të kufizuara. Në kontekstin e martesës që konsiderohet kaq e rëndësishme (dhe, së fundi, ‘mundësia e vetme’), kjo do të thotë se kur një bashkëshort/e i/e mundshëm shfaqet, pranimi i martesës do të ishte mundësia më e mirë, pavarësisht moshës.

“Këtu është edhe çështja e mentalitetit, ato nuk kanë shumë mundësi për të takuar njerëz, janë të izoluara, sapo arrin mundësia e parë, ato e pranojnë martesën.”

[DGF – baballarë/kujdestarë jo-romë që jetojnë në komunitete rurale]

Kutia 10: Martesa është e vetmja rrugë për të qenë bashkë

‘I thashë babait të saj që ose të na lerë të takohemi, ose do të martoheshim.’

Historia ime është paksa e pazakontë, por në fund u zgjidh. Kur isha në klasën e 9-të, takova një vajzë dhe filluam të dilnim bashkë, por pas përfundimit të klasës së nëntë, babai i saj nuk e dërgoi më në shkollë, sepse ai ishte pak fanatik. Kështu që nuk mund të takoheshim më, prandaj unë desha të martohesha me të dhe i shkova në shtëpi për të kërkuar dorën e saj në martesë. I thashë babait të saj që ose të na lejonte të takoheshim, ose do të martoheshim. Në fillim ai tha se ajo ishte e re, por më pas pranoi dhe në fund u martuam.

Në fillim ndihesha pak i turpëruar, sepse asnjë nga shokët e mi nuk ishte martuar në atë moshë; të gjithë u përpoqën të më bindnin kundër martesës. Edhe ime shoqe ishte pak e turpëruar, sepse ishim të rinj dhe nuk dinim asgjë për martesën. Por, me kalimin e kohës mësuam dhe kemi qenë të martuar për 3 vjet. Nuk kemi fëmijë, por kjo pasi po e marrim me ngadalë.

Unë e mbarova shkollën e mesme, edhe gruaja shkon në shkollë të mesme me kohë të pjesshme, dhe pastaj do të shohim si do na shkojnë punët.

[II – Djalë i ri jo-rom i martuar para moshës 18 vjeç]

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

'Babai nuk më la të kthehesha në shkollë ... ai tha se mund ta bëja shkollën apo çfarë të doja, pasi të martohesha.'

Unë rashë në dashuri me një djalë që ishte 4 vjet më i madh se unë. Isha në vitin e parë të shkollës së mesme, por në fakt atij i pëlqejta që në klasë të 9-të. Kështu filluam të dilnim dhe isha 16 vjeç në atë kohë. Pastaj ai emigroi në Itali dhe u kthye pas ca kohësh. Më pas, prindërit e mi e morën vesh marrëdhënien tonë dhe babai më kërcënoi se nuk do të më linte të shkoja në shkollë, nëse vazhdoja ta takoja djalin dhe unë u pajtova me të për këtë. E dija gjithashtu se vajtja në shkollë ishte mënyra më e mirë për t'u takuar me djalin. Pra, kështu vazhduam, deri tre muaj pasi kisha filluar vitin e dytë, pastaj babai e mori vesh dhe nuk më la më të shkoja në shkollë.

Atëherë, vendosëm të fejojeshim dhe pas disa përpjekjesh, babai më në fund ra dakord. Isha 17 vjeç. Babai nuk më lejoi të kthehesha në shkollë pas fejesë dhe tha se mund ta bëja shkollën apo çfarëdo që të dëshiroja, pasi të martohesha. U martuam pas disa muajsh, kur unë isha 17 vjeç dhe ai 21 vjeç.

Pasi mbusha 18 vjeç, e bëmë zyrtare martesën në bashki dhe u ktheva në shkollë. Kemi 5 vjet të martuar dhe martesa ka qenë e mirë. Sfidë jonë më e madhe ishte kur patëm një fëmijë, për shkak të të gjitha shpenzimeve, por ne të dy punojmë dhe ia dalim.

[II - Vajzë e re jo-rome e martuar para moshës 18 vjeç]

Jo-romë që jetojnë në komunitete urbane

Sipas pjesëmarrësve në grupet e fokusit nga komunitetet urbane jo-rome, mundësia e përfundimit të shkollës së mesme dhe vazhdimi i universitetit ishte e mundur për vajzat (dhe djemtë), por vetëm nëse prindërit e tyre mund ta përballonin atë. Nëse jo, atëherë, si me grupet e tjera të popullsisë, martesë shihej si mundësia e vetme ose më e mirë për një vajzë që nuk ndiqte më arsimin. Punësimi ishte gjithashtu një mundësi për disa vajza dhe gra të reja, por sërish, për një vajzë që nuk ndiqte arsimin apo nuk ishte e punësuar, mundësia e vetme ose më e mirë mbetej martesë. Emigrimi nuk shihej si mundësi për të rejtat, ndërkohë që për të rinjtë po. Përkundrazi, martesë shihej si e vetmja mënyrë se si një vajzë ose grua të re të emigronte. Së fundmi, si me çdo grup tjetër të përfshirë në këtë studim, martesë shihej si mundësia më e mirë për një çift i ri për të qenë bashkë; megjithatë, pjesëmarrësit më të rinj dhanë edhe shembuj të çifteve të reja që bashkëjetonin (ndoshta pa dijeninë e prindërve të tyre).

Arsimi

Ndërkohë që pjesëmarrësit nga të katër grupmoshat u pajtuan se përfundimi i shkollës së mesme dhe vazhdimi i universitetit ishin një mundësi për vajzat dhe djemtë adoleshentë, ata pranuan se pamundësitë financiare e kufizonin këtë mundësi për disa familje. Ashtu si me grupet e tjera, në këtë rast, martesë shihej si mundësia e vetme ose më e mirë për vajzën.

"Ne përpiqemi shumë që ato të mbarojnë shkollën e mesme dhe, kush është me fat, ia arrin, por jo të gjitha familjet kanë mundësi ta bëjnë këtë, kështu që kjo çon te martesë e vajzës, kurse djemtë përpiqen të gjejnë punë për të mbështetur veten dhe familjen."

[DGF – nëna/kujdestare jo-rome që jetojnë në zona urbane]

Edhe djemtë më të rinj në moshë reflektuan se ishte ende e pazakontë që një vajzë e re të shkonte në universitet, ndërsa djemtë e rinj tani kanë mundësinë e emigrimit. Kjo funksionon për të vonuar më tej martesën për djemtë.

"Djemtë zakonisht emigrojnë në shtete të tjera, sepse kanë nevojë për të ardhura dhe për të siguruar jetën e tyre, prandaj martohej më vonë."

[DGF – djem të rinj jo-romë që jetojnë në zona urbane]

Puna

Gratë, si ato më të rejat, ashtu edhe ato më të mëdha në moshë reflektuan se kishte pak mundësi punësimi për këdo në lagjet ku jetonin, megjithëse gratë më të reja vunë re se po fillonin të hapeshin disa mundësi punësimi për to.

“Kohët e fundit gjërat kanë ndryshuar pak, sepse janë hapur rrobaqepësi dhe gratë kanë filluar të punojnë atje.”

[DGF – vajza të reja jo-rome që jetojnë në zona urbane]

Megjithatë, si ato më të rejat, ashtu edhe ato më të mëdha në moshë vunë në dukje se disa familje nuk e konsiderojnë punën si një mundësi të pranueshme për vajzat dhe gratë e reja.

Ka shumë pak mundësi punësimi, si: fabrika e peshkut, fabrika e këpucëve, por edhe atje pagat janë të ulëta dhe shumica e prindërve janë fanatikë dhe nuk i lejojnë vajzat e tyre të punojnë. Për ta, është më mirë që vajzat të martohen në mënyrë që ata t'i kenë nën kontroll.

[DGF – nëna/kujdestare jo-rome që jetojnë në zona urbane]

Marrëdhëniet

Përsëri, për këtë grup të popullsisë, takimet dashurore ose lidhja me një djalë ose vajzë nuk shihet si një mundësi për të rinjtë dhe, nëse një çift dëshiron të jetë bashkë, martesa shihet si mundësia e vetme ose më e mirë.

Ka raste kur ata bien në dashuri dhe fillojnë të takohen kur janë të rinj, kështu që familjet ndihen nën trysni për t'i martuar.

[DGF – nëna/kujdestare jo-rome që jetojnë në zona urbane]

Megjithatë, më të rinjtë kishin pikëpamje të ndryshme për këtë, duke treguar se, në zonat urbane, mundësitë tani janë ndoshta pak më elastike.

Ata që ishin të lidhur gjatë shkollës së mesme, jetojnë bashkë kur fillojnë universitetin në Tiranë. Në këtë mënyrë, shpenzojnë më pak për qiranë, dhe arrijnë të kursejnë para.

[DGF – vajza të reja jo-rome që jetojnë në komunitete urbane]

Kutia 11: Kur martesa është mundësia e vetme

‘As unë nuk do të isha martuar aq e re, por mbeta shtatzënë.’

E nisa me një përvojë të keqe. Isha adoleshente dhe fillova të takohesha me këtë djalë kur isha në klasën e 9-të pra isha diku 15 vjeç. Ai ishte në vitin e fundit të shkollës së mesme. Në fillim ishim shumë të fshehtë dhe po përpiqesha t’ua mbaja të fshehtë prindërve. Isha nxënëse e mirë dhe vazhdova shkollën e mesme. Isha 16 vjeç në atë kohë dhe kur filluam të bëheshim seksualisht aktivë, nuk u treguam të kujdesshëm dhe unë mbeta shtatzënë.

I kisha thënë mamit më parë se kisha takuar dikë, por jo më shumë se kaq. Pastaj fillova të dukesh (shtatzënë), kështu që i thashë atij të vinte të më kërkonte dorën në shtëpi. Ishte shumë problematike, por me ndihmën e Zotit, gjithçka doli mirë. Ai erdhi në shtëpinë time dhe në fillim babai nuk pranoi, sepse isha mirë në shkollë dhe ai ishte i papunë, e kështu me radhë. Por i thashë babit se ai ishte njeriu me të cilin doja të martohesha. Pastaj i thashë se, nëse nuk më linte, do të ikja nga shtëpia. I thashë edhe se isha shtatzënë dhe ata nuk kishin asnjë mundësi tjetër, veçse të binin dakord.

Dasmën e bëmë kur isha 17 vjeç dhe pas 6 muajsh martese linda, d.m.th. 4 muaj para se të mbushja 18 vjeç. Në fillim ishte shumë e vështirë, sepse nuk e kisha idenë si të kujdesesha për një foshnje, por vjehrra më ndihmoi dhe më në fund ia mora dorën. Kur u martuam, shumë njerëz flisnin për ne dhe gjërat dukeshin vërtet keq. Por pastaj gjërat filluan të ndryshonin për mirë. Tani vazhdoj shkollën e mesme dhe mund të shkoj edhe në universitet.

Unë as nuk e mendoj këtë mundësi [për vajzën time] që ta ketë kaq të vështirë sa unë. As unë nuk do të martohesha atëherë, por mbeta shtatzënë. Nuk mendoj ta martoj vajzën para se ajo të jetë 23 vjeçe dhe para se të ketë përfunduar universitetin. Kjo vlen edhe për djalin tim. Unë u martova me dashuri dhe gjithçka përfundoi mirë, por nuk do të doja që fëmijët e mi ta kalonin këtë përvojë.

[II - Vajzë e re jo-rome e martuar para moshës 18 vjeç]

8: Përfundime dhe rekomandime

Përfundime

Ndërsa nuk është projektuar si përfaqësues, ky studim ka ofruar informacione të rëndësishme për njohuritë, qëndrimet dhe perceptimet që kanë të bëjnë me martesën e fëmijëve në Shqipëri. Gjetjet tregojnë se ndërkohë që nivelet e njohjes së legjisllacionit lidhur me martesën e fëmijëve dhe të ndikimeve negative të praktikës janë të larta, martesat e fëmijëve ende ndodhin në të katër grupet e popullsisë të përfshira në studim. Brenda komuniteteve të veçanti, shumë njerëz vazhdojnë ta mbështetin këtë praktikë, për shkak të një ndërthurjeje komplekse pritshmërisht të forta shoqërore, besimit në rëndësinë e martesës së fëmijëve si zakon apo traditë dhe për ruajtjen e 'nderit', kombinuar me realitetet e jetesës në varfëri dhe në kushte të mbipopullimit. Kjo u konfirmua nga pjesëmarrësit gra dhe burra, si për më të mëdhenjtë dhe më të rinjtë në moshë. Çdo ndërhyrje e politikave dhe programeve me këto komunitete duhet të jetë po aq komplekse dhe gjithëpërfshirëse.

Analiza e mundësive në dispozicion të vajzave dhe grave të reja në lidhje me arsimin, punën dhe marrëdhëniet jashtë kuadrit të martesës po ashtu zbuloi se, për të katër grupet e popullsisë, martesa mbetet mundësia më e mirë ose 'e vetmja' për të qenë në një marrëdhënie, dhe zakonisht shihet si ekskluzive, pra jo një rrjedhë jete që mund të kombinohet me arsimin dhe/ose punësimin. Kjo po fillon qartazi të ndryshojë për vajzat dhe gratë e reja që jetojnë në zonat urbane, ku vajzat dhe gratë e reja tani duket se kanë mundësi të shtyjnë martesën, derisa të mbarojnë arsimin e lartë dhe të kenë gjetur punë, dhe gjithashtu ku marrëdhëniet para-martesore tani po bëhen më të pranueshme në aspektin shoqëror. Megjithatë, për vajzat që jetojnë në zonat rurale dhe vajzat nga komunitetet rome, do të duhet të bëhen ndryshime të rëndësishme për të hapur mundësi të tjera zgjedhjeje për vajzat dhe gratë e reja përtej martesës. Këto ndryshime do të duhet të ndodhin në sferën e normave shoqërore që lidhen me përkatësinë gjinore dhe atyre që konsiderohen si kurse të pranueshme të jetës për gratë. Po ashtu, ndryshime duhet të ndodhin në drejtim të përmirësimit të qasjes në arsim në nivelin e mesëm dhe më tej, si dhe në përmirësimin e kushteve ekonomike dhe mundësive të punësimit. Vetëm në këtë mënyrë, vajzat dhe gratë e reja do të fillojnë të kenë mundësi 'reale' zgjedhjeje për jetën e tyre, përveç martesës.

Rekomandime

Pas përfundimit të analizës së të dhënave dhe draftit të këtij raporti, gjetjet u ndanë në tryeza të rrumbullakëta të mbajtura me palët e interesuara në Korçë, Durrës, Lezhë dhe Tiranë. Pjesëmarrësit, të cilët ishin nga radhët e pushtetit vendor dhe institucioneve të tjera në nivel vendor, drejtorive të policisë, drejtorive rajonale arsimore, departamenteve të shërbimeve sociale, institucioneve shëndetësore, gjykatave vendore dhe OJQ-ve, u përfshinë në diskutime rreth gjetjeve të studimit dhe identifikimin e ndërhyrjeve të mundshme në të ardhmen për të adresuar këtë dukuri.

Rekomandimet e mëposhtme bazohen në gjetjet dhe analizën e studimit, si dhe në rekomandimet e bëra nga pjesëmarrësit e këtyre tryezave të rrumbullakëta.

Rekomandimi i përgjithshëm që rrjedh nga ky studim është se qeveria duhet të adresojë martesën e fëmijëve nëpërmjet masave politike në nivel qendror dhe lokal, duke përcaktuar ndërhyrjet, buxhetet e lidhura me to, si dhe rolet dhe përgjegjësitë e organeve të ndryshme publike. Duke patur parasysh sfidat komplekse të kësaj dukurie, veprimet në lidhje me martesën e fëmijëve duhet të integrohen në dokumentet përkatëse politike dhe të adresojnë ndër-sektorialitetin e reagimit publik ndaj saj. Politikat dhe planet e veprimit, që mund të luajnë rolin më të rëndësishëm në luftën kundër martesës së fëmijëve, janë ato në fushën e barazisë gjinore; regjistrimit të lindjeve; arsimit dhe aftësimin profesional; shëndetit seksual dhe riprodhues; fuqizimit ekonomik të grave dhe vajzave; përfshirjes sociale, veçanërisht të romëve; zhvillimit rural; rinisë; drejtësisë, etj. Këto masa politike duhet t'i qasen problemit nga këto drejtime:

1. Sensibilizim dhe edukim;
2. Krijimi i alternativave për fëmijët, të ndryshme nga martesat;
3. Parandalim dhe mbështetje për fëmijët e prekur nga martesat e fëmijëve.

Më poshtë jepen hollësi të mëtejshme të qasjeve të rekomanduara:

Sensibilizim dhe edukim

- Të punohet në mënyrë të qëndrueshme dhe afatgjatë me romët dhe komunitetet e thella rurale, për të nxitur ndryshime në qëndrimet dhe, në fund të fundit, në sjelljet rreth martesës së fëmijëve dhe normave të tjera që prekin atë. Ndërhyrjet duhet të synojnë individin, familjen, si dhe komunitetin.
- Të angazhohen aktorë që janë pranë këtyre komuniteteve dhe gëzojnë besimin e tyre për ta kryer këtë punë. Ofruesit e shërbimeve, si: mësuesit, punonjësit e shëndetësisë, ata të mirëqenies sociale, si dhe personat me ndikim në komunitet, të tillë si: drejtuesit e komuniteteve, aktivistët e rinj, aktorët e shoqërisë civile, bashkëmoshatarët, etj., janë më të përshtatshmit për ta kryer këtë rol. Për këtë qëllim, këta aktorë duhet të bëhen përfitues të investimeve për vetëdijësim, sensibilizim dhe zhvillim kapacitetesh, me synimin për t'iu qasur komunitetit me mesazhet e duhura, përmes metodave dhe kanaleve efektive të komunikimit.
- Mesazhet që dekurajojnë martesën e fëmijëve - ndërsa ankorohen brenda debatit për promovimin e shëndetit publik, për luftën kundër dhunës ndaj fëmijëve dhe asaj me bazë gjinore, - duhet të ndërthuren dhe të ofrohen në kuadrin e përgjithshëm të barazisë gjinore, fuqizimit të vajzës, vlerës së fëmijës, përfitimeve nga arsimit, të drejtave të viktimave, si dhe të sfidojnë mitet dhe besimet që lidhen me martesën e hershme e të detyruar dhe që kanë të bëjnë me 'nderin' dhe virgjërinë.
- Të angazhohen djemtë dhe burrat aktivisht përmes hartëzimit të komunitetit dhe programeve që i nxitin ata që jo të 'bëjnë sehir' kur një fëmijë martohet, por të ndërhyjnë e të flasin kundër martesës së fëmijëve.
- Të promovohen raste pozitive të vajzave, veçanërisht nga komunitetet rome, të cilat kanë vazhduar arsimin dhe kanë qenë në gjendje të sigurojnë një jetë më të mirë për veten e tyre.
- Të punohet me vajzat në rrezik martesë në moshë të vogël për t'i fuqizuar ato dhe për t'i inkurajuar që të sfidojnë pabarazinë gjinore dhe të përqafojnë drejtime jete të ndryshme nga martesat. Aktivitetet mund të përfshijnë klubet e vajzave dhe hapësirat e sigurta për to, mentorimin, promovimin e grave dhe vajzave që mund të bëhen shembull për të tjerat dhe trajnimin për aftësi jetësore.
- Të ndërmerren masa për parandalim të shtatzënisë së adoleshenteve përmes ndërhyrjeve si: ofrim informacioni, edukim seksual dhe shëndetësor, ndërtim të aftësive jetësore, këshillim për kontraceptivët dhe ofrim shërbimesh, si dhe krijim të mjediseve mbështetëse. Të ofrohen ndërhyrje që ndërthurin edukimin seksual të bazuar në kurrikulë me promovimin e kontraceptivëve tek adoleshentët, në mënyrë që të ulen normat e shtatzënisë tek adoleshentët.
- Të inkurajohen shkollat dhe qendrat komunitare për të luajtur një rol më aktiv në rritjen e ndërgjegjësimit për këto lloj çështjesh sociale, jo vetëm tek fëmijët dhe adoleshentët, por edhe tek prindërit dhe familjet.
- Mediat të përdoren në mënyrë strategjike, si mjet i edukimit publik, për të tërhequr vëmendjen tek rastet dhe pasojat negative të martesës së fëmijëve.

Krijimi i alternativave për fëmijët, të ndryshme nga martesa

- Në përgjithësi, është e nevojshme që të ketë alternativa tërheqëse për fëmijët, përveç martesës si nga pikëpamja e familjes/prindërve, ashtu edhe për vetë të rinjtë. Për këtë qëllim, duhet të krijohen dhe të zbatohen politika dhe programe për të zvogëluar barrën ekonomike të adoleshentëve në familje dhe për t'u mundësuar të rinjve të krijojnë një jetë të pavarur, siç janë: arsimit i përbalueshëm ekonomikisht, qasja në strehim, qasja në punësim, qasja në shërbimet shëndetësore dhe shërbime të tjera sociale.
- Të zbatohen programe dhe strategji që rritin qasjen e fëmijëve dhe veçanërisht të vajzave në arsim dhe mundësi financiare, pasi ato mund të vonojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë martesën. Këto strategji mund të përfshijnë:
 - Përsheptimin e nismave në sektorin arsimor për të rritur integrimin e fëmijëve romë në shkollë që nga mosha e hershme, për të ndërtuar dhe inkurajuar aspiratën e tyre për përparim.
 - Ofrimin e mbështetjes për fëmijët e familjeve të varfëra që të vazhdojnë shkollimin. Librat dhe transporti falas duhet t'u ofrohen fëmijëve të familjeve të varfra, jo vetëm për arsimin e detyrueshëm, por edhe për shkollën e mesme.
 - Zhvillimin e skemave financiare për të mbështetur vajzat që vijnë nga familje me gjendje të vështirë ekonomike, sidomos për vajzat romë, të cilat dëshirojnë të ndjekin arsimin profesional ose të ndjekin kurse profesionale, në vend të arsimit të përgjithshëm.

Parandalim dhe mbështetje për fëmijët e prekur nga martesa e fëmijëve

- Ofruesve të shërbimeve të vijës së parë, si për shembull: Punonjësve të Mbrojtjes së Fëmijëve, Policisë, Shëndetësisë, Mirëqenies Sociale, Arsimit, Krerëve të komuniteteve, Sektorëve Ligjorë dhe të mbështetjes Psiko-sociale duhet t'u ofrohen mundësi për rritjen e kapaciteteve të tyre për ta kuptuar martesën e fëmijëve si një çështje të mbrojtjes së fëmijës dhe ta trajtojnë atë si të tillë, përmes një bashkëpunimi ndër-sektorial. Për këtë qëllim, duhet të vihen në dispozicion mekanizma efektive raportimi për të inkurajuar viktimat e martesës së fëmijëve dhe asaj të detyruar që të raportojnë shkeljen.
- Shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues, përfshirë informacion dhe materiale, duhet të vihen në dispozicion dhe të bëhen më të aksesueshme, veçanërisht duke investuar në mbërritjen e komuniteteve të veçuara, si dhe të zonave rurale dhe të thella, duke synuar specifikisht adoleshentët, me qëllim parandalimin e martesës së fëmijëve.
- Të mbështeten fëmijët dhe të rinjtë e prekur nga martesa në moshë të vogël që të shfrytëzojnë programet e shansit të dytë për t'u mundësuar të ndjekin arsimin edhe pasi të jenë martuar që t'i hapin vetes më shumë mundësi.
- T'i jepet përparësi mbështetjes për të rinjtë e martuar në moshë të vogël për të gjetur një punë, duke krijuar mundësi për të hapur një biznes të vogël dhe me programe strehimi.
- Të inkurajohen ofruesit e shërbimeve në vijë të parë që të mbështesin çiftet e reja që janë bërë prindër, për të zhvilluar aftësi jete dhe prindërore.

Shtojca 1: Standardet ndërkombëtare

Traktatet ndërkombëtare

Dokumenti i parë i OKB që adresoi pëlqimin në martesë dhe martesën e hershme ishte **Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut** (DUDNJ) (1948) (Neni 16). Kjo hodhi themelet për Rezolutën 843 (IX) të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së (1954), e cila thekson se martesë e fëmijëve është e papajtueshme me DUDNJ dhe u bën thirrje shteteve të 'marrin të gjitha masat e duhura' [. . .] [për të eliminuar plotësisht] martesat e fëmijëve dhe fejesën e vajzave të reja para moshës së pubertetit⁷⁵. **Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Pëlqimin në Martesë, Moshën Minimale për Martesë dhe Regjistrimin e Martesave** (1962) deklaroi përsëri se martesë kërkonte pëlqimin e plotë dhe të lirë të të dy bashkëshortëve dhe se shtetet duhet të vendosin një moshë minimale ligjore për martesë, por nuk deklaroi se cila duhet të jetë kjo moshë.

Çështja e pëlqimit të plotë dhe të lirë për martesë u përsërit në **Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore** (KNDKSK) (1966), Neni 10 dhe **Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike** (KNDKCP) (1966), Neni 23.

Martesë e fëmijëve trajtuar në mënyrë specifike në **Konventën e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave** (KEGJFDG) (1979), së bashku me çështje më të gjëra në lidhje me të drejtat seksuale dhe riprodhuese të grave. Neni 16 i Konventës thekson se: 'fejesa dhe martesë e një fëmije nuk do të kenë efekt ligjor'. Ndonëse traktati nuk përcakton një moshë minimale martesë, Komenti i Përgjithshëm Nr. 21 (1994) nga Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave (organi monitorues për KEDGJFG) 'konsideron se moshë minimale për martesë duhet të jetë 18 vjeç, edhe për burrin edhe gruan' dhe vë në dukje ndikimin e dëmshëm të praktikës në shëndetin, arsimin, autonominë financiare dhe të drejtën e bashkëshortes fëmijë për të zgjedhur partnerin e saj.⁷⁶

Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (KDF) (1989) nuk e trajton në mënyrë të veçantë çështjen e martesës së fëmijëve. Megjithatë, KDF vlerëson praktikën e dëmshme tradicionale (neni 24) dhe një numër dispozitash të KDF-së gjithashtu adresojnë shkeljet e të drejtave të fëmijëve që ndodhin në kontekstin e martesës së fëmijëve, siç është dhuna ndaj fëmijëve (neni 19), abuzimi seksual dhe shfrytëzimi i fëmijëve (neni 34) dhe mohimi i qasjes në arsim (neni 28). Komenti i Përgjithshëm Nr. 4 (2003) i Komitetit për të Drejtat e Fëmijës (i cili monitoron pajtueshmërinë me KDF-në) i bën thirrje shteteve palë të vendosin 18 vjeç si moshën minimale ligjore për martesë për gratë dhe burrat. Përveç kësaj, Komenti thotë se martesë e fëmijëve përbën një praktikë tradicionale të dëmshme, që ndikon negativisht tek të drejtat riprodhuese dhe seksuale të vajzave.⁷⁷

Edhe Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave edhe Komiteti për të Drejtat e Fëmijës shpesh e ngrenë martesën e fëmijëve si një çështje që duhet adresuar në Vëzhgimet e tyre Përfundimtare mbi raportet periodike të shteteve nënshkruese.⁷⁸

Deklarata e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e Dhunës ndaj Grave (1993) nuk e përfshin martesën e hershme ose martesën e detyruar brenda përkufizimit të saj të dhunës kundër grave, por u bën thirrje shteteve palë të veprojnë për të mbrojtur gratë dhe vajzat nga praktikat tradicionale të dëmshme dhe nga format e dhunës që ndodhin shpesh brenda martesave të hershme.⁷⁹

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Instrumentet rajonale

Këshilli i Evropës ritheksoi rëndësinë e një moshe minimale për martesë në **Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut** (1950). Neni 12 i Konventës parashikon që 'burrat dhe gratë e moshës martesore kanë të drejtë të martohen dhe të krijojnë [një] familje'.⁸⁰

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE) e adresoi martesën e fëmijëve në **Rezolutën e saj mbi Martesat e Detyruara dhe Martesat e Fëmijëve** (2005). Ndër rekomandimet e saj, Rezoluta nxit shtetet anëtare: të përmbahen nga njohja e martesave të detyruara dhe martesave të fëmijëve të kontraktuara jashtë vendit, përveç se kur njohja do të ishte në interesin më të mirë të viktimave; të lehtësojnë anulimin e martesave të detyruara; dhe të shqyrtojnë kriminalizimin e martesës së detyruar, si një shkelje e veçantë. Rezoluta rekomandon gjithashtu që marrëdhëniet seksuale shtrenguese brenda martesave të detyruara dhe të fëmijëve duhet të konsiderohen si përdhunim.⁸¹

Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) ndalon martesën e detyruar, por nuk merret në mënyrë të veçantë me martesën e fëmijëve.

Planet ndërkombëtare të veprimit

KNPZh dhe Platforma për Veprim e Pekinit

Duke njohur ndikimet negative të martesës së hershme në të drejtat riprodhuese dhe, përfundimisht, zhvillimin, Programi i Veprimit i dakorduar pas Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin (KNPZh), i mbajtur në vitin 1994, i bën thirrje shteteve palë që të dekurajojnë martesën e hershme dhe të krijojnë një marrëdhënie socio- ekonomike 'që çon në eliminimin e të gjitha martesave të fëmijëve'.⁸² Programi i Veprimit i KNPZh-së gjithashtu ripohon se të gjitha martesat duhet të bazohen në pëlqimin e lirë dhe të plotë të të dy bashkëshortëve.

Qeveritë pjesëmarrëse në Konferencën e Katërt Botërore mbi Gratë, të mbajtur në Pekin, në vitin 1995, miratuan dhe u angazhuan për zbatimin e Platformës për Veprim të Pekinit (PpV Pekin), e cila ia kushtoi një nga objektivat e saj strategjike realizimit të të drejtave të fëmijëve vajza. Në lidhje me martesën e hershme, klauzolat përfshinin: zbatimin e ligjeve për të siguruar që martesa lidhet vetëm me pëlqimin e lirë dhe të plotë të të dy bashkëshortëve synues; zbatimin e ligjeve në lidhje me moshën minimale të martesës; dhe ngritjen e moshës minimale ligjore të martesës, ku është e nevojshme.

OZhM-të dhe OZhQ-të

Ndërsa Objektivat e Zhvillimit të Mijëveçarit (OZhM-të) nuk adresojnë drejtpërdrejtë martesën e fëmijëve, OZhM 3, treguesi 3.1 (eliminimi i pabarazisë gjinore në arsimin fillor dhe të mesëm) dhe dy synimet nën OZhM 5 (Synimi 5.A: reduktimi i raportit të vdekshmërisë amësore; dhe Synimi 5.B: qasje universale në shëndetin riprodhues) ishin të rëndësishme për të inkurajuar shtetet palë për të kundërshtuar praktikën.⁸³

Dhënia fund e praktikës së martesës së fëmijëve globalisht është përfshirë në Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ) 5, 'Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave'. Synimi 5.3 është 'eliminimi i të gjitha praktikave të dëmshme, të tilla si martesa e fëmijëve, e hershme dhe e detyruar dhe gjymtimi gjenital i femrave'.⁸⁴ Duke pasur parasysh lidhjet ndërmjet martesës së fëmijëve, pjellorisë adoleshente dhe vdekshmërisë foshnjore dhe të nënës, zvogëlimi i numrit të vajzave që martohen dhe lindin fëmijë është po ashtu përbërës në realizimin e OZhQ 3, 'Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat'. Synimet e veçanta domethënëse, sipas OZhQ 3 janë: 3.1: Zvogëlimi i raportit të vdekshmërisë globale të nënave; 3.2: dhënia fund e vdekjeve të parandalueshme të të sapolindurve dhe fëmijëve nën 5 vjeç; dhe 3.7: garantimi i qasjes universale në shërbimet e kujdesit shëndetësor seksual dhe riprodhues.⁸⁵

Shtojca 2: Nxitësit dhe ndikimet e martesës së fëmijëve të identifikuar në nivel botëror, rajonal dhe kombëtar

Nxitësit e martesës së fëmijëve

Pabarazia gjinore

Megjithëse martesa e fëmijëve shpesh është kundër ligjit ... ajo vazhdon, sepse është një normë sociale e rrënjosur thellë e shoqëruar me perceptimet e familjetit dhe burrësisë dhe vlerësohet vendimtare të mbajtur vlerat shoqërore.⁸⁶

Bazën e veprimit të praktikës së martesës së fëmijëve në çdo rajon e formojnë normat shoqërore që mbështesin pabarazinë gjinore.⁸⁷ Martesa e fëmijëve nxitet nga mungesa e vlerës që i vendoset arsimit të vajzave dhe përmbushjes së mundshme profesionale, lidhjet midis kontrollit të seksualitetit të vajzave dhe grave dhe familjes më të gjerë dhe 'nderit' në komunitet, perceptimit se roli i grave duhet të kufizohet në punën e shtëpisë dhe rritjen e fëmijëve dhe supozimi shpesh i padiskutueshëm se një 'grua e mirë' është një bashkëshortee bindur dhe e nënshtruar.

Për më tepër, në shumë komunitete ku praktikohet martesa e fëmijëve, fëmijët, në përgjithësi, dhe vajzat, në veçanti, kanë shumë pak zë në vendimet që ndikojnë jetën e tyre të bërë në nivel familjar, pasi normat shoqërore diktojnë se pritet që ato t'u binden prindërve dhe të moshurave. Kjo e bën të vështirë për to që të kundërshtojnë vendimin për ta hequr vajzën nga shkolla dhe për ta martuar.⁸⁸

Mungesa e vlerës që i vendoset arsimit të vajzave

Arsimi i vajzave dhe qëndrimet e prindërve për arsimin e tyre janë faktorë të fortë përcaktues në lidhje me martesën e fëmijëve. Për ta thënë thjesht, sa më gjatë të qëndrojnë një vajzë në shkollë, aq më vonë do të martohet.⁸⁹ Kur prindërit nuk i japin shumë vlerë arsimit të vajzave, në bazë të faktit se fati i tyre është martesa dhe fëmijët, sesa të punojnë jashtë shtëpisë, atëherë kjo mund të përdoret si justifikim për largimin e tyre nga shkolla, duke i vendosur ato në rrezik më të madh të martesave të fëmijëve.⁹⁰

Sidoqoftë, është e rëndësishme të theksohet se, përveç mos vlerësimit të arsimit të vajzave, faktorë të tjerë mund të ndikojnë në vendimin për ta larguar një vajzë nga shkolla, përfshirë pengesat praktike, si distanca që një vajzë duhet të përshkojë për në shkollë, cilësia e dobët e arsimit të ofruar, qëndrimet negative të mësuesve ndaj nxënësve femra dhe paaftësia e shkollave për t'i ruajtur vajzat nga ngacmimet seksuale dhe forma të tjera të dhunës.⁹¹ Kur lenë shkollën, pavarësisht arsyeve të braktisjes së saj, një vajzë është në rrezik shumë më të madh për t'u martuar.

Kontrolli i seksualitetit dhe lëvizjeve të vajzave

Justifikimet për heqjen e vajzave nga shkolla dhe për t'i martuar ata herët, shpesh, lidhen me normat shoqërore rreth kontrollit të lirisë së lëvizjes së vajzave dhe bashkëveprimit social, në mënyrë që të sigurohet se nuk kryejnë marrëdhënie seksuale paramartesore, që mund të ndikojnë në 'nderin' e tyre dhe të familjes. Këto argumente jepen po ashtu për të justifikuar largimin e një vajze nga shkolla, ku ajo mund të bjerë në kontakt me djem.⁹²

Martesa si mundësia e vetme për vajzat

E lidhur ngushtë me mungesën e vlerës së vendosur në arsimin e vajzave dhe dëshira për të kontrolluar seksualitetin e tyre dhe ndërveprimin shoqëror është qëndrimi se martesa përfaqëson të vetmen të ardhme të pranueshme për vajzat.⁹³ Hulumtimet nga situata të ndryshme kanë treguar si prindërit shpesh mendojnë se është e rëndësishme për statusin e familjes së tyre dhe një pjesë e detyrave të tyre ndaj vajzës që të sigurojnë një 'burrë të mirë' për të dhe që ta bëjnë këtë sa më shpejt që të jetë e mundur: kjo ndihmon në nxitjen e martesës së fëmijëve.⁹⁴ Përveç kësaj, perceptimi se bashkëshortet fëmijë do të jenë më të bindura dhe të nënshtruara se gratë më të mëdha dhe se do t'i pranojnë rolet tradicionale gjinore brenda familjes, është një tjetër faktor që e nxit praktikën.⁹⁵

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Varfëria dhe përjashtimi social

Vajzat që kanë më shumë gjasa të martohen para moshës 18 vjeç banojnë në zona rurale dhe të largëta, kanë pak ose aspak arsimim dhe jetojnë në familjet më të varfra.⁹⁶

Në nivel global, rajonal dhe kombëtar, shumë studime kanë treguar se varfëria është një nxitës kyç i martesës së fëmijëve.⁹⁷ Familjet mund të justifikojnë martesën e një vajze, pasi kjo do të thotë 'një gojë më pak për të ushqyer' në shtëpi, kur ajo shkon të jetojë me burrin,⁹⁸ ndërsa vajzat mund të pranojnë martesën si një mënyrë për t'i shpëtuar mbipopullimit dhe mungesës së parave në shtëpi.⁹⁹ Në shoqëritë ku paguhet çmimi i nuses ose paja, ky mund të jetë gjithashtu një faktor në vendim.¹⁰⁰

Varfëria e ndërthurur me përjashtimin social mundet po ashtu t'i shtyjë të rinjtë në martesë, nëse ata dhe familjet e tyre nuk shohin mundësi reale për të siguruar punësim të denjë përballë diskriminimit dhe marginalizimit. Kjo ka qenë një gjetje e qëndrueshme në hulumtimin mbi martesën e fëmijëve në komunitetet rome, të cilat përjetojnë nivele të larta të varfërisë dhe përjashtimit social në të gjithë Evropën.¹⁰¹

Është treguar gjithashtu se edhe nivelet e larta të emigracionit, shpesh të lidhura me varfërinë, nxisin martesën e fëmijëve, pasi burrat që emigrojnë ulin numrin e burrave 'të përshtatshëm' për martesë, që do të thotë se prindërit duan t'i martojnë vajzat e tyre sa më shpejt që të jetë e mundur.¹⁰² Së fundi, martesa e fëmijëve është gjithashtu e lidhur fort me jetesën në zonat e thella rurale.¹⁰³

Zbatim i paqëndrueshëm ose i dobët i mbrojtjes ligjore

Shumica e vendeve kanë legjislacion në fuqi, i cili specifikon një moshë minimale për martesë (edhe pse kjo mund të jetë më e ulët se 18 vjeç) dhe shumë të tjerë kanë legjislacion të veçantë që e vlerëson martesën e fëmijëve dhe/ose martesën e detyruar vepër penale. Megjithatë, dështimi i agjencive shtetërore për të zbatuar legjislacionin mund t'i lërë adoleshentët të pambrojtur. Ligjet që kriminalizojnë martesën e detyruar ose martesën e fëmijëve shpesh nuk zbatohen në mënyrë efektive,¹⁰⁴ për shkak të ngurrimit të policisë apo gjykatës për të ndërhyrë në çështje 'private' ose 'kulturore'. Kjo ndodh veçanërisht kur martesa e fëmijëve dhe martesa e detyruara zhvillohen në komunitetet minoritare.¹⁰⁵ Regjistrimi problematik i lindjeve kombëtare gjithashtu mund ta vështirësojë zbatimin e moshës minimale të martesës.¹⁰⁶

'Tronditjet': tranzicioni ekonomik, konflikti dhe fatkeqësitë natyrore

Studimet kanë gjetur se në komunitetet ku martesa e fëmijëve tashmë është një normë sociale e themeluar, 'tronditjet' si konflikti i dhunshëm, kolapsi ekonomik apo fatkeqësitë natyrore mund të shtyjnë më shumë prindër të vendosin t'i martojnë vajzat e tyre. Një 'tronditje' në nivel familjar, si vdekja e një familjari që është siguruesi kryesor i të ardhurave, mund të rezultojë në vendimin e familjeve që t'i martojnë vajzat e reja.¹⁰⁷ Dëshmitë nga Kosova sugjerojnë se shkalla e martesës së fëmijëve u rrit gjatë konfliktit në vitin 1999, pasi prindërit i martonin vajzat e tyre për t'i mbrojtur, dhe vajzat që kishin mbetur jetime dhe/ose si kryefamiljare kërkuan mbrojtje dhe një mbajtës të familjes.¹⁰⁸ Shkallë rritëse të martesës së fëmijëve janë regjistruar midis refugjatëve që arratiseshin nga lufta në Siri.¹⁰⁹

Të rinjtë që zgjedhin të martohen

Në disa raste të martesës së fëmijëve, një adoleshent/e mund të zgjedhë të martohet me një adoleshent/e tjetër ose një partner më të madh. Sidoqoftë, ky vendim mund të ndikohet nga faktorë të tjerë, si varfëria dhe mbipopullimi në shtëpi, shtatzënia e paplanifikuar, presioni për t'u martuar nga prindërit, kur zbulojnë se vajza takon një të dashur, ose një dëshirë për t'i shpëtuar një jete të pakënaqur familjare.¹¹⁰

Ndikimet e martesës së fëmijëve

Mëmësia e hershme

Në nivel botëror, shumica e adoleshenteve që lindin janë tashmë të martuara ose jetojnë në një formë bashkimi të miratuar nga familja dhe komuniteti i tyre.

Në shumë raste të martesës së fëmijëve, adoleshentet e martuara nuk kanë kontroll mbi atë nëse duhet të mbeten shtatzëna apo jo dhe mbi numrin e shtatzënieve, vitet midis tyre dhe kohën e shtatzënisë; shpesh, ato janë nën presion të madh që të bëjnë fëmijë brenda vitit të parë të martesës.¹¹¹ Kjo i lë ato në rrezik të shtatzënanive të padëshiruara, si dhe të marrjes së HIV-it apo sëmundjeve të tjera të transmetueshme seksualisht.¹¹² Qasja e bashkëshorteve fëmijë në shërbimet e shëndetit riprodhues gjithashtu mund të jetë e kufizuar, ose për shkak të mungesës së shërbimeve të përshtatshme dhe të qasshme, ose sepse bashkëshortët dhe familjarët e tyre nuk i lejojnë bashkëshortet fëmijë të ndiqen në klinika ose këmbëngulin t'i shoqërojnë ato.¹¹³ Sa më e re të jetë vajza kur mbetet shtatzënë, aq më i madh është rreziku për shëndetin e saj.¹¹⁴ Shtatzënia e adoleshenteve mbetet një kontribues kryesor në vdekshmërinë e nënës dhe fëmijës. Mungesa e pjekurisë fizike nënkupton që ndërlikimet e lidhura me shtatzëninë janë një shkaktar kryesor i vdekjeve midis vajzave të moshës 15-19 vjeç në vendet në zhvillim. Studimet kanë treguar se nënat nga 15 deri në 19 vjeç kanë dy herë më shumë gjasa të vdesin gjatë shtatzënisë ose në lindje se nënat e moshës midis 20 dhe 24 vjeç, dhe gjasat për vajzat nën 15 vjeç pesëfishohen.¹¹⁵ Nëna adoleshente (10 deri në 19 vjeç) përballen me rreziqe më të larta të eklampsisë, endometritit puerperal dhe infeksioneve sistemike se gratë e moshës 20 deri në 24 vjeç.¹¹⁶ Vajzat që i mbijetojnë shtatzënisë mund të përballen me probleme të shëndetit riprodhues, përfshirë fistulat obstetrike, të cilat mund të çojnë në izolim dhe stigmatizim.¹¹⁷ Për më tepër, nevojat emocionale, psikologjike dhe sociale të adoleshenteve shtatzëna mund të jenë më të mëdha se ato të grave të tjera. Përveç kësaj, çdo vit ndodhin rreth 3.9 milionë aborte të pasigurta tek vajzat e moshës 15-19 vjeç, duke kontribuar në vdekshmërinë e nënave dhe probleme shëndetësore afatgjata.¹¹⁸

Shtatzënia në moshë të hershme mund të rrisë rreziqet për të sapolindurit, si dhe nënat e reja. Në vendet me të ardhura të ulta dhe të mesme, foshnjat e lindura nga nëna nën 20 vjeç përballen me rreziqe më të larta të peshës së ulët të të sapolindurit, lindjes së parakohshme dhe kushteve të rënda neonatale.¹¹⁹ Fëmijët e lindur nga nëna nën moshën 18 vjeçare gjithashtu janë në rrezik më të madh të mbytjes dhe vdekjes para ditëlindjes të tyre të pestë krahasuar me fëmijët e lindur nga nëna më të mëdha në moshë.¹²⁰ Mungesa e shkollimit të vajzave të martuara do të thotë se ka më pak gjasa që ato të kenë njohuri për çështjet që kanë të bëjnë me shëndetin dhe ushqyerjen e fëmijëve, që do të thotë se ka më shumë gjasa që fëmijët e tyre të jenë të kequshqyer dhe kanë më pak gjasa të vaksinohen.¹²¹

Varfëria dhe përjashtimi social

Varfëria e familjes është një faktor kyç që nxit martesën e fëmijëve në shumë vende, por është gjithashtu një rezultat, pasi martesa e fëmijëve shërben për të zgjatur vazhdimësinë e varfërisë ekstreme dhe pabarazisë për vajzat e martuara si fëmijë dhe për fëmijët e tyre.¹²² Kjo është e lidhur ngushtë me braktisjen e shkollës, pasi mos përfundimi i shkollimit të mesëm do të thotë që vajzat e martuara nuk kanë aftësitë, njohuritë ose aftësimin profesional që iu duhet për të gjetur punë në ekonominë formale dhe kanë më pak gjasa të marrin pjesë në fuqinë punëtore formale, në përgjithësi.¹²³ Kjo mund të ketë efektin e uljes së të ardhurave të familjes në përgjithësi dhe mbajtjes së familjeve në varfëri.

Përjashtimi social dhe marginalizimi janë faktorë të rëndësishëm në nxitjen e martesës së fëmijëve, por martesa e fëmijëve gjithashtu shërben për të përforcuar përjashtimin social, për shembull duke kontribuar në qëndrimet diskriminuese ndaj komuniteteve ku ajo praktikohet, si dhe duke ndihmuar në mbajtjen e adoleshenteve jashtë arsimit, punësimit, dhe hapësirave të tjera, ku ato mund të kenë qasje në mbështetje formale për t'u integruar.¹²⁴

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Braktisja e shkollës

Martesa e fëmijëve për vajzat është e lidhur fort me braktisjen e shkollës dhe mos përfundimin e arsimit të mesëm. Vërtetë, në vendet dhe komunitetet me përhapje të lartë të martesës së fëmijëve, martesa zakonisht është arsyeja kryesore që vajzat lënë arsimin. Nëse një vajzë nuk hiqet nga shkolla për t'u martuar, atëherë ka shumë mundësi që ajo do ta lerë shkollën pas martesës dhe/ose kur të mbetet shtatzënë.¹²⁶ Kjo do të thotë që adoleshentet e martuara humbasin mundësinë që të përftojnë aftësi dhe njohuri teknike, të kuptojnë shëndetin (përfshirë shëndetin dhe të drejtat riprodhues) dhe të ushqyerit dhe besimin që do të fitonin në shkollën e mesme.¹²⁷ Edhe një herë, kjo e bën edhe më të mundur që adoleshentet e martuara të mbeten në varfëri dhe të përjetojnë përjashtim social, teksa lëvizin drejt moshës madhore.

Në situatat ku djemtë preken po ashtu nga martesa e fëmijëve, si në Nepal dhe tek romët në Evropën juglindore, braktisja e shkollës e shkaktuar nga martesa gjithashtu kontribuon në mbajtjen të varfër të djemve të martuar, dhe bashkëshortëve e fëmijëve të tyre.¹²⁸

Zgjatja e vazhdimësisë së pabarazisë gjinore

Ashtu si martesa e fëmijëve nxitet nga pabarazia gjinore, praktika gjithashtu shkakton zgjatjen e vazhdimësisë së pabarazisë gjinore. Në shumë bashkësi ku praktikohet martesa e fëmijëve, gratë shkojnë për të jetuar me familjen e bashkëshortit pas martesës. Një vajzë e martuar shpesh zë statusin më të ulët në njësinë familjare të bashkëshortit dhe është nën kontrollin efektiv të bashkëshortit dhe familjarëve të tij, duke 'e kufizuar aftësinë e saj për të shprehur mendimet dhe për të ndjekur planet dhe aspiratat e saj', si dhe fuqinë vendimmarrëse brenda njësisë familjare.¹²⁹ Kjo mungesë e ekuilibrit të pushtetit shpesh përkeqësohet nga një hendek i madh në moshë midis vajzave të martuara dhe bashkëshortëve të tyre.¹³⁰ Izolimi i kufizon mundësitë e vajzave të martuara për të marrë pjesë në diskutime dhe debate në nivel komunitar dhe kombëtar ose për t'u angazhuar në procese politike.¹³¹

Dhuna me bazë gjinore

Analistët kanë argumentuar se martesa e fëmijëve është, në vetvete, një formë e dhunës me bazë gjinore,¹³² pasi në praktikë, ajo sinjalizon shkeljen e të drejtës së një vajze për të marrë vendime për trupin e saj.¹³³ Praktika është përfshirë në listën e 'praktikave tradicionale të dëmshme' të shoqëruara me dhunën me bazë gjinore, të përfshira në dokumente të ndryshme ndërkombëtare dhe rajonale që kanë të bëjnë me të drejtat e grave dhe të drejtat e fëmijëve.

Bashkëshortet fëmijë janë gjithashtu më të cënuara nga dhuna në familje dhe format e tjera të abuzimit fizik, seksual dhe psikologjik nga bashkëshortët dhe familjarët e tyre, se ato që martohen më vonë.¹³⁴ Studime të shumta kanë gjetur edhe se, ka më shumë gjasa që, krahasuar më gratë e martuara më të mëdha në moshë, vajzat e martuara të besojnë se dhuna në familje kundër grave është e justifikuar në rrethana të caktuara.¹³⁵ Po ashtu, familja e burrit mund të mos i japë bashkëshorteve fëmijë veshje të mjaftueshme ose mjaft ushqim dhe t'i detyrojë ato të punojnë orë të gjata brenda dhe jashtë shtëpisë.¹³⁶

Në shumë kontekste, përvojat e para seksuale të vajzave të martuara shpesh janë të forcuara dhe traumatike. Përvoja traumatike e seksit të detyruar mund të përkeqësohet nga fakti se vajza mund të mos dijë asgjë ose fare pak për seksin, para se të martohet dhe mund të jetë plotësisht e papërgatitur.¹³⁷

Ndikimet e mirëqënies psikologjike dhe emocionale

Pas martesës, vajzat e martuara mund të kenë lëvizshmëri shumë të kufizuar; kontakti me prindërit e tyre mund të kontrollohet ose të kufizohet¹³⁸ dhe bashkëshortët dhe familjarët e tij mund t'i ndalojnë ato që të mbeten në kontakt me miqtë ose mund ta kenë shumë të vështirë t'i ruajnë kontaktet.¹³⁹ Për shkak të kësaj, bashkëshortet fëmijë mund të jenë shumë të izoluar dhe të kenë pak qasje në mbështetjen sociale.¹⁴⁰ Kjo, bashkuar me statusin e tyre të ulët dhe mungesës së zërit në familjen e bashkëshortit, një barrë e madhe punësh shtëpiake dhe kujdesit për fëmijët dhe, në disa raste, trauma pas kontaktit të detyruar seksual ose dhunave të tjera, mund të ketë një ndikim të madh në mirëqënien emocionale dhe psikologjike të vajzave të martuara.¹⁴¹ Megjithatë, këto janë të vështira për t'u vlerësuar, pasi ato mund të ndryshojnë në intensitet, të kenë pasoja afatgjata emocionale dhe nuk janë të dukshme menjëherë.

Karakteristikat e martesës së fëmijëve në Shqipëri

Hulumtimi cilësor i ndërmarrë nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve dhe UNFPA ka treguar se, në Shqipëri, martesa e fëmijëve është një çështje që prek intensivisht vajzat dhe që prek veçanërisht vajzat nga pakica rome. Megjithatë, është e rëndësishme që martesa e fëmijëve të mos karakterizohet si një çështje 'minoriteti'. Studimet cilësore në shkallë të vogël të UNFPA-s dhe Observatorit kanë treguar se martesat e fëmijëve ndodhin në mesin e popullatës së përgjithshme shqiptare dhe se vajzat që jetojnë në zonat rurale, në komunitetet e largëta, malore dhe në zonat kufitare mund të jenë veçanërisht në rrezik.¹⁴²

Ka të ngjarë që shumica e martesave që përfshijnë adoleshentët, brenda komuniteteve rome dhe popullatës së gjerë, nuk janë të regjistruara. Në dy qarqe të Shqipërisë, Korçë dhe Vlorë, gratë që ishin martuar para moshës 18 vjeçe, të cilat u intervistuan nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, 'ishin shpesh të hutuara kur u pyetën për statusin ligjor të marrëdhënieve të tyre', pasi bashkëjetesa shihej si një formë e 'martesës sociale' që ishte miratua nga prindërit dhe komuniteti më i gjerë.¹⁴³ Megjithatë, hulumtimi i Observatorit tregon se martesat e fëmijëve, që përfshijnë jo-romë, kanë më shumë gjasa të regjistrohen, pas një kërkesë në gjykatë për të zhvilluar martesën. Ky është një proces që lidhet ngushtë me regjistrimin e fëmijëve për qëllime shëndetësore dhe përfitimet e sigurimeve shoqërore, si dhe për të lehtësuar emigracionin (kur burri tashmë jetonte jashtë vendit.)¹⁴⁴

Faktorët që nxisin martesën e fëmijëve në Shqipëri

Hulumtimet e realizuara deri më sot nga Observatori dhe UNFPA ka treguar se faktorët kryesorë që nxisin martesën e fëmijëve në Shqipëri janë pabarazia gjinore, si dhe varfëria dhe përjashtimi social. Duket edhe se gjykatat luajnë një rol në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për martesat e fëmijëve, siç u diskutua më sipër. Në fund, ndërsa shumë martesat e fëmijëve në Shqipëri stisen nga prindërit, disa adoleshentë zgjedhin të martohen. Megjithatë, siç është gjetur në kontekste të tjera kombëtare, mund të ketë shumë faktorë të tjerë që ndikojnë në këtë vendim, duke përfshirë: varfërinë dhe mbipopullimin në shtëpi; shtatëzaninë e paplanifikuar; presionin nga prindërit për t'u martuar, kur këta të fundit zbulojnë se vajza është e lidhur me dikë ose; një dëshirë për t'i shpëtuar jetës jo të lumtur në shtëpi.¹⁴⁵

Pabarazia gjinore

Mungesa e vlerës që i vendoset arsimit të vajzave, që rrjedh nga paragjykimet gjinore, është një faktor që nxit martesën e fëmijëve në Shqipëri.¹⁴⁶ Hulumtimet nga Observatori dhe UNFPA zbuluan se, në komunitetet ku praktikohet martesa e fëmijëve, vajzat dhe gratë inkurajohen ta shohin martesën dhe fëmijët si të ardhmen e vetme të pranueshme.¹⁴⁷ Kjo pastaj bëhet një justifikim për t'i larguar vajzat nga shkolla, duke i vendosur ato në rrezik më të madh të martesës së fëmijëve. Kjo ishte një nga gjetjet në nivel rajonal e hulumtimit të UNFPA-së në 14 vende në rajonet e Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore,¹⁴⁸ përfshirë Shqipërinë; ajo ishte gjithashtu një nga gjetjet e hulumtimit të Observatorit për martesën e fëmijëve midis romëve në Shqipëri.¹⁴⁹

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Në hulumtimin rajonal të UNFPA-së, nevoja për të garantuar që vajzat nuk humbasin virgjërinë para martesës, për të siguruar 'nderin' e familjes, u përmendën si një arsye e rëndësishme që prindërit i heqin vajzat nga shkolla dhe për stitjen e martesave të hershme, për t'i ndaluar që ato të bien në kontakt me djem.¹⁵⁰ Kjo ishte gjithashtu një gjetje e hulumtimit të Observatorit mbi martesën e fëmijëve midis romëve në Shqipëri.¹⁵¹

Në shumë komunitete ku praktikohet martesa e fëmijëve, përfshirë tek romët dhe komunitete të largëta, malore në Shqipëri,¹⁵² fëmijët, në përgjithësi, dhe vajzat, në veçanti, kanë shumë pak zë në vendimet që ndikojnë në jetën e tyre.¹⁵³ Hulumtimet e UNFPA në Shqipëri gjithashtu zbuluan se në komunitete të largëta rurale, përveç faktit që vajzat kanë fare pak ose aspak zë se kur do të martohen, edhe nënat e tyre nuk ishin në gjendje të kundërshtonin vendimet e marra nga burrat e tyre, që do të thotë se ato nuk mund të ndërhyjnë në emër të vajzave të tyre.¹⁵⁴

Varfëria dhe përjashtimi social

Varfëria dhe përjashtimi social janë faktorë të rëndësishëm që nxisin martesën e fëmijëve. Kjo ka qenë një gjetje e qëndrueshme në hulumtimin mbi martesën e fëmijëve në komunitetet rome, përfshirë edhe në Shqipëri. Është dëshmuar se varfëria i shtyn adoleshentët në martesë për arsye ekonomike ose për shkak se prindërit e tyre duan të kenë 'një gojë më pak për të ushqyer' në shtëpi, ose për shkak se adoleshentja dëshiron të shpëtojë nga varfëria dhe mbipopullimi në shtëpi.¹⁵⁵ Tek romët, përfshirë këtu edhe në Shqipëri, mungesa e dokumenteve të identitetit, shkallët e larta të braktisjes së shkollës, papunësia e lartë, mbipopullimi dhe qasja e dobët në shërbime janë të gjitha tiparet e marginalizimit social që përball kjo popullsi.¹⁵⁶ Ata janë gjithashtu faktorë që nxisin martesën e fëmijëve, ku adoleshentët shpesh ndejnë se martesa është mundësia e vetme që u mbetet.

Lidhur me varfërinë, disa studime tregojnë se, migrimi është gjithashtu në disa kontekste një faktor në nxitjen e martesës së fëmijëve. Sipas hulumtimeve cilësore nga UNFPA dhe nga Observatori,¹⁵⁷ në Kosovë dhe Shqipëri, prindërit e panë martesën me një burrë që kishte emigruar, si një mënyrë për të garantuar sigurinë ekonomike të vajzave të tyre. Të dhënat nga diskutimet e grupeve të fokusit të kryera për këtë hulumtim e mbështesin po ashtu këtë, ku disa të anketuar nga grupet e ndryshme të popullsisë përmendën një lidhje midis martesës së fëmijëve dhe emigracionit. Sidoqoftë, nevojiten hulumtime të mëtejshme për të hetuar nëse emigrimi është vërtetë një faktor i rëndësishëm që nxit martesën e fëmijëve në Shqipëri.

Shtojca 3: Metodologjia e zgjeruar Informacion mbi bashkitë e përzgjedhura

Në të katër rajonet fokale të këtij studimi, bashkitë e targetuara janë selektuar më tej bazuar në përqëndrimin e popullsisë rome,¹⁵⁸ dhe bazuar në përqindjen e varfërisë.¹⁵⁹

Bashkitë e zgjedhura ku ky studim u realizua janë:

- Bashkia Durrës, e cila ndodhet në pjesën qendrore të vendit dhe është një bashki bregdetare. Kjo bashki është bashkia qendrore e qarkut dhe ka një normë të moderuar varfërie (përqindja e varfërisë llogaritet të jetë 0.141) dhe një numër të lartë të popullsisë rome (577 pjesëtar të komunitetit rom)
- Njësia Administrative Sukth, e cila është njësi e Bashkisë Durrës, është një zonë e izoluar dhe ka nivelin më të lartë të varfërisë ndër të gjitha bashkitë e qarkut Durrës (përqindja e varfërisë është 0.211). Popullsia rome llogaritet të jetë vetëm 17 pjesëtarë të komunitetit rom.
- Bashkia Korçë, e cila është e lokalizuar në pjesën Jug-Lindore të vendit dhe është bashkia qendrore e qarkut Korçë. Përqindja e varfërisë në këtë bashki llogaritet të jetë 0.096, dhe ndërkohë ka edhe përqëndrimin më të madh të popullsisë rome (784 pjesëtarë të komunitetit rom)
- Njësia Administrative Pojan e cila është një nën-ndarje e bashkisë Maliq në qarkun e Korçës. Kjo Njësi administrative ka edhe nivelin më të lartë të varfërisë (Përqindja e varfërisë është 0.115), dhe një numër të ulët të popullsisë rome (94 pjesëtarë të komunitetit rom).
- Njësia administrative Bilisht është njësi administrative përbërëse e bashkisë Devoll në qarkun e Korçës. Qyteti i Bilishtit është qyteti më jug-lindor i Shqipërisë, dhe ndodhet vetëm 9 km nga kufiri me Greqinë në Kapshticë. Ka një nivel të moderuar varfërie (përqindja e varfërisë është 0.085) dhe ka një përqëndrim të lartë të popullsisë rome (274 pjesëtarë të komunitetit rom).
- Bashkia Lezhë është një qytet dhe bashki në Veri-Perëndim të Shqipërisë në qarkun e Lezhës. Ka një nivel mesatar varfërie (Përqindja e varfërisë është 0.13) dhe gjithashtu është edhe bashkia me përqëndrimin më të lartë të popullsisë rome (223 pjesëtarë të komunitetit rom).
- Njësia Administrative Fushë Kuqe është fshat dhe nën-ndarje e bashkisë Kurbin në qarkun e Lezhës. Ka një nivel të lartë të varfërisë (Përqindja e varfërisë është 0.2) dhe në të llogariten 16 pjesëtarë të komunitetit rom.
- Njësia administrative Fan është një fshat dhe nën-ndarje e bashkisë Mirditë në qarkun e Lezhës. Ka nivelin më të lartë të varfërisë në qark (Përqindja e varfërisë është 0.238), dhe në të nuk ka komunitet rom.
- Bashkia Tiranë është kryeqyteti dhe si dhe qyteti më i madh i Shqipërisë. Është gjithashtu edhe zemra e aktivitetit kulturor, ekonomik dhe qeveritar të Shqipërisë, lokalizuar në cepin Qëndror-Perëndimor të vendit. Ka një nivel të ulët varfërie (Përqindja e varfërisë është 0.092) dhe është bashkia me përqëndrimin më të lartë të komunitetit rom në të gjithë vendin (Numri i pjesëtarëve të komunitetit rom llogaritet të jetë 2631).
- Bashkia Kamëz është një bashki periferike në qarkun e Tiranës. Është bashkia me normën më të lartë të varfërisë në qark (Përqindja e varfërisë është 0.252) dhe ka një numër mjaft të ulët të pjesëtarëve të komunitetit rom (vetëm 5 pjesëtarë të komunitetit rom).
- Bashkia Rrogozhinë është një qytet dhe bashki në qarkun e Tiranës, e lokalizuar në rajonin e ultësirave Qendrore-Perëndimore të Shqipërisë. Kjo bashki ka një normë të lartë varfërie (përqindja e varfërisë është 0.209) dhe një përqëndrim të lartë të komunitetit rom duke numëruar 189 pjesëtarë të komunitetit rom.

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Informacion mbi DGF-të

Diskutimet e fokus grupeve (DGF-të) kanë shumë avantazhe si metodë për mbledhjen e të dhënave mbi njohuritë, qëndrimet, besimet, perceptimet dhe pritjet, së bashku me informacionin mbi praktikatat e tyre individuale dhe komunitare. DGF-të janë mjaft fleksibël. Ato lejojnë mbledhjen e një sasive të madhe informacioni në një periudhë kohe relativisht të shkurtër. Një diskutim i gjallë në grup mund të gjenerojë njohuri të rëndësishme për tema që më parë nuk kuptoheshin mirë (siç janë, në këtë rast, ajo që formëson preferencat dhe mundësitë në lidhje me martesën e fëmijëve) dhe gjithashtu për një shumëllojshmëri të pikëpamjeve që shfaqen. Duke qënë se DGF-të lejojnë shfaqjen e opinionëve të grupeve, ato janë veçanërisht të dobishme për të konsideruar normat sociale.

DGF-të që vijojnë u zhvilluan veçmas me pjesëmarrës romë dhe jo-romë në çdo vend të grumbullimit të të dhënave.

- me gra të reja të moshë 18-24 vjeç;
- me burra të rinj të moshës 18-24 vjeç;
- me nëna/kujdestare të moshës 25-50 vjeç;
- me baballarë/kujdestarë të moshës 25-50 vjeç.

Kjo ndarje midis grupeve të ndryshme bazuar në moshën u bë me qëllim që të testohet nëse ka diferenca në njohuritë, qëndrimet, besimet, pritjet, besimet në lidhje me mundësitë, perceptimet dhe preferencat midis brezit të ri dhe një brezi më të vjetër (të rritur të rinj dhe prindër/kujdestarë). Për më tepër, hulumtuesit donin të siguroheshin se të anketuarit më të rinj në moshë do të ndjeheshin komod për të shprehur opinionet e tyre, gjë për të cilën mund të mos ishin ndjerë komod për ta bërë në praninë e njerëzve më të moshuar dhe gjithashtu për t'u siguruar se të anketuarit më të moshuar nuk do të dominonin diskutimin dhe të ndikonin mbi atë që më të rinjtë kishin për të thënë.

Grupe të fokusit të ndara u realizuan me burrat dhe gratë. Kjo u bë për t'u siguruar se të gjithë pjesëmarrësit do të mund të flisnin lirisht, duke përfshirë dhe ata nga komunitete shumë konservatore ku një grup diskutimi i përzier mund të konsiderohet i papërshtatshëm dhe/ose ku gratë mund të jenë potencialisht të rrezikuara nga të shprehurit për tema që konsiderohen të jenë sensitive. Kjo u bë gjithashtu edhe për të krijuar mundësinë për të regjistruar diferencat gjinore përsa i përket pikëpamjeve mbi njohuritë, qëndrimet dhe perceptimet.

Në total, 34 DGF u zhvilluan, të detajuara në tabelën më poshtë (dy DGF nuk u përdorën, pasi ishin grupe të përziera dhe nuk janë të përfshira më poshtë).

Tabela 7: Shpërndarja e DGF-ve

Grupi i popullsisë	Numri i DGF-ve	Vendndodhjet
Baballarë/kujdestarë romë që jetojnë në komunitete të integruara	1	Lezhë
Nëna/kujdestare rome që jetojnë në komunitete të integruara	3	Durrës; Rogozhinë; Korçë
Djem të rinj romë (18-24 vjeç) që jetojnë në komunitete të integruara	2	Durrës; Tiranë
Vajza të reja rome (18-24 vjeç) që jetojnë në komunitete të integruara	1	Lezhë
Baballarë/kujdestarë romë që jetojnë në komunitete të veçuara	2	Sukth; Tiranë
Nëna/kujdestare rome që jetojnë në komunitete të veçuara	1	Fushë Kuqe
Djem të rinj romë (18-24 vjeç) që jetojnë në komunitete të veçuara	3	Korçë; Lezhë

Vajza të reja rome (18-24 vjeç) që jetojnë në komunitete të veçuara	2	Shkozë; Korçë
Baballarë/kujdestarë jo-romë që jetojnë në zona rurale	2	Durrës; Pojan
Nëna/kujdestare jo-rome që jetojnë në zona rurale	2	Vaqarr; Sukth
Djem të rinj jo-romë (18-24 vjeç) që jetojnë në zona rurale	2	Sukth; Vaqarr
Vajza të reja jo-rome (18-24 vjeç) që jetojnë në zona rurale	3	Bilisht; Fan; Devoll
Baballarë/kujdestarë jo-romë që jetojnë në zona urbane të izoluar	2	Bathore, Durrës
Nëna/kujdestare jo-rome që jetojnë në zona urbane të izoluar	2	Bilisht; Lezhë
Djem të rinj jo-romë (18-24 vjeç) që jetojnë në zona urbane të izoluar	1	Lezhë
Vajza të reja jo-rome (18-24 vjeç) që jetojnë në zona urbane të izoluar	3	Tiranë; Durrës; Kamëz

Pjesëmarrësit në DGF u identifikuan me ndihmën e lehtësuesve lokalë të cilët janë ofrues shërbimesh dhe/ose persona me ndikimin në bashkitë e targetuara. Vështirësi u hazën vetëm për identifikimin e vajzave të reja rome të pamartuara para moshës 18 vjeç, pasi, sipas lehtësuesve lokalë, numri i tyre është tepër i ulët. Vërtetë, në Durrës, qe e mundur të gjendej vetëm një grua rome e cila nuk ishte martuar para moshës 18 vjeç e cila pranoi të marrë pjesë në hulumtim. Kjo grua u intervistua.

Informacion mbi Intervistat individuale

Ndërkohë që DGF-të ofruan të dhëna të rëndësishme përsa i përket perceptimeve mbi normat sociale, ato nuk siguruan 'tregime jete' të njerëzve të prekur direkt nga martesat e fëmijëve, apo lejuan diskutime mbi disa nga aspektet më sensitive të praktikës së martesës së fëmijëve. Vërtetë, konsideratat etike (specifikisht, mbrojtja e konfidencialitetit dhe siguria e të anketuarve) nënkuptojnë që DGF-të do të kishin qënë një metodë e papërshtatshme për të mbledhur këtë informacion dhe pyetjet e përfshira në guidat e DGF-ve nuk ishin përshtatur për të gjeneruar këtë lloj informacioni.

Vlen të theksohet se nuk u hazën vështirësi në identifikimin e të rriturve të rinj të martuar para moshës 18 vjeç në komunitetin rom. Gjatë komunikimeve me ofruesit e shërbimeve dhe OJF-ve lokale që ofrojnë shërbime në këto komunitete, u deklarua se martesat para moshës 18 vjeç janë shumë të zakonshme në këtë komunitet dhe se është e vështirë të gesh të rinj që nuk janë martuara para moshës 18 vjeç. Duke iu përqsasur të rinjve së bashku me një person që komuniteti i tyre e njih dhe e beson, nuk qe e vështirë për t'i inkurajuar ata të flasin me intervistuesit dhe të shprehin mendimet e tyre.

Situata ishte më ndryshe përsa i përket komuniteteve jo-rome ku praktika e martesave të fëmijëve duket të jetë jo kaq e zakonshme. Me ndihmën e lehtësuesve lokalë, dhe falë eksperiencës së zgjatur që stafi lokal i Observatorit ka në zonat respektive, u bë i mundur identifikimi i të rriturve të rinj të martuar para moshës 18 vjeç.

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Tabela 8: Shpërndarja e II-ve

	Durrës	Korçë	Lezhë	Tiranë
Djalë i ri jo-rom i martuar para moshës 18 vjeç		1	1	
Vajzë e re jo-rome e martuar para moshës 18 vjeç	1	1	2	
Djalë i ri rom i martuar para moshës 18 vjeç	1			1
Vajzë e re rome e martuar para moshës 18 vjeç	1	1	1	2
Grua më e madhe në moshë rome që ka martuar fëmijët para moshës 18 vjeç		1		1
Vajzë e re jo-rome JO e martuar para moshës 18 vjeç	1			

Informacion mbi Intervistat me Informatorët kyç

Pjesëmarrësit në IIK u përzgjedhën duke qënë njerëz në komunitetet e tyre të cilët kanë më shumë gjasa të kenë rënë në kontakt me të rritur të rinj të prekur nga martesa e fëmijëve dhe të kuptojnë impaktet e kësaj praktike. Pesëmbëdhjetë IIK u zhvilluan në total.

Tabela 9: Shpërndarja IIK-ve

	Durrës	Korçë	Lezhë	Tiranë
Mësues		1		2
Punonjës të qendrave shëndetësore		1		
Psikologë			1	
Staf nga administrata e bashkive	1		1	1
Punonjës socialë	2	1	1	
Staf i organizatave të shoqërisë civile				1
Kryetarë komunitetesh		2		

Më shumë informacion në lidhje me zbatimin e studimit

Stafi lokal në çdo qark ishin përgjegjës për realizimin e mbledhjes së të dhënave. Koordinatorët lokalë vendosën kontakt me ofruesit e shërbimeve dhe/ose me njerëz me ndikim në komunitete të caktuara, duke përfshirë kryetarë komunitetesh, punonjës të qendrave shëndetësore, stafin e shkollave, stafin e bashkive, punonjës socialë, psikologë, etj, të cilët më tej u intervistuan. Për më tepër, këta persona lehtësuan identifikimin dhe ftimin e pjesëmarrësve të DGF-ve si dhe të të rinjve të martuar para moshës 18 vjeç të cilët u intervistuan.

Çdo diskutim në grup u lehtësua nga të paktën dy pjesëtarë stafi. Moderatorin e grupit të fokusit bëri pyetjet dhe në disa raste mbajti shënime. Mbajtësi i shënimeve ishte përgjegjës për mbajtjen e shënimeve të diskutimeve. Kur pjesëmarrësit ishin dakort, bisedat u regjistruan. Në fund të çdo diskutimi të grupit të fokusit, mbajtësi i shënimeve transkriptoi diskutimet dhe i ndau me moderatorin e grupit të fokusit për kontroll të dyfishtë. Brenda ditës, transkriptet e të dhënave dhe shënimet e mbajtura u ndanë me stafin e zyrës qendrore që mundësoi përkthimin e tyre në anglisht dhe i ndau me hulumtuesin. I njëjti proces u ndoq edhe për intervistat. Disa grupe fokusi u përzgjedhën rastësisht për t'u monitoruar nga UNICEF dhe UNFPA si dhe nga zyra qendrore e Observatorit.

Shtojca 4: Instrumentat e mbledhjes së të dhënave

Instrumentat e mbledhjes së të dhënave u testuan në terren dhe pyetjet u rishikuan para se të finalizoheshin. Testi i parë u realizua në tre GDF: (1) me një grup miks prindërisht / kujdestarësh që jetojnë në komunitete të veçuara në qarkun e Korçës; (2) me vajza të reja romë që jetojnë në komunitete të veçuara në qarkun e Tiranës; dhe (3) me prindër / kujdestarë jo-romë që jetojnë në zona urbane të izoluara (vetëm burra). Qëllimi ishte të testohet: (1) Sa lehtësisht të kuptueshme ishin pyetjet për komunitetet romë dhe jo-romë, dhe se si të intervistuarit reagonin ndaj tyre; (2) Nëse të intervistuarit e shprehnin veten më lirisht në një grup të përzier apo në grupe të ndara. Pas testimit të parë, u vendos që do të ishte më mirë të shkohej me grupe të ndara dhe disa nga pyetjet duhet të rishikoheshin me qëllim që të ishin më të kuptueshme për këdo. Pasi pyetjet u rishikuan, një raund i dytë testimi u realizua: (1) Me prindër romë që jetojnë në komunitete të integruara (vetëm burra) në Korçë, dhe (2) me vajza të reja që jetojnë në zona urbane të izoluara në Tiranë.

Guida e diskutimeve të grupeve të fokusit

Në fillim pasi të kesh prezantuar veten (emër dhe mbiemër dhe organizatën që përfaqëson) si edhe njerëzit që të shoqërojnë lexon këtë pjesën në vijim duke e përshtatur me dëgjuesit:

Pikë së pari, faleminderit që keni pranuar për të marrë pjesë në këtë diskutim. Do të doja të ndaja me ju informacionin në lidhje me studimin për të cilin po punojmë si dhe në lidhje me mundësinë e kontributit tuaj.

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, në bashkëpunim me UNICEF dhe UNFPA, po realizon një studim mbi njohuritë, qëndrimet dhe perceptimet e komuniteteve të ndryshme përsa i përket martesave në moshë të re, me qëllim hartimin e disa programeve të ndryshme në lidhje me këtë temë.

Për këtë arsye do të ishim të interesuar në atë çfarë ju mund të na thoni në lidhje me këtë praktikë në komunitetin/ zonën ku ju banoni. Pjesëmarrja juaj do të ishte shumë e vlefshme dhe e rëndësishme për të kuptuar më mirë këtë temë. Biseda / diskutimi zgjat rreth 60-90 minuta. Do t'ju bëjmë disa pyetje në lidhje me perceptimet dhe opinionet tuaja me qëllim që të nisim një diskutim midis jush. Ne nuk do të kontribuojmë në diskutim por do ta moderojmë atë dhe do të sigurohemi që të mbahet në drejtimin e duhur duke i dhënë mundësinë e diskutimit të gjithëve.

Ju lutemi mundohuni të flisni hapur për çdo gjë që mendoni por pa e ndërprerë njëri-tjetrin. Gjithçili ka të drejtë të kontribuojë në këtë bisedë, kështu që ju lutemi të respektoni pjesëmarrësit e tjerë dhe opinionet e tyre. Ndhuni të lirë për të mos iu përgjigjur ndonjë pyetje ose të ndërprisni bisedën nëse nuk ndiheni komod ose nëse pyetja nuk është e qartë. Kolegu/ kolegja ime dhe unë do të jemi të pranishëm gjatë bisedës. Vetëm me aprovimin tuaj do ta regjistrojmë bisedën. Nëse ju preferoni që të mos regjistrojmë, kolegu/kolegja ime do të mbajë shënime për mendimet e shprehura.

Duam t'ju sigurojmë se çdo gjë që do të thoni gjatë diskutimit do të mbetet anonime dhe do të trajtohet me konfidencialitet – Nuk na duhet të dimë emrin apo mbiemrin tuaj, si dhe çdo gjë që do të thoni nuk do të lidhet me ju. Gjithashtu jeni të lutur që të mos diskutoni atë që do të thuhet gjatë këtij grupi të fokusit me njerëz jashtë këtij grupi. Për të ruajtur konfidencialitetin e gjithsecilit, ju lutemi të mos zbuloni identitetin e askujt gjatë diskutimit (jeni të lutur të mos përmendni emra, apo të jepni shembuj personal).

Nëse në një pikë vendosni që nuk doni të vazhdoni të merni pjesë, ju lutem informoni një nga moderatorët e grupit. Jeni të lirë të largoheni kurdo qoftë.

Nëse nuk keni ndonjë pyetje, mund të vazhdojmë?

Martesa e fëmijëve

Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri

Pasi të keni marrë dakordësinë me gojë të çdo pjesëmarrësi, ju lutemi të plotësoni pjesën në vijim e cila përmban informacion të përgjithshëm i cili nuk ka nevojë t'i kërkohet direkt pjesëmarrësve. Ju lutemi të mos kërkonit asnjë informacion personal.

Data:

Vendi:

Numri i pjesëmarrësve (në fillim): _____ (në fund): _____

Kategoria:

Mosha e pjesëmarrësve (duke filluar nga): _____ (deri në): _____

Gjinia e pjesëmarrësve (meshkuj): _____ (femra): _____

Koha e fillimit:

Koha e mbarimit:

Lehtësuesi i grupit të fokusit:

Mbajtësi i shënimeve :

Jemi tani gati të nisim me pyetjet!

Shënime për intervistuesen/in: Diskutimi do të bazohet në shtatë pyetje kryesore. Kur shikoni se nuk ka përgjigje apo nuk po ecën diskutimi mund të bëni pyetje ndihmëse apo nxitëse të cilat janë shënuar si të tilla. Pyetja kryesore pasohet edhe nga pyetje të tjera shpjeguese.

1. PYETJA KRYESORE (pk): Çfarë mund të thoni në përgjithësi për martesën në këtë zonë / komunitet? A ka ndonjë ndryshim midis martesës dhe bashkëjetesës?

PYETJE NDIHMËSE QË NXISIN PËRGJIGJE RRETH PYETJES KRYESORE (**Nxitje**):

Pse martesa është e rëndësishme?

Çfarë roli ka gruaja në martesë? Po burri?

Çfarë konsiderohet një martesë e lumtur/ e shëndetshme?

2. (pk) Në mendimin/perceptimin tuaj, cila konsiderohet si mosha më e përshtatshme për martesë? (Për vajzat dhe djemtë) Pse mendoni kështu?

3. (pk) Zakonisht, në dijeninë tuaj, në çfarë moshe ndodhin martesat? (Duhet të sqarohet që nuk bëhet fjalë vetëm për martesat formale, por edhe për bashkëjetesat. Pjesëmarrësit të nxiten që të japin përgjigje për moshën kur martohen vajzat dhe moshën kur martohen djemtë)

Nëse asnjë nuk përmend martesat nën 18 vjeç, do të vijohet:

3.1. Cfare dini per rastet kur martesat ndodhin më shpejt?

3.2. Cila është mosha më e re që keni dëgjuar se ndodhin martesat? (për vajzat dhe për djemtë)

3.3. Çfarë flitet për raste të tilla?

3.4. Si ndryshon jeta e të rinjve kur martohen në këtë moshë? (për vajzat dhe për djemtë)

• Si ndryshojnë detyrat dhe roli i tij / saj në familje?

• Si ndryshojnë aktivitetet e tij / saj të përditshme? (për vajzat dhe për djemtë)

3.5. Çfarë të mirash sjell marta për këta të rinj? (për vajzat dhe për djemtë)

3.6. A mendoni se vajzat / djemtë janë gati të martohen në këtë moshë (të re)?

• Mendoni se janë gati të bëhen bashkëshorte / bashkëshort? Pse?

• Mendoni se janë gati të bëhen prindër? (nënë / baba)? Pse?

4. (pk) Në rastet që keni dëgjuar, kush e mer vendimin për martesën? Bazuar në përgjigjen e pyetjes së parë: Pse të rinjtë / prindërit / familjet mendosin që martesa të ndodhë në një moshë kaq të re?

Nxitje: Cilat janë arsyet që zakonisht çojnë në martesa në moshë të re?

- [Nëse dikush përgjigjet: **Për arsye ekonomike**]
